

Nga pritja e Bajronit në Tepelenë, në Sallonet e Artit nëpër Europë

Nga Ferid Hudhri

(fq. 2)



Roberto Gammone, Portreti i Donika Kastriotit

SHËNIME PËR LIBRAT

BARDHYL LONDO "SHËN SHIU", - POEZI

Nga Ali Aliu

(fq. 8)

Libri me poezi i Bardhyl Londos "Shën Shiu" vjen i veçantë për disa arsye: rikonfirmon fuqinë krijuese të zërit lirik, dëshmon qëndrueshmërinë e vijës më të talentuar krijuese në traditën poetike të shqipes gjatë gjysmës së dytë të shekullit që shkoi dhe në vazhdim, sjell dëshminë e pjekurisë jetësore, intelektuale dhe filozofike të autorit, dëshminë e shqetësimit konstant krijues të tij përballë botës së pandreqshme...

PËRMBLEDHJA ME POEZI TEMPI CHE SONO... ZEITEN WIE... KOHË QË JANË... E GENTIANA MINGËS

Nga Entela Tabaku

(fq. 16)

Përmbledhja *Tempi che sono... Zeiten wie... Kohë që janë...* sjell një poezi solide, të ankoruar mirë në vend dhe në kohë. Konturet gjeografike të poezisë janë të qarta dhe të zgjedhura me kujdes: Durrësi, Daka, Verona, Trento, Bolzano, Rovereto, Magrë, Dachau, ose Libia, Siria a Palestina dhe shëtitorja *Hikmet*. Janë ujërat e Maltës, ura *Talvera*, Mesdheu, Nili apo Eufirati.

Mbi librin "Politika si ide", refleksione,
të VALENTINA LESKAJ, Botimet Toena, 2021

PREMTIMI I DEMOKRACISË

Ida Xoxa, PhD

(fq. 9)

Si dëshmi, libri i përshtatet mjaft mirë një leximi nga brezat e rinj, që kurrë nuk duhet të reshtin së besuari në fuqinë e tyre për të farkëtuar një botë më të drejtë. Mesazhi i shpresës mbetet pikërisht ai, që jashtë çdo mospërfilljeje e shkujdesjeje, angazhimi shoqëror dhe politik, të jetë mjeti që çdo komunitet duhet e mund të përdorë për të mos humbur kurrë kulturën demokratike që i jep linjë dhe besueshmëri institucioneve, ligjeve, sistemit në tërësi dhe mbi të gjitha, shoqërisë dhe komunitetit të përbashkët.



In memoriam: Luan Starova

Pardje ka ndërruar jetë akademiku dhe shkrimtari i shquar Luan Starova. Lajmin për vdekjen e tij e kanë bërë të ditur familjarët e tij në Facebook.

NË KËRKIM TË IDENTITETIT TË HUMBUR: SHËNIME RRETH "SAGËS BALLKANIKE"

Nga Matteo Mandalà

(fq. 6)

HARUKI MURAKAMI Ditëlindja ime, ditëlindja jote

(fq. 23)



CORIOLANUS, NJI MEGA- SPEKTAKËL NË TEATRIN KOMBËTAR

Nga Primo Shllaku

(fq. 20)

BIBLIOTEKË

Për Lagerkvist

(fq. 14)

Gjithçka do të harrohet

Nurie Emrullai

(fq. 15)

Rrënjake

Rexhep Ferri

(fq. 17)

Djalli ka surrat të bukur

Esmeralda Shpata

(fq. 12)

Nuhatja e një peshku të kuq

Shkëlzen Halimi

(fq. 13)

Mona Liza

Botim i ri nga Ombra GVG

KOHËT MË TË MIRA

Immanuel Mifsud

(fq. 18)

Botim i ri nga Minerva

TË FITOSH

Jack Welch

(fq. 11)


NGA PRITJA E BAJRONIT NË TEPELENË, NË SALLONET E ARTIT NËPËR EUROPE

Nga Ferid Hudhri

Mëngjesi i 29 shtatorit të vitin 1808 me gjeti Bajronin pranë bregdetit të Shqipërisë. Kur lindi dielli ai ndodhej akoma më afër bregut dhe malet Akrokeraune iu dukën si “amfiteatër vullkanik natyre”. Ishte bashkë me mikun e tij John Hobhouse në bordin e anijes “Spider” në udhëtimin e parë drejt Lindjes. Po atë ditë zbritën në Prevezë dhe të nesërmen morën rrugën drejt Veriut. Siç e kishin planifikuar kur u nisën nga Sicilia, ata do të shkonin në Janinë, në oborrin e Ali Pashës. Por gjatë udhëtimit u njoftuan se *pashait i vinte keq që ato ditë ishte i detyruar të linte Kuvendin e tij për t'i dhënë fund një lufte të vogël në Berat dhe i ftonte miqtë për t'u takuar në vendlindje, në sarajet e tij në Tepelenë*. Gjatë qëndrimit në Janinë, Bajronin e priti sekretari i Vezirit për t'i uruar mirëseardhjen. Ai u tha miqve anglezë *se Lartësia e tij kishte porositur të vizitonin Janinën dhe se kishte dhënë urdhër të përgatitej gjithçka për mirëpritjen dhe udhëtimin e tyre drejt Tepelenës*². Kishte vënë në shërbim të këtij qëllimi një eskortë që do

t'i shoqëronte gjatë gjithë kohës, si e dhe disa kuaj të postës për të bartur bagazhet. Bajroni dhe Hobhouse qëndruan pak ditë në Janinë dhe më 11 tetor vazhduan rrugën drejt Veriut. Kaluan pranë Butrintit, fjetën një natë në Libohovë, qëndruan në fshatrat Erind e Qesarat dhe në mëngjesin e datës 19 tetor të vitit 1808 u nisën në drejtim të Tepelenës ku i priste Ali Pasha.

Ndonëse gjatë udhëtimit të dy Lordët anglezë u përballën me vështirësi *nëpër shtigjet me baltë për shkak të përrënjeve që zbrisnin nga malet*, kur iu afruan Tepelenës e shprehën menjëherë kënaqësinë për vendin ku arritën. Vetë Bajroni, në vazhdim të rrëfimit për këtë udhëtim, do të shkruante *se nuk do ta harrojë kurrë pamjen e bukur në hyrje të Tepelenës, nga ora pesë e mbsaditës, në perëndim të diellit*. Në vendlindjen e Aliut qëndroi më pranë *shqiptarëve me veshjet e tyre nga më magjiket në botë, me fustanella të bardha e të gjata, me jelekët e qëndisur me ar*³. Gjatë tre ditëve në Tepelenë ndjeu mikpritjen më të mirë të



atij udhëtimit. Bashkëbisedoi disa herë me pashain. Aliu i tha Bajronit ta quante baba për sa kohë do të qëndronte aty dhe se e konsideronte si birin e tij. E trajtonte

si fëmijë, i dërgonte bajame dhe sherbet, si dhe fruta e ëmbëlsira disa herë në ditë. Aliu e kuptoi që Bajroni ishte nga një derë fisnike, sepse kishte veshë të vegjël, flokë të dredhur dhe duar të vogla e të bardha. I shprehu edhe kënaqësinë për veshjen e tij të bukur. Ato ditë në Tepelenë kuvenduan gjatë për Anglinë dhe për shqiptarët. Biseduan për Portën e Lartë, për interesat franceze dhe angleze në Pashallëkun e Janinës, përmendën Napoleon Bonapartin dhe figura të tjera të njohura të kohës. Para se të largoheshin, Aliu u tregoi miqve anglezë se pranë Tepelenës ndodheshin disa rrënoja të lashta të Paleokastrës, me mure të moçme dhe gurë të skalitur. U tha gjithashtu se kishte urdhëruar të gatitnin disa kuaj që të shkonin për t'i parë.

Pasi vizituan edhe vendbanimin e hershëm të Paleokastës, në mëngjesin e 23 tetorit Bajroni me Hobhouse vazhduan udhëtimin për në Athinë dhe në Stamboll, të shoqëruar nga eskorta e Aliut si dhe nga shqiptarë të tjerë, grekë, suljotë dhe arvanitas. Kur u largua nga Tepelena, bashkë me mbresat e veçanta për njerëzit dhe natyrën, siç shkruan edhe në letrën dërguar nënës së tij, Bajroni mori edhe disa veshje shqiptare madhështore, e vetmja plaçkë e shtrenjtë në këtë vend. Kushtojnë pesëdhjetë guine secila, dhe kanë aq flori të qëndisur sa në Angli mund të kushtojnë dyqind guine.⁴ Thuhet se në një nga takimet me Ali Pashën brenda sarajeve në Tepelenë, Bajroni u vesh me fustanellën e gjatë dhe jelekun e qëndisur me ar. Siç shihet në disa piktura të shekullit XIX, edhe gjatë udhëtimit nëpër Greqi poeti anglez është paraqitur i veshur me rrobat shqiptare.



Luigi Zuccoli, *Takimi i parë i Aliut me Vasiliqin*, tablo e vitit 1841, Palazzo Isimbardi, Milano

Në korrik të vitit 1811 Bajroni u kthye në Angli. Me mbresat e fuqishme nga udhëtimet në Portugali, në Spanjë, në Shqipëri, në Greqi e në Turqi ai krijoi një nga veprat e tij më të rëndësishme, “Shtegtimet e Çajld Haroldit”. Në shkurt të vitit 1812 u botuan në Londër dy këngët e para të atij vëllimi. Shumë vargje të këngës së dytë Bajroni ia kushtoi Shqipërisë. Siç kanë vërejtur edhe studiues të huaj, mbresat dhe përshtypjet midis shqiptarëve ndikuan shumë në jetën dhe krijimtarinë e poetit. Është shkruar gjithashtu se edhe vargjet e para të “Çajld Haroldit” filloi t’i hedhë në letër gjatë kohës që udhëtonte midis shqiptarëve. Botimi i parë i këtij libri u shit menjëherë. Po ashtu e menjëhershme ishte edhe fama e autorit. Suksesi pas kësaj vepre i kapërceu shkallëzimet e zakonshme të famës, erdhi si në rrëfimet e përrallave, brenda një nate të vetme. Në mëngjesin e 10 marsit të vitit 1812, një muaj pas botimit të librit, vetë Bajroni u shpreh “U zgjova në mëngjes dhe pashë se isha bërë i famshëm”. “Çajld Haroldi” është përcaktuar si një nga veprat më të shquara të letërsisë botërore. Gete e vlerësoi Bajronin si *Gjeniu më i madh i kohës*, ndërsa Belinskij e quajti *Prometheu i shekullit XIX*. Krijimtaria e Bajronit pati një ndikim të madh e të menjëhershëm në letërsinë e të gjitha vendeve europiane. Shkrimtarë të shquar në Francë, në Gjermani, në Itali, në Rusi, në Spanjë e deri në Amerikë u bënë pasues të tij.

Pikërisht në kohën kur gëzonte famën më të madhe, në vitin 1813, i veshur me kostumin që mori nga Shqipëria, poeti i shquar pozoi para piktorit Thomas Philips. Në vitin 1814, pak muaj pas pikturimit, tabloja “Bajroni me veshje shqiptare” u ekspozua në Akademinë Mbretërore të Arteve në Londër. Po atë vit imazhi i kësaj pikturë, i gdhendur në gravurë nga William Finden, u printua në shumë kopje, u botua në revista, gazeta dhe libra të ilustruara të kohës. Vite më pas u realizua edhe në teknikën mezzotint (me ngjyra të buta, të sfumuar) nga piktori G. Sidney Hunt dhe u stampua në 400 kopje*. [Pasi i paraqitën në pritje të ndryshme në Londër dhe i përdorën gjatë pikturimeve të disa tablove të tjera, veshjet e tij shqiptare Bajroni ia dhuroi mikeshës Margaret Mercer-Elphinstone, e cila më pas u martua në familjen Lansdown. Nga viti 1962 kostumi shqiptar i Bajronit, i veshur në një manekin me imazhin e poetit të shquar, u vendos Bowood House & Garden në Wiltshire, pronë e familjes Lansdown dhe shihen aty çdo ditë nga turistë të shumtë që vijnë nga e gjithë bota]*.

Suksesi i menjëhershëm i Bajronit zgjoi një jehonë të madhe edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët nëpër botë. Pas vargjeve të Çajld Haroldit “*Shqipëri, lejome të kthej syt’ e mi/ mbi ty o nënë burrash të egër...*”, shënimeve për këtë vepër ku i përshkruan shqiptarët *si raca më e bukur në botë*, apo mbresave për mikpritjen shqiptare të shprehura në letrat dërguar nënës dhe miqve të tij, si dhe pikturës *Bajroni me veshje shqiptare*, i vlerësuar si portreti më i bukur dhe më i njohur, Shqipëria dhe shqiptarët, nga viti në vit u bënë gjithnjë e më tërheqës për artistët. Nga një vend që ndonëse *dukej nga Italia, ishte më pak i njohur se brendësia e Amerikës* siç kish shkruar vite më parë Edward Gibbon (1737-1794), Shqipëria u bë e pranishme edhe nëpër galeritë, sallonet dhe akademitë e artit të Europës. Tablotë me figura shqiptarësh, të veshur me fustanellat e gjata e të bardha dhe jelekët e qëndisur me ar, u pikturuan edhe në Greqi, Maltë, Turqi, Egjipt, Siri e vende të tjera ku artistët i hasën gjatë pikturimeve të tyre. Me temën shqiptare u angazhuan disa nga shkrimtarët dhe artistët e më të njohur të Europës. Nisur edhe nga numri i madh i gravurave, litografive, akuareleve, portreteve, skulpturave, relieveve dhe



Joseph Petzl, *Robinat*, tablo e vitit 1836, Count Lerchenfeld, Munich

tablove në përmasa të mëdha kushtuar Shqipërisë, që u realizuan gjatë shekullit XIX, në një prej revistave amerikane më të njohura të atyre viteve, do të shkruhej se *shumë është folur dhe shumë është shkruar këto kohë për shpirtin gjallërues dhe kryengritës të shqiptarëve*.⁶

Si një nga personazhet kryesorë të letrave, shënimeve dhe disa vargjeve te

“Shtegtimet e Çajld Haroldit”, edhe për Ali pashë Tepelenën u ringjall një interesim më i madh nga shkrimtarë, diplomatë, artistë dhe udhëtarë të asaj kohe. Jehona e këtij vlerësimi u pasqyrua edhe në shumë vepra arti. Takimet e tij me Bajronin i shohim në vizatimin e grafistit italian G. A. Sasso (1819), në akuarelin e piktorit francez L. Dupre (1823) ku shfaqet çasti i takimit të parë dhe


festat e organizuar në sallonet e madh midis një grupi vajzash që vallëzojnë, ndërsa te litografia e autorëve anglezë E. Finden, W. Purser (1830) paraqitet pallati i madh i Tepelenës dhe mjedisi i brendshëm, aty ku u bënë takimet. Nga kërkimet e deritanishme, litografia “Sarajet e Aliut” është e vetmja vepër arti që paraqet pamjen e plotë të atyre ndërtesave, para se të shkatërrohen nga një zjarr i madh që rrënoi katin e dytë dhe, më pas, të gjithë pallatin. Litografia e autorëve anglezë mbetet gjithashtu e vetmja dëshmi figurative reale, e vizatuar drejtpërdrejt nga natyra, në ditët e shkëlqimit të plotë të asaj ngrehine. Në kohën kur pikturohej kjo pikturë konsulli anglez William Leake ka shkruar se kështjella dhe saraji i Vezirit në Tepelenë kanë pamje madhështore dhe janë krejt në harmoni me panoramën e mrekullueshme përfaqë. Pallati i Aliut është një nga banesat më romantike dhe më ngazëllyese sa mund të përfytyrohet.⁷

Pas vizitës së Bajronit, në Tepelenë erdhën më shumë artistë europianë për të pikturuar Aliun, si edhe motive të tjera nga bota shqiptare. Arkitekti i njohur Charles Cockerell i filloi pikturimet në Shqipëri pasi u takua dhe u miqësua me Bajronin në Athinë. I nxitur edhe prej përshtypjeve të poetit nga vizitat në Tepelenë dhe nëpër troje të tjera shqiptare, Cockerell bashkë me mikun e tij Thomas Hughes ndoqën thuasht të njëjtin rrugëtim. Hughes shkruante mbresat e çdo dite, ndërsa Cockerell vizatonte pamje të ndryshme. Ditën që u takuan me Ali pashë Tepelenën, gjetën më shumë motive për t’i përshkruar dhe pikturuar. Cockerell-it arkitekt i bënë përshtypje sarajet luksoze të pashait dhe qëndroi tri ditë duke pikturuar fasadat e jashtme dhe mjediset e brendshme. Pikturoi edhe Aliun brenda sallave luksoze të pallatit, midis shqiptarëve me fustanella që lëviznin nëpër ato mjedise. Aty realizoi tablonë më të bukur për Aliun dhe një grup shqiptarësh me veshjet tradicionale. Piktura e Cockerell-it i u realizua në Shqipëri të njëjtin vit (më 1914) kur në Londër u ekspozua tabloja “Bajroni me veshje shqiptare”, që gjithashtu e kishte pikënisjen nga udhëtimi drejt Tepelenës. Katër vjet më pas, më 1818, edhe ky *akuarel magjeps* (enchanted water-colour), siç vlerësohet në librin kushtuar autorit të saj C. Cockerell⁸, u ekspozua në Akademinë Mbretërore të Arteve në Londër, në të njëjtin sallë ku ishte vendosur katër vjet më parë “Bajroni me veshje shqiptare”.

Këto janë dy nga ngjarjet më të bukura dhe më të rëndësishme e asaj periudhe. Në kohën kur i gjithë vendi ishte ende nën Perandorinë Otomane, dy tablotë me



Roberto Gammone, *Portreti i Donika Kastriotit*, Romë, 2021




Ali pashë Tepelena dhe Vasiliqia, litografi e vitit 1842, sipas tablosë së piktorit R. Monvoisin

motive arbërore ekspozohen në Londër, në një nga institucionet më larta të artit botëror. Nga kërkimet e deritanishme këto janë të parat vepra arti kushtuar Shqipërisë që futen në sallonet e artit europian. Pak vite pas ekspozimeve në Akademinë Mbretërore të Londrës edhe tri tablo të tjera me imazhin i Ali pashë Tepelenës u paraqitën në Sallonet e Parisit (Salon de Paris), që vlerësohen midis ekspozitave më të rëndësishme të shekullit XIX në Francë dhe në gjithë Europën. Artisti francez Louis Dupré ekspozoi për herë të parë aty pikturën më të rëndësishme që kishte realizuar në Shqipëri. Në Sallonin e Parisit të vitit 1824 u paraqit me tablonë e titulluar

Ali Tebelen, pacha de Janinna, à la chasse sur lac Butrinho (Ali Tepelena, pashai i Janinës, duke gjuajtur në liqenin e Butrintit). Kjo vepër si dhe portreti i veçantë që krijoi më pas për Aliun, vlerësohet si imazhi më i autentik nga i cili janë mbështetur disa nga autorët e tjerë të mëvonshëm. Edhe mjeshtri më i shquar i romantizmit francez Eugène Delacroix u ndikua nga kjo tablo Dupré-së për vizatimet e tij me figurën e Ali pashë Tepelenës*.

Pak vite më pas, në Sallonin e Parisit të vitit 1831, piktori Alexandre Colin ekspozoi dy vepra kushtuar Ali pashë Tepelenës: portretin *Ali Pacha d'Épire* dhe tablonë *Ali Tepelen, pacha de Janina, dans le bras*



G.A.Sasso, Aliu me Bajronin dhe J. Hobhouse në sarajet e Tepelenës, gravurë e vitit 1819

de Vasiliki, sa femme chérie (Ali Tepelena, pasha i Janinës, në krahët e Vasiliqisë, gruas së tij të dashur). Vite më vonë, në bazë të pikturës ku pashai tepelenas paraqitet në krahët e Vasiliqisë, u realizua një acqua tinta me të njëjtin titull nga artisti francez Alexandre Vincent Sixdeniers, në vitin 1833, sikurse tabloja me ngjyra vaji e piktorit grek Spiridhon Kristidhi, në vitin 1900*.

Edhe në albumin e parë me kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia, që u botua në Londër nga Joseph Cartwright (*Selection of the costumes of Albania and Greece*, London, 1822), një pikturë e veçantë i kushtohet Aliut. Ndërsa një vit më vonë, sipas vizatimeve nga W. Davenport u

realizuan gjashtë akuatinte me ngjyra nga piktori G. Hunt më 1823 me imazhe nga ngjarjet kryesore të Ali Pashës (*Historical Portraiture of Leading Events in the Life of Ali Pacha*, London, 1823). Akuarele dhe litografi me ngjyra për pashain tepelenas u botuan edhe në albumet me krijimet e piktorëve Poer Peresford (*Scenes in Southern Albania*, London, 1855) dhe Louis Dupré (*Voyage à Athens et à Constantinople*, Paris, 1825).

Me veprat e tjera që u krijuan edhe më pas mund të themi se Ali pashë Tepelenës i takon numri më i madh i tablove që u është kushtuar figurave të rëndësishme të historisë shqiptare gjatë shekullit XIX. Portretet e tij më të hershme fillojnë para vitit 1804. U realizuan gjatë takimeve me pashain në Janinë dhe në Tepelenë. Më të njohurit janë tri akuarelet nga John Philip Morier (viti 1803), nga William Haygarth (viti 1810) dhe nga Henry Holland në vitin 1813. Midis krijimeve më të hershme është edhe litografia e piktorit italian Dall'Acqua që u botua si ilustrim i librit të François Pouqueville me shënime nga udhëtimet në More, Konstadinopojë dhe në Shqipëri (*Voyage en Moree, a Costantinople et en Albanie*, Paris, 1805). Artisti italian ka krijuar një nga imazhet e rralla për figurën e Ali pashë Tepelenës. Në atë litografi nuk ka asnjë ndikim prej vizatimeve, linogravurave apo tablove të autorëve të tjerë europianë për Aliun, madje mund të quhet një nga veprat më të veçanta, që nuk u përsërit tek asnjë nga modelet e mëpasme.

Një numër i madh vizatimesh, gravurash, akuarele dhe litografish u realizuan edhe për vrasjen tragjike të Ali Tepelenës, në ishullin e liqenit të Janinës në 5 shkurt të vitit 1822. Plot 200 vjet më pas shohim se artistë të vendeve të ndryshme vazhduan të krijojnë vepra të tjera artistike kushtuar pashait shqiptar. Edhe tani, ndërkohë që trupi i Aliut prehet midis Janinës dhe Stambollit, imazhet me portretit të tij vazhdojnë të ekspozohen në disa nga muzetë dhe galeritë e artit nëpër botë. Dy nga pikturat më të njohura ndodhen në Muzeu Britanik në Londër dhe Muzeun



Alexandre Colin, Ali Tepelena, në krahët e Vasiliqisë, Salon de Paris, 1831



Thomas Philips, *Bajroni me veshje shqiptare*

Metropolitan të Nju Jorkut. Biblioteka Kombëtare e Francës ruan rreth 20 litografi me portrete të Aliut, po ashtu shumë punime të tjera artistike gjenden nëpër disa arkiva, muze, galeri apo koleksione publike e private nëpër botë.

Vepra të panjohura më parë po dalin nga shtëpitë e ankandit Christie's dhe Southby's në Paris, Londër, Nju Jork etj. Po bëhen të njohura edhe piktura të tjera nga koleksione të ndryshme publike apo private. Imazhet e dy prej veprave që botohen në ilustrim të këtij shkrimi paraqiten për herë të parë për lexuesin shqiptar. Janë dy nga kompozimet më të bukura piktorale me këtë temë. Në tablonë e piktorit italian Luigi Zuccoli është fiksuar çasti i takimit të parë të Aliut me Vasiliqinë. Një takim i rastësishëm. Një vajzë e re del përpara pashait të madh për t'i shprehur lutjen e saj, për të shpëtuar familjarët nga dënimi. Aliu pranon kërkesën e vajzës. Më pas, siç është pasqyruar edhe në shumë piktura të autorëve të tjerë, Vasiliqia bëhet grua e dashur e Pashait. Tabloja e piktorit Zuccoli është realizuar në vitin 1841 dhe ruhet në Pallatin Isimbardi në Milano.

Ndërsa piktori Joseph Petzl, në ndikimin e shkrimtarëve e artistëve romantikë, na sjell një skenë tepër të ndjeshme dhe prekëse për botën perëndimore të shekullit XIX: rrëmbimi i vajzave të reja për t'i bërë robina. Në tablonë e piktorit gjerman **paraqiten** disa vajza të rrëmbyera që luten para Aliut për shpëtim. Pashai shikon i qetë me vëmendje. Bri tij, i mbështetur në kolltuk është i nipi, i veshur me fustanellë dhe jelekun e qëndisur. Aliu këtu shfaqet më i ri se në pikturat e mëparshme. Kur Petzl pikturonte në Greqi, pashai tepelenas kishte mbi 10 vjet që ishte ndarë nga jeta. Për ravijëzimin e portretit të tij duket se është mbështetur te litografite e Louis Dupré-së, autorit më autentik që e vizatoi direkt nga natyra. Ndikimi nga Dupré shihet jo vetëm për portretin e Aliut

me kësulën e tij karakteristike, por edhe në pikturimin e nipit. Kjo tablo e pikturuar në vitin 1836 ruhet në Koleksionin Count Lerchenfeld, në Munich.

Vitet e fundit po rikrijohen tablo të tjera me personazhe të rëndësishëm të historisë shqiptare, që ndonëse në pamje të parë duken si imazhe të shekullit XIX apo më të hershme, nga teknika e pikturimit si edhe shëmbëlltyra e heronjve kuptohet qartë se janë krijime të ditëve të sotme. Portretet e Gjergj Kastriotit, Donikës dhe Gjon Kastriotit, të realizuara nga piktori italian Roberto Gammone (1.1979) janë tri nga pikturat më të bukura të këtij lloji. Edhe imazhi i pikturës kushtuar Donika Kastriotit, njësoj si dy tablotë e mësipërme, paraqitet për herë të parë për lexuesit shqiptarë në ilustrim të këtij shkrimi.

1. Bajron, Xh. G., Çajld *Harold*, shqipëruar nga S. Luarasi, f. 51, Onufri, Tiranë, 1999. [Ndërsa në shënimet për Çajld Harold-in Bajroni ka shkruar shkruar se i ka parë malet Akroeraune të Himarës, në dukje të frikshme, por madhështorë (Byron, *The complete poetical works*, London, 1853)]
2. Hobhouse, J., *A Journey through Albania and other Turkish Provinces*, London, 1813 (përkthyer nga Dh. Qiriazhi, Toena, Tiranë, 2001)
3. Hobhouse, J., Po aty, f. 4
4. Nga shënimi në fund të letrës së Bajronit dërguar nënës së tij më 12 nëntor 1809.
6. Mayhew, A., *In albania with the ghegs*, Scribner's Monthly, vol. XXI, f. 381, New York, 1881.
7. Leake, W., *Travels in Northern Greece*, f. 30, London, 1835.
8. Watkin, D., *The Life and Work of C. R. Cockerell*, f. 15, London, 1974.
- * Shënime nga kërkimet në Akademinë Mbretërore të Arteve, Londër, Muzeun e Luvrit, Paris, The Wiit Library, Londër, Bowood House & Garden, Wiltshire etj., dorëshkrime, imazhe dhe faksimile, arkivi personal, F.H.



Edward Finden, *Pallati i Ali Pashës në Tepelenë*, litografi e shek. XIX



Saga ballkanike e Luan Starovës përbën një zhvillim me rëndësi të posaçme në panoramën e letërsisë së Europës Juglindore, në lakoren e së cilës në fakt shënon një pikë kulmore. Duke e rilexuar pas disa vitesh dhe mbështetur në bibliografinë kritike që ndërkohë i është kushtuar, dalin në pah shumë elemente që na shtojnë drejt një reflektimi jo gjithmonë mirëfilli letrar. Në qendër të metaforave me ngjyrim të forta surrealistë të Luan Starovës gjejmë brenga të thella që gjatë shekujve kanë përshkuar Ballkanin dhe popujt e këtij gadishulli. Një rajon gjeopolitik që ka përjetuar konfliktet më të mëdha të Erës moderne dhe sidomos gjurmët e ideologjive mbytëse të pushtetit, gjithmonë të importuara nga jashtë si mjete sundimi dhe shtypjeje. Pyetjes që lind natyrshëm se cili virus i ka shkaktuar ato brenga, historianët, antropologët dhe gjuhëtarët janë përpjekur t'i japin përgjigje të ndryshme.

Gjatë shekujve që pasuan rënien e Perandorisë Bizantine, pra gjatë rrënjosjes së sundimit osman, popujt ballkanikë ndanin së bashku jo vetëm hapësirat gjeografike, por edhe kulturat. Të karakterizuara nga një natyrë e theksuar endacake (nomade), ata kishin bërë të vetën shprehinë e bashkëjetesës me tjetrin dhe traditën e respektit të ndërsjellë me vetëdijen se tek e fundit me fqinjin kishin më shumë të përbashkëta sesa dallime. Kjo në të vërtetë konfirmohet nga disa përkufizime dhe emërtime shumë-etnike të shekujve XVI-XV, – si p.sh. βουλγαρβοαντοβλάχοç e «Bulgaralbanitoblahos», «Serbalbanitoblahos» e «Serbalbanitobulgarovalaque» – që u gjetën në vitin 1850 nga arbëreshi Pietro Matranga dhe iu atribuuan banorëve të Thesalisë, “identiteti” i të cilëve përcaktohej nga shuma e tipareve etnike që nuk bënte dallime mes «bullgarëve», «shqiptarëve», «vllëve», «serbëve» e me gjasa edhe «grekëve». Falë kësaj trashëgimie të moçme të visarit gjuhësor të përbashkët që kishte vënë re Jernej Kopitar qysh në vitin 1829, aty nga gjysma e parë e shekullit të shkuar u krijua termi shkencor Balkansprachbund pikërisht për të shënuar kompleksin e bashkëpërkimeve fonetike, gramatikore sintaksore dhe leksikore që gjenden nëpër gjuhët ballkanike e që nuk mund të shpjegohen ndryshe veçse si rezultat i një bashkëjetese të gjatë paqësore të bashkësive folëse përkatëse. Një bashkëjetese që i bëri popujt e Ballkanit ta plazmonin fizionominë e tyre antropologjike duke përshtatur rite dhe simbole të përbashkëta edhe përmes ndërmjetësimesh të mëpasme dhe përzjeresh të vazhdueshme që ende sot ngjallin interesin e kërkuesve shkencorë të cilët përpiqen të shpjegojnë vitalitetin, modalitetet dhe larminë e formave të kësaj dukurie me vlerë jashtëzakonshme. Përballë këtij konteksti historiko-kulturor që nuk është vendi këtu ta shtjellojmë më tej, përgjigjja e pyetjes së shtuar më lart na ndihmon të kuptojmë premisat e vërteta të Sagës ballkanike të Luan Starovës: virusi që mbolli përçarjen, përvijoi kufijtë, ngriti gjerdhet dhe i bëri ato të pakapërcyeshme është ai i nacionalizmit, i flamës ideologjike

In memoriam:Luan Starova

NË KËRKIM TË IDENTITETIT TË HUMBUR: SHËNIME RRETH "SAGËS BALLKANIKE"

Nga Matteo Mandalà

më të re dhe më shkatërruese që ende sot e gjithë ditën Europa e ka të vështirë ta heqë qafe. Pikërisht ndaj kësaj flame të kohës sonë romanet e Starovës përvijohen si denoncim i prerë dhe i pakompromis.

Saga ballkanike është një cikël narrativ modular që vërtitet rreth jetës së familjes Starova, babait dhe nënës së Luanit. Një familje shqiptare e detyruar të ndërrojë vendbanim sa herë që ndryshojnë kushtet dhe regjimet politike. Është një histori (auto) biografike që e zë fillin kur plasën luftërat ballkanike në vitin 1912, viti i realizimit të ëndrrës së madhe kombëtare të shpalljes së Pavarësisë, për të vazhduar, sikurse ka vënë në pah Edgar Morin, me «valën nacionaliste turke që do të shkaktojë dëbime dhe zhvendosje popullsh, të cilat më vonë do të quhen pastrime etnike». Një varg i

padërprerë ngjarjesh tragjike, përpjekjesh për asgjësimin e tjetrit, imponime pikëpamjesh mbi të tjerët, shtypjeje të atyre që konsideroheshin inferiorë thjesht sepse perceptoheshin “të ndryshëm” nga pikëpamja etnike, gjuhësore dhe kulturore, që kishin pra një përkatësi të ndryshme “kombëtare”. Pikërisht përkatësia në këtë kategori të re në Ballkan u përcaktua me zjarrin e topave, në dallim nga mentaliteti i deriatëhershëm që i kishte konsideruar popujt e Ballkanit si “fqinj të ngjashëm”. Te shndërrimi i vështirimit dhe te metamorfoza e frymës së thellë të Europës Juglindore lidhet filli i regjimit surreal të Luan Starovës, që përshkon breza të tërë me synimin për të ndërtuar përmes rrëfimit të andrallave familjare dhe kujtimeve intime të Autorit-dëshmitar, rrjedhën historike të një rajoni të

tërë që duke nisur nga viti 395 për shekuj me radhë mishëroi simbolikisht vijën e famshme të Teodosit, e cila, sikurse e thotë titulli i esesë së Aurel Palsarit, *rishfaqet* me funksionin e moçëm të kufirit ndarës mes Lindjes dhe Perëndimit. Pas Luftës së Dytë Botërore “dallimet” etnike do të fshiheshin në emër të unitetit ideologjik: pas periudhës bizantine dhe asaj osmane, një tjetër valë e huaj do të përfshinte Europën Juglindore, përsëri nga Lindja, kësaj here nga Rusia sovjetike.

Shfaqja e nacionalizmave me ngjyrë të kuqe solli me vete vendosjen e kufijve të rinj sipas vijave që dikur në Ballkan nuk përbënin ledhe ndarëse mes entitetesh homogjene – *Schranke* i quanin Kant dhe Hegel, paçka se sinorë, *Grenze*, gjithmonë sipas dy filozofëve të mëdhenj gjermanë – që duke qenë pika takimi mes entitetesh homogjene, ishin të destinuara të kapërceheshin. Me t'u shkatërruar kjo paradigmë e bashkëjetesës, popujve ballkanikë nuk u mbetej tjetër veçse të ashpërsionin marrëdhëniet dhe të thellonin dallimet deri në mohim të historisë së përbashkët. Urrejtja dhe pandjeshmëria shpërthye me një dhunë të paparë gjatë dy luftërave të fundit në Ballkan, sidomos në ish-Jugosllavi, që për shkak të hipokrizisë së “bashkim-vëllazërimit” titist u zhyt në një vorbull nacionalizmash dhe lokalizmash ekstremë. Te *Saga Ballkanike* e Luan Starovës rreziku që i kanoset Europës Juglindore ndihet qysh me shfaqjen e perdes së hekurt. Për ta neutralizuar atë rrezik autori propozon, do të thoshim me një optimizëm të tepruar, një hipotezë shpëtimi që merr trajtën e kërimit të identiteteve të humbura, të ringjalljes së të shkuarës jo si panteon i lavdishëm, as si grumbull trofesh, por si katalizator i dialogut dhe hapjes, sikurse pohonte edhe Edgar Morin në një gjykim që u përvetësua nga lexuesit dhe nga kritikët e Starovës. Me fjalë të tjera e kaluara e largët, Mesjeta aq e kritikuar, evokohet, paçka se tërthorazi, si model i bashkëjetesës dhe ballafaqimit paqësor me tjetrin. Pikërisht “tjetri” te romanet e Starovës merr pamjen e një dallimi biologjik, aq rrënjësor sa mund të shfaqet si pasojë e një antropomorfizimi të tepruar të kafshëve – si p.sh. të dhive, të cjamin, të ngjalave – ose përndryshe shfaqet si një fuqi sugjestionuese që u jep jetë sendeve jofrymore nga të cilat varet zhvillimi i qytetërimeve dhe fati i njerëzve.

Historitë që janë derdhur te *Saga ballkanike* jo vetëm përcjellin andrallat e përjetuara nga familja Starova, por shtrihen më tej aq sa përfshijnë jetën e popullive të tëra, fatet e të cilave vendosen së lartmi nga mekanizmat e pushtetit me synimin për të realizuar plane të çmendura autoritare. Sikurse dhinë, ashtu edhe burrat dhe gratë, gjithë bashkësitë njerëzore tërhiqen përdhuni në vorbullën e paranoive ideologjike që nuk kursejnë asgjë, as edhe logjikën më të thjeshtë e të natyrshme të gjërave. Në emër të ideologjive – në rastin e veprave të Starovës të ideologjisë komuniste të importuar me forcë në Ballkan pas Luftës së Dytë Botërore – përmbysen përparësitë, hartohen projekte të shndërrimit të njeriut, ndiqen objektiva të panatyrshëm si ai i “krijimit të njeriut të ri”, përcaktohen synime të përcudnimit të identiteteve sociale, planifikohen revolucionet që shkallmojnë asetet antropologjike shekullore, përvijohen profile të papajtueshme me vizionin natyror të njeriut dhe me misionin e tij primordial: të japë dhe të ushqejë jetë. Të gjitha këto në kuadër të determinizmit ideologjik që nuk përfill as historinë, as traditën, por që i njeh mesianizmit të ri të drejtën të shkatërrojë identitetet vetjake dhe komunitare.

Pikërisht nga ky mishmash mitesh të rreme dhe realiteti tragjik Starova nxjerr lëndën e parë për endjet e tij narrative. Nga ajo botë ku ai dhe familja e tij, e marrë si simbol për mijëra familje të tjera të viktimizuara prej delirit të ideologjisë së re, autori frymëzohet për të rrëfyer anën groteske të ekzistencës njerëzore. Një jetë e shenjuar prej një morie rrugëdaljesh që i ati sajonte herë pas here për të shpëtuar familjen. “Kur babai shihte se familja ndodhej para rrezikut të luftës, zhdukej diku pa lajmëruar, që ta përgatiste

Pardje ka ndërruar jetë akademiku dhe shkrimtari i shquar Luan Starova. Lajmin për vdekjen e tij e kanë bërë të ditur familjarët e tij në facebook.

Luan Starova ka lindur në Pogradec më 1941. Si student i gjuhës dhe i letërsisë frënge, punoi një kohë si gazetar. Më vonë u pranua asistent në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë frënge në Fakultetin Filologjik të Shkupit, në të cilën ka qenë profesor i rregullt i letërsisë frënge. Së fundmi ai ka ligjëruar në Universitetin e Evropës Juglindore të Tetovës.

Luan Starova ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë dhe të Akademisë Mesdhetare në Napoli.

Trashëgimia e tij letrare është shumë e pasur. Ka botuar shtatë romane, dy vëllime me tregime, një me poezi, disa vëllime me ese dhe studime, ka përkthyer poetë të njohur francezë në shqip dhe maqedonisht. Ka shkruar paralelisht në shqip dhe në maqedonisht. Starova renditet ndër shkrimtarët shqiptarë më të përkthyer në botë, pas Kadaresë. Është fitues i çmimit më të lartë francez për art dhe letërsi.

ExLibris ka pasur fatin e lumtur të botojë një intervistë të gjatë për jetën dhe krijimtarinë e Starovës.

Redaksia e ExLibris dhe Onufri u shprehin ngushëllimet më të thella familjarëve dhe miqve të shumtë të autorit.




shpërnguljen e e ardhshme të familjes”. Çka dikur konsiderohej si normale për popullsitë nomade, në kohët moderne të shekullit XX shndërrohej në një masë mbrojtjeje dhe mbijetese. Bëhej fjalë gjithmonë për një shpërngulje nga një vend në tjetrin, por dallimi ishte ontologjik: shpërngulja nuk u detyrohej më nevojave të jetës, por ikjes instinktive nga rreziku i vdekjes. Një lojë paradoksesh që në realitetin ballkanik – të atij “Ballkani të mallkuar” ku nuk kishin të sosur luftërat vëllavrasëse – shënonte një udhë të shtruar me vuajtje shpirtërore dhe metamorfoza kulturore. Një udhë që në një çast të dhënë të jetës së protagonistëve do të kërkonte një bilanc final, një llogari të përvojave të jetuara dhe të mësimave të nxjerra. Sipas nesh, këtu qëndron vizioni optimist i narrativës së Starovës, e cila, nëse na lejohet një paralelizëm, duket se ndjek, tashmë në kah të kundërt, të njëjtin *Weltanschauung* që Thomas Mann derdhi te saga gjenealogjike e *Buddenbrook-ëve*: nga njëra anë kemi familjen hanseatike, që shkrimtari i ri gjerman e përshkruan duke u nisur nga përvoja e vet familjare, një familje e qëndrueshme (në hapësirë), por e destinuar të pësojë (në kohë) rrënimin social si rezultat i një dekadence të përgjithshme dhe të pashmangshme epokale; nga ana tjetër familja e Starovës, që përshkruhet nga pikëpamja e privilegjuar e narrativës së dëshmitarit në cilësinë e protagonistit, është një familje e destinuar të lëvizë vazhdimisht (në hapësirë) dhe të rizbulojë gjithmonë vetveten (në kohë), me fjalë të tjera është e destinuar të rivlerësojë arsyet e thella të rilindjes dhe afirmimit të saj. Rrëfimi i Starovës, në kërkim të një pike të re mbështetjeje, i jep jetë një “sage familjarë” të mirëfilltë, e cila, duke u përfshirë në vorbullën e ngjarjeve, tërheq me vete përbërësit e veçantë, i detyron ata të bëhen pjesë e historisë kaotike të vendeve dhe të vuajnë barrën e shndërrimeve të thella të shkaktuara nga stuhitë ideologjike, politike dhe ushtarake, të tilla që të sjellin deri edhe shndërrime identitetesh. Procesi të pashmangshme tëhuajësimi që nga njëra anë dëshmojnë alternativën ekstreme që lind nga instinkti i mbijetësës dhe që gjithsesi, nga ana tjetër, falë një reagimi të posaçëm vetjak, rreken t’u hapin udhën paradokseve duke arritur madje deri atje sa të hamendësojnë imperativë kategorikë me prejardhje ontologjike, si p.sh. kërkimi i identitetit të humbur apo ndoshta pretendimi për ta rindërtuar atë si përgjigje e një thirrjeje nga lashtësia. Pikërisht kësaj thirrjeje i përgjigjet me vetëdije të kthjellët rrëfimtari-dëshmitar, duke mos ngurruar ta shpallë hapur atë në përshkrimin e mëposhtëm të babait, që është rimarrë me mprehtësi nga prof. Ali Aliu në parathënien e botimit shqip të romanit *Librat*

e *Babait*, çka në vetvete përbën edhe një përshkrim të përpiktë kritik të gjithë *Sagës ballkanike*: “*Babai në shpirt bartte dy lumenj të bujshëm që vazhdimisht bymeheshin, por që asnjëherë nuk bashkoheshin, as derdreshin te njëri-tjetri e as që përfundonin në detin e largët të mendimeve të tij: njëra rrjedhë shprehte instinktin për ruajtjen e identitetit..., kurse tjetra gatishmërinë që çështja e identitetit të relativizohej*”.

Udhëtimi së prapthi i Starovës përvijohet si një shtegtim në intimitetin e dëshmitarit për të rizbuluar dramën e përjetuar nga familje që asokohe nuk e dinin se jetonin

në zgrip të botëve heterogjene, madje, përkundrazi, e konsideronin normale të ndanin të njëjtat hapësira ku gjuhë dhe kultura të ndryshme dëshmonin prirjen e lindur për bashkëjetesë paqësore dhe hapje të ndërsjellë. Introspektimi i guximshëm i protagonistit tonë – dëshmitar i ngjarjeve që përjetuan ballkanasit gjatë shekullit më të trazuar të historisë europiane – zhbiron nëpër zgafellat më të thella të kujtesës vetjake derisa e shndërron atë në paradigmen universale të një bashkësie të tërë, të vetë njerëzimit. Këtë e ka vënë në dukje më së miri Éric Faye kur e ka quajtur romanin *Emigrimi*



i ngjalave «metaforë metafizike, metaforë politike, [pasi] pushon pak nga pak së qeni emigrimi i disa njerëzve të veçantë, për t’u shndërruar në një udhëtim të njerëzimit me zgjedhjet e tij, me ngurrimet e tij, me gabimet e tij». Për më tepër, po të duam të vlerësojmë si duhet raportin referencial mes përfaqësimit metaforik dhe realitetit, nuk mund të mos pajtohemi me gjykimin e Silvana Lekës, e cila, gjithë duke iu referuar metaforës së emigrimit të ngjalave – metaforë që në prozën e Starovës rrok gjithë korpusin narrativ të *Sagës ballkanike* – vë në pah se «*Metafora vendoset në truall real kur pengesat nuk janë më abstrakte, por kur ato realizohen përmes diktatit, në emër të propagandës, të utopive dhe kur janë po aq artificiale sa forcimet e kufijve dhe mbyllja e liqeneve me diga mbytëse*».

Në rrafshin mirëfilli letrar rrëfimi i Luan Starovës prek një nga temat kyçe të teorisë së letërsisë, e cila, – sikundër e ka vënë në dukje me mprehtësi prof. Ali Aliu në parathëniet e botimeve shqip të dy romaneve *Librat* e *Babait* dhe *Koha e dhive*, që përbëjnë përkatësisht dy vëllimet e para të *Sagës ballkanike* – prej kohësh vë në qendër të refleksionit hermeneutik çështjen e rolit të rrëfimtari-dëshmitar dhe të marrëdhënieve të tij me autorin. Është fjala për një aspekt që e vendos prozën e Starovës në hullinë e traditës moderniste, a më mirë të themi surrealistë, që e zuri fillin me Apollinaire-in dhe vijoi gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të shkuar duke kontribuar në shndërrimin rrënjësor të romanit bashkëkohor. Nuk është vendi këtu për një analizë të krahasuar, as për të shqyrtuar hollësisht në mënyrë kritike kompleksitetin estetik të kontributit të Starovës, por nuk mund të mos e përmendim prozën e tij si shembull krejt original të letërsisë bashkëkohore ballkanike dhe të vëmë në dukje se ajo zhvillohet, sikurse e thamë më lart, si ndërhyrje vetjake rreth temës-kyçe të autobiografizmit letrar, duke i dhënë një përthyerje origjinale kësaj paradigme enigmatike, ende të pazgjidhur, që spikat në krijimin artistik *tout court* e sidomos në krijimin letrar.

Në përfundim të këtyre shënimeve dua të kujtoj takimin që pata me Luan Starovën në tetor të vitit 2015 me rastin e pjesëmarrjes së tij në *Festivalin e letërsive migrante* që organizohet çdo vit në Palermo. Bashkë me kolegët Maria Teresa Giaveri dhe Francesco Altimari moderuam një diskutim me Autorin tonë para një publiku të gjerë mbi të fshehtat e shkrimtarisë së tij. Nxitëm në këtë mënyrë një lloj “vetërrëfimi” gjatë të cilit Starova na shpjegoi sesi profili i tij human dhe intelektual që zhvilluar në zgrip të kufijve gjithmonë të paqëndrueshëm, në kërkim të pareshtur të një përmase identitare, fillimisht vetjake, më pas edhe në raport me identitetin e të tjerëve. Kur organizuesit e festivalit më kërkuan një titull për takimin me Starovën, thujse instinktivisht më erdhi në mendje një paralelizëm mes prozës së Luan Starovës dhe asaj të shkrimtarit arbëresh Carmine Abate: një paralelizëm që nuk ishte aspak i stisur, pasi buronte nga një lexim sinoptik i dy përvojave jetësore të shenjuara nga e njëjta dhimbje, mërgimi, që te të dy shkrimtarët, njëri arbëresh i Italisë, tjetri shqiptar i Maqedonisë, kishte ushtruar një trysni dhe ndikim të madh intelektual mbi krijimtarinë në prozë. Të dy këta e kanë interpretuar gjendjen e paqëndrueshmërisë së përhershme, pra gjendjen e emigrantit, si burim për të gërshtuar prejardhjet dhe rrugët individuale, duke arritur t’i përçojnë tjetrit, sikurse e ka theksuar Francesco Altimari, një ide të thellë, aspak folkloristike, të identitetit të vet dhe të bashkësisë së cilës i përkasin. Te të dy ka peshuar brenga e gjuhës dhe e komunikimit. Të dy e kishin lënë mënjanë *gjuhën e zemrës* për *gjuhën e bukës* që në rastin e tyre ishte ngritur në nivelin e gjuhës së artit. Të dy e kishin shndërruar gjendjen e tyre prej emigranti të përjetshëm në atë të refugjatit gjuhësor. Prej kësaj rrjedh edhe titulli që sugjerova për takimin e vitit 2015: “Luan Starova: përvoja e një refugjati gjuhësor...”. Sot do ta plotësoja duke i shtuar “...në kërkim të identitetit të humbur!”

Libri me poezi i Bardhyl Londos “Shën Shiu” vjen i veçantë për disa arsye: rikonfirmon fuqinë krijuese të zërit lirik, dëshmon qëndrueshmërinë e vijës më të talentuar krijuese në traditën poetike të shqipes gjatë gjysmës së dytë të shekullit që shkoi dhe në vazhdim, sjell dëshminë e pjekurisë jetësore, intelektuale dhe filozofike të autorit, dëshminë e shqetësimit konstant krijues të tij përballë botës së pandreqshme...

Libri me poezi “Shën Shiu” përfshin në vete pesë cikle frymëzimi tematik që, sejcili është libër në vete: i lidh, pos ekspesionit, një shqetësim bosht e që vjen mungesë ngasëse, gri përditshmërie, pezull dhe boshësi, e në çaste edhe pasiguri dhe kërcënim latent. Vjen jehonë thellësisht kjo mungesë e esencave dhe kuptimit, e pranishme pandërprerë në rrjedhën kohë-dje, sot, nesër...

Cikli i pare, i librit “Shën – Shiu”, “E zeza tragjike e Ballkanit”, hapet me poezinë “Rikthimi në tempull” që kumton shfaqjen në horizont dritën e një rikthimi, - e kthimit të përhershëm. Nuk ka rëndsi mëtimi dhe misioni i këtij kthimi, nëse vjen dhe e ripushton kështjellën e ëndërruar të muzës, apo rrënjët e lashta të etnisë antike, - frymë që i përshkon edhe poezitë e ciklit vijues “E kaltra e Makit”; kthimi a rikthim vjen gjithnjë i përrirë si Frymë dhe Panteon njëkohësisht; është shfaqja e rikthimit si një agim i bardhë që shkrepet çdo ditë e gjithnjë i ri, gjithnjë për here të pare njësoi si loja e dashurisë, rikthim që mbase është më i vështirë se kthimi në Itakë, - prandaj edhe më i bukur...

Edhe pas mungesës, përkatësisht boshit të pranishëm në hapësirë të cilën njeriu që nga fillimet ëndërron ta përmbushë, ta kuptimësojë, vargjet e poezisë në hapje të librit, jehojnë krah-parabolë për tu kapur dhe komunikuar me akrostikun e sonetit përmbyllës të librit “Ata që erdhën dhe do të vine”, që është: “Falna Krisht Amin”, tek i cili poeti, poezia shtrydh lëng bukurie edhe nga ligësia dhe krimi që i evokon si të kaluara-të përhershëm, të pranishme dhe në rritje edhe në botën shqiptare.

Në dy ciklet e parë, - kryesisht shtegtime reale dhe virtual të poetit, lashtësive etnike (Çamëri-Kalabri...) është kornizuar hapësira-kohë reale, e zënë në çaste ngjizjeje dashurie a përgjërimi, malli a vetmie, gëzim a pikëllim, gjithnjë në sensin e ndjenjës që lidh të tanishmen me të kaluarën. Është frymëzim ngasës që shtresimet shpirtërore, vlerat, i mbron nga korrozioni i shiritit kohë. Këto vargje, kanë, po ashtu, edhe ngarkesë sociale, historike, dramën, dritën e vizionit në horizont... Vargje ku portret - kontakti me figurat e ndritura të etnisë, nuk kërkon mbështetje në të dhëna historike, formale për ta xigluar lexuesin: pamja e jashtme dhe brendia shfaqet drejtpërdrejtë dhe evokim i shkrepshëm, si shpërthim me ndriçim estetik.

Vargjet e këtij rrethi frymëzimi rrezatojnë aromë thellësisht të rrënjëve dhe kanë ngarkesën e vetëdijes së kohës kur ngjizet poezia. Është pikërisht ana e fuqishme e lirikës së Bardhyl Londos, - ofron emocione dhe refleksë parabolike në kohë dhe hapësirë.

Përballë poezisë Shën Shiu – cikli it retë i librit-, që vërshon me force lirike hapësirën, qëndrojnë edhe gjashtë poezitë e tjera, e që në fakt janë degëzim i saj. Edhe vargjet e poezisë “Maskat”, shtigjeve dhe rrugëve të shumta turen të acaruar drejt pushtimit sa më shumë hapësirë; Qentë gjithashtu përdhosin dhe kontaminojnë qytete dhe mbarë hapësirën. Shqetësimin dramatik dhe anatemen, poezitë e këtij brezi tematik e kanë vetvetiu, në vete. Poeti ndërsa, dashamirësisht apo ironikisht njësoj, vetëm në çaste, klithlutet, - le të kenë

BARDHYL LONDO

“SHËN SHIU”, - POEZI

Nga Ali Aliu

mëshirë maskat, pa le qentë...Janë vargje të thurura me fjalëngarkuarat e zgjedhura që vijnë ekuivalent verbal i asaj që “shihet”, që “preket”, që “dëgjohet”. Përmes autonomies së plotë të fjalës, arrihet “zbutja”, “zotërimi”, “fisnikërimi i lendës bruto. Prirja drejt gjuhës-bisedimore lirike e poezisë “Shën Shiu”, (me traditë majakovskiane)me këtë rast fuqimisht e thekson, brenda tërësisë së vet, poentimin poetik. Është gjuhë poetike që nuk e përjashton me çdo kusht prirjen për të rrëfyer. Ngjashmëria e fjalëve sipas tingujve, sugjeron afërsi në sensin kuptimor, krijon hapësira dhe mundësi shtesë për variacione estetike dhe kuptimore, hapësira të reja stili gjuhësor. Poetika e tillë mëton të përfshijë të pathënë në përmes konvencave, që me këtë rast arrihet përmes shtatë poezive të përfshira në ciklin “Shën Shiu”. Fjala e sfiduar këtu, nxitet, gatuhet nga një specter e vizion, ngjashëm me vargjet e Azem Shkrelit “Lirikë me shi”, dhe “Ç’gurron guri” të Ali Podrimjes. Fjala është për aventurë poetike që ka mbështetjen e besimit: kreacioni artistik ka ngasjen e refleksit të vetëdijshëm në sens të përzgjedhjes së tingujve, të ritmeve dhe tonaliteteve, përzgjedhje fjalësh dhe fizionomi fjalësh që në poezitë e zëna ngoje fjalëformimi është ajo që e përcakton reflektimin domethënës, kuptimor. Rezultati poetic me këtë rast vjen shpërthim i sensacioneve të forta, shtrirje të ndiesive e pamjesh të fuqishme asociative. Shpërthejnë roitje të bujshme të pamjeve lidhur varg, poetikë që sugjeron diskurs gjuhe të ngarkuar me pushtet të fuqishëm emocional.

Ngjyrimi i aventurës poetike, spektri i emocioneve, i ngasësit të refleksioneve

është i veçantë dhe dallues mes tri poezive të përmendura më sipër: Bardhyl Londo ka shqetësimin e pranisë së ligësisë në përditshmërinë tone dhe në atë mbarë njerëzore; Azem Shkreli thur mozaik magjik të një pamjeje gjithësie, të një peisazhi uJOR paqësor, ëndërror në ndjellje, buisje shiu që vjen sinfoni parajsore, mbase edhe për të shuar etjen, për ta vënë në përgjumje, në qetësi engjëlllore gjithësinë, mbase për të sjellë një kumt pëshpëritës nga thellësitë e rrënjëve, apo përgaditje për shiun n që shpëlan kurm e shpirt... Podrimja, gjithnjë brenda vizionit të tij të njohur mbi etninë, sjell, përmes simbolesh, rrënjët antike të saj, të etnisë, qëndresën nëpër kohë dhe hapësirë, - gurrojnë dhe gurrojnë pa ndërprerë gurët si një ardhje me pamje sa tokësore sa qiellore, si një shtrirje pa fund e pamjes – bardhë, bardhë. Shiu i Bardhyl Londos vjen shigjetim shitues, mbase edhe ndëshkim qiellor, bibli, fajesh dhe mëkatesh. Shiu i Azem Shkrelit rrezaton qetësi dehëse që merr në dorëzim gjithësinë, që rafshon laramanitë, vjen pajtim e mirësi qiellore, vjen pastrim katartik. Podrimja ndjell vision idilik arbëror ndër shekuj, ndjell gurrërim të përjetshëm ndër dejt e etnisë...

Gjithnjë në frymën e këtij stili gjuhësor, të kësaj poetike, (të kujtojmë insistimin valerian se kreativiteti poetik është prurje edhe e përqëndrimit të ndërgjegjshëm) durimi i përzgjedhjes tingullore dhe ritmike, tek poezitë e këtij cikli sidomos, artikulon zë të fuqishëm poetic të Bardhyl Londos. Përsikëndijimet që me këtë rast rrezaton vargëzimi i fjalëve të përzgjedhura, vërshojnë sa si valë të vrullshme, të

shkumbëzuara, që në cast të qetësohen, të frenohen sinkopueshëm, duke rrezatuar tension të brendshëm, ngulçitës. Veset dhe ligësia, të regjistruara në poezi, me prirje shtrirjeje në hapësirë, sikur gjenden aty rastësisht, incidentalisht, pa zot. Fjalët Shtetarë- Shtegtarë përshembull qëndrojnë të përafërta si tingëllim, por të largëta, për më shumë të kundërta për nga kuptimi. Në këtë sens rrezaton refleks poetik, në këtë frymë e nget lexuesin në monologun bisedimor. Poezia në përmbylljen e librit (Ata që erdhën dhe do të vine) vjen prandaj si një ngushëllim pikëllues me akrostikun Falna Zot Amin, për krejt mëkatat e bëra dhe të mundshme...

Kjo mund të jetë perspective soditëse e poetit: marroja e maskave, në një ditë marroke marsi (shqiptar), që përsëritet sipas një kalendari fatal e që sjell vizionin dhe shijen e hidhur të poezive të ciklit në tërësi, por edhe të ciklit që pason “Fluturimi i korbave” që shfaqet përmes pesë hovesh: brenda njeriut korbat lindin dhe rriten, - për të rinisur fluturimin e zi në pambarim... Në grinë e përditshme, vritemi duke e urryer njerëzjetrin... Njëra ndë poezitë më të bukura, karakteristike edhe për profilin moral dhe estetik të njohur të këtij poeti është poezia Revolver, arma që i qëndron armiqësisht prore e ngrehur në ballë e që kursesi të shkrepet: Mos u lodhni më kot, - Mua mund të më vrasin vetëm miqtë...

Cikli i fundit i librit Shën Shiu “Dhjatë e përmbysur”, vjen dëshmi e pjekurisë jetësore dhe krijuese, dëshmi urtie e lirikut të shquar. Janë poezi që dëshmojnë fuqinë shprehëse të mundësive krijuese të poetit, mundësitë e gjuhës në duart e tij, dëshmi e pjekurisë filozofike në perceptimin e botës dhe realitetit. Shqetësimi poetik në vargjet e këtij cikli vjen urti e shtresuar natyrshëm në kohë, i heshtur zëshëm. Brezi tematik i këtij cikli (biblik) që bredh plot kërshtëri dramës njerëzore që nga thellësitë mitike dhe biblike në sensin e nxjerjes së të vërtetave, të mbështjella apo gjysmë të mbështjella megjull thellësisht, janë në frymën e prirjes për depërtim edhe tek shtresimet e papenetrueshme, gjithnjë në kontakt me një skenë dhe perspective prej nga njeriu gjakon deshifrim të enigmave dhe s’mundet...

E pranojmë lirikën e tillë të Bardhyl Londos që mëton pikërisht ato thellësi të cilat kanë aromën e së tanishmes, kanë ngarkesën dhe vetëdijen për hapësirën dhe kohën në të ciën ngjizen. Është ndiesi kjo, do të thoshim, është ana më e fuqishme e ksaj lirike, poezi që ofron emocione dhe refleksë parabolike në kohë dhe hapësirë. Vargjet e përfshira në këtë cikël kanë ngarkesën e rrjedhave njerëzore në kohë, sjell përjasje e ngjashmëri personazhesh mitologjike, biblike, fiksione gjenisht të gjithëkohshme, bëma dhe pamje që nxisin buisje të asocioacioneve dhe refleksë të përafërta, të gjalla, të prekshme si prani e përhershme në përditshmërinë tone. Rezatimi i ndiesive filozofike dhe morale i kësaj poezie, formatimi estetik i saj, insitimi në poentim të heshtur, të pazëshëm, poentim që shfaqet vetvetiu, si shqetësim konstant dhe përherë i zgjuar. Janë plagë-gozhdat që njerëzimi i bart që nga fillimet, në gjakim të përhershëm për t’i shëruar, - e s’mundet. Qartësia e këtij rrugëtimi dramatik në horizontin poetik të Bardhyl Londos, vetëdëia e kthjellhtë për këtë pozitë dhe perspective të tij, të njeriut, e bën të natyrshëm shqetësimin e botës krijuese të Londos. Është poezi hapje ndaj jetës që në pafundësi ndryshon dhe ribëhet. Poezi, - që nga fillimet e Bardhyl Londos, pledoaje për fisnikërimin e shpirtit, insistim për të mos pranuar rafshimin e kufirit mes së m irës dhe së keqes, refuzim indiferences përballë brutalitetit dhe dhunës, - në të njëjtën vale me bringën e Lasgushit – poeti është fajtor për çdo krim që ndodh në botë.





Mbi librin “Politika si ide” refleksione,
të VALENTINA LESKAJ, Botimet Toena, 2021

PREMTIMI I DEMOKRACISË

Ida Xoxa, PhD në Studime Politike, Romë

Kur në 1955 teoricienes Hannah Arendt Ciu propozua të shkruante një “Hyrje në politike”, ishte pikësynim i saj të mos shkruante një traktat me karakter akademik, por një diskutim mbi konceptet kyçe të shkencave politike e sociale që mund të qartësonte pyetjet kryesore lidhur me karakterin e vetë qenies njerëzore po aq sa të politikës, të asaj çka është politike. Kësisoj Arendt-i, ndonëse “Hyrje në politike” nuk e përfundoi dot në atë periudhë për shkak të ngjarjeve të viteve ‘50 dhe ‘60, por sikurse do të dalë në pah në të gjitha veprat e saj të mëtejshme, ngulmonte në rëndësinë për të përcaktuar kuptimin e politikës, duke e njehsuar atë me idenë e pluralitetit - *pluralitas* - të qenësisë së shumëfishtë, të shumësisë. Një përcaktim i përfutur nga identifikimi i vetë qenies njerëzore me faktin e të qenët *pluralitët*. Më vonë, në pasthënien e përmbledhjes së disa shënimeve të Arendt-it nën titullin “Was ist politik?”¹, publikuar në 1993, adaptimi i së cilës në anglisht mban titullin “The Promise of Politics”² (2005), theksohet pikërisht ky parim, duke sjellë përsëri në pah dimensionin realist, po aq sa idealist të Arendt-it.

Ende mbetet aktual thellimi që Arendt-i i dedikonte kësaj çështje këtu e thujse shtatëdhjetë vjet më parë, duke konsideruar jetëgjatësinë e paragjykimet që moderniteti ka ndërtuar kundrejt politikës dhe politikës. Ndaj Arendt-i na vjen ende sot në ndihmë kur mendojmë për rreziket që shfaqen nëse konsiderojmë politikën si mjet për të arritur një qëllim, qëllim që jo domosdoshmërisht gëzon legjitimitetin e justifikimit. Për një qëllim që qëndron jashtë kufijve të synimit parësor të politikës, që është liria, kujton Arendt-i, vetë parimet e politikës janë në rrezik. Mbi faktin e pluralitetit, i kuptuar edhe si larmi edhe si shumësi, Arendt-i vendos themelin e politikës. Pra, politika është pluralitet; nëse nuk është e tillë, politika nuk është, dhe pikërisht falë pluralitetit, liria politike dhe barazia mund të zhvillohen në një shoqëri.

Natyrshëm të vijnë në mend këto fjalë gjatë leximit të librit të Valentina Leskaj, ku aq fort e drejtë përkrahet i njëjti parimi i gjerë i pluralitetit me të cilin Arendt-i përcaktonte politikën vetë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe libri i Valentinës nuk synon të jetë një krijesë teorie e formës së traktatit akademik, por një thellim mbi mënyrën se si duhet ta jetojmë si komunitet dhe si individë, politikën e menduar si hapësirë lirie.

Që në fillimet e saj, shfaqja moderne e politikës si hapësirë lirie dhe barazie, sikurse e mendojmë sot, mbetet në thelb një përpjekje për të siguruar pikërisht këtë hapësirë. Sikurse shkruante Asambleja Kushtetuese Franceze, në ditën e nxehtë të gushtit teksa ngjizej Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit në vitin 1789 - laborator studimi ende sot i pashtershëm - çdo njeri lind i lirë dhe i barabartë në të drejta³. Askush, as vetë aktorët e ditëve të para të Revolucionit Francez nuk mund të imagjinonin sa të fuqishme do të mbeteshin këto fjalë në historinë e demokracisë moderne për të gjithë popujt, që pikërisht tek imaginari i barazisë dhe lirisë gjetën lemën e përbashkët ku të kultivonin çdo nismë emancipuese, çliruese dhe

kushtetuese, pavarësisht kufizimit të mëtejshëm që universalizmi revolucionar i ditëve të para pësoi, duke u shndërruar në ligjërime kombëtar e duke u trashëguar kësajoh në historinë europiane. Por edukimi i parë ndaj qytetësisë akoma përpara se shtetësisë që sot kemi trashëguar, mbetet ende një pikë referimi për shtytsat demokratike dhe pjesëmarrëse që dolën në pah në vitet e para të Revolucionit Francez dhe në valët e mëtejshme të kërkesës për liri dhe barazi gjatë shek. XIX. Sepse pikërisht pjesëmarrja, hyrja e qytetarit në sferën publike dhe aktivizmi politik trashëguan nocionin e sotëm të politikës si pluralitet; ndaj nëse politika nuk është plurale, nuk është politike. Një pluralitet që as vetë aktorët e parë të formës moderne të politikës nuk e kishin hamendësuar, mjafton të përmendet nisma e parë - lindur si një kritike ndaj Deklaratës së 1789 - e hartimit të një *Deklarate të së drejtave të gruas dhe qytetares*⁴, pararendëse e çdo argumenti themelues të feminizmit modern⁵. Mjafton këtu të përmenden Olympe de Gouges apo Mary Wollstonecraft e më tej e bija Mary Shelley, autorja e krijesës së famshme Frankenstein. Kuptimi i lirive dhe i të drejtave në të gjithë historinë europiane erdhi kësajoh i shformuar dhe i përkulur drejt lirive e të drejtave të burrit më tepër se të njerëzimit. Por mbetet e padyshimtë që, pavarësisht udhës që mori politika moderne gjatë fazave të ndryshme të Revolucionit Francez, duke u shndërruar në një regjim që limitonte pikërisht pluralitetin, politika si fenomen nuk reshti së provuari fiziologjinë e saj pluralë, nga e cila ka lindur në çdo zhvillim të mëtejshëm të rrugëtimit të popujve për liri dhe *recognition*. Nevoja për një politikë të menduar si hapësirë lirie, theksohet jo më kot ende më fort e me ngulm nga Arendt-i pikërisht pas gjëmës së Holokaustit dhe mishërimit të totalitarizmave.

Nuk mund të mos jetë një ide, politika, sepse nuk mund të mos të jetë një botëkuptim, nuk mund të zhvishet nga thelbi i saj si bartëse e një sistemi vlerash, sikurse thekson Valentina, vlera që i japin kuptim dhe përmasa edhe vete konfliktit demokratik, si element fiziologjik i pluralitetit politik që aq jetim do të ishte pa kulturën demokratike për të cilët autorja, me përvojën e saj shumëvjeçare, mund të dëshmojë në lidhje me vitet e gjata drejt një modeli demokratik shqiptar. Një periudhë të cilën, ne, fëmijët e viteve ‘90 u edukuam të quajmë “tranzicion”, një dispozitiv narrativ ky, i cili ka shërbyer shpesh si mburojë justifikuese e më pak si mjet analitik.

Botimi i “Politika si ide” shqyrton, në saje të përvojës, kujtimeve, formimit, pasionit dhe përqasjes kritike të autores, fenomenet më të rëndësishme, ende aktuale, të gjendjes së politikës së gjerë dhe të tërësisë së institucioneve në Shqipëri. Përvojë e nisur si gazetarë, aktiviste e të drejtave të njeriut dhe drejtuese e shoqërisë civile, drejtuese e Qendrës për Popullsinë dhe

Zhvillimin, për të vijuar me pjesëmarrjen në qeveri dhe postin e deputetes apo Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Kryesinë e grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe Nënkryesinë e Kuvendit të Shqipërisë, për të mos harruar praninë në dimensionin lokal të Shqipërisë dhe në kontekste institucionale ndërkombëtare në shumë vende të botës.

Një sërë temash që ndërlihen mes tyre për të krijuar një panoramë të karakteristikave dhe problematikave me të cilat jeta publike shqiptare përballet vazhdimisht, por që jep shkas gjithashtu për një thellim në modelin demokratik e sistemet politike përfaqësuese, në rang global.

Është interesante dhe shpresëdhënëse të lexosh në këtë libër që, ndryshe nga sa mund të duket nga një vështrim i jashtëm, arena publike e politike shqiptare në fazën e parë të formimit, ka pasur diskutime dhe subjekte që problematizonin rëndësinë e pluralitetit dhe të një kulture të ballafaqimit civil e të dialogut demokratik, me bindjen se cilado kundërvënie ideore të përbashkët, pikërisht si një hapësirë e përbashkët lirie.

Në shëndetin e një debati publik, edhe më publik sot se në vitet ‘90, rëndësi të veçantë ruajnë problematika si përgojimi publik, trillimi, dhuna verbale, tallja, ngacmimi dhe bullizmi kibernetik, që sheh një rritje të vazhdueshme, në deri 60% të fëmijëve⁶, apo *public shaming*, shpesh konsideruar si një epidemi që po kthehet në një kulturë të turpërimit e të përbuzjes publike. Sikurse nënvizon autorja, shpesh kjo kulturë shfaqet në një nevojë kolektive për të “shkatërruar po aq sa për të lartësuar me shpejtësinë e dritës”, si në arenën politike po ashtu në megafonin mediatik. Dhe përgjegjësia për një klimë të tillë lidhet po aq me kë kryen bullizëm sa edhe me këdo kthen kokën nga ana tjetër. Sikurse problematizohet në shumë vende të botës ku ka dedikim ndaj kultivimit të kulturës demokratike në shoqëri, një dinamikë e tillë dëmton jo vetëm viktimat e abuzuara, por edhe vetë tabanin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes në jetën sociale e politike të një shoqërie demokratike. Dhuna verbale, përsheptimi teknologjik që asimilohet në mënyrë johomogjene nga kategori e pjesë të ndryshme të shoqërisë, trajtat e populizmit dhe pasiguria në një horizont të ardhmërisë së përbashkët, i jep shpesh zë ekstremeve, por lë gjithashtu në hije një mazhorancë të heshtur. Sikurse nënvizon autorja, duhet gjetur një gramatikë politike aspak përjashtuese, që garanton ndeshjen dhe konfliktin, por pa shkualifikuar dhe delegjitimuar pluralitetin. Sikurse është pohuar në të gjitha rangjet politike e institucionale të vendeve me një retazh historik e kulturor demokratik, është shumë e rëndësishme që kultura e pluralizmit të jetë farë në kultivimin e politikës. Për shkak të elementeve identitare në të cilët shpesh politika esencializohet, manifestohet shpesh risku i shndërrimit të politikës në ekuacionin schmittian mik-armik, ndonëse si kategori që shpjegon diversitetin ekzistencial nuk përfshin antagonizmin për arsye thjesht personale. Është një risk, ai i kundërvënies mik-armik që ka linfuar një pjesë të konsiderueshme të traditës politike perëndimore, deri në format më ekstreme të totalitarizmit, pogromeve apo degjenerimit gjenocidar.

Në një realitet ku rrjetet sociale bëhen gjithnjë e më të qëndrueshme, preokupimi i rregullimit të raportit mes njeriut dhe mjetit që ai përdor, natyrisht që po orienton një pjesë të madhe të studimeve të shumë fushave, shkencore e humaniste, përveçse të institucioneve që me një fenomen aq të ri sa edhe ndikues në stofin shoqëror, po ndërmarrin

një sërë masash për të mbrojtur individët nga abuzimet dhe shkeljet me origjinë kontekstin IT, digjitalizimin dhe virtualizimin e marrëdhënieve; *EU Code of Conduct* është një ndër shembujt për kundërvënien ndaj *hate speech* në internet apo ndaj *fake news* dhe manipulimit të informimit. Por mbetet e patundshme bindja se një edukim i vazhdueshëm, që në brezat më të rinj, ndaj vlerave demokratike, ndaj historisë, ndaj lëvrimit të kujtesës dhe ndaj principeve të një politike si hapësirë lirie e barazie, është baza për të luftuar çdo tentativë manipulimi informativ e politik.

Një nga elementet më interesante të librit është p.sh. përpjekja mjaft e artikuluar për një rindërtim historik të hapave të feminizmit shqiptar. Shembujt e jetës dhe angazhimit të Selfixhe Ciu, Ollga Plumbi, Musine Kokalari, Urani Rumbo, Mila Vangjeli, Motrat Qirjazi (f. 21-22), shtigjet që hapën në një kohë e vend ku krahas vargut të Çajupit⁷ vargu i Kanunit e shihte gruan si “shakull për të bajtu”, janë pjesë tepër të çmuara të kujtesës kolektive dhe si të tilla duhet të mbahen mend e të përfshihen së gjëri në tekstet shkollore.

Duke rikujtuar rëndësinë e shkrimeve të Selfixhe Ciu Broja, autorja sjell në vëmendje një kontekst tepër të vështirë për rolin dhe gjendjen e gruas në shoqërinë shqiptare të kohës: një sintezë që përmbledh gjithçka ishte gruaja në shoqëri po edhe në familje, një qenie pa zë (f. 21). Pikërisht atë zë që në mënyrë të vazhdueshme historia e gruas ka dashur të fitojë, në një sistem gjithëpërfshirës të ndërtuar nga ligjërimi patriarkal, sikurse theksonin gratë e 1789-s e sikurse përpiqeshin e kërkonin gratë shqiptare, ku disa prej tyre zgjodhën nismën për arsimimin si rrugën më të mirë për fuqizimin e grave dhe vajzave dhe për ndërtimin e një zëri për të drejtat e tyre. Mesazh ende shumë aktual, që autorja thekson përgjatë gjithë librit ashtu sikurse ka theksuar gjatë gjithë karrierës profesionale e angazhimit të saj politik. Po aq fort sa thekson edhe rëndësinë e angazhimit të burrave në çështjen e barazisë së të drejtave të gruas, kur përmend “Frashërlinjët, që e kuptonin se shoqëria nuk mund të ecte përpara nëse gjysma e saj është e shtypur dhe e prapambetur”. (f. 23).

Si intelektuale e angazhuar, Ollga Plumbi, “nga të rrallat gra gazetarë të viteve 1930, gruaja antifashiste, ish-presidentja e parë e Grave të Shqipërisë pas çlirimit të vendit, post që nuk i zgjati shumë, ashtu si për shumë intelektualë të tjerë, që nuk e patën të lehtë ose nuk pranuan të konformoheshin me çfarë po ndodhte atë kohë, [...] kishte bërë emër qysh në vitet ‘30 e më pas, kur u bë ndër të parat gra që u rreshtuan krah burrave në Luftën Antifashiste për çlirimin e vendit”. (f. 26). Çlirimi i vendit bashkë me çlirimin e gruas, por ishte një ëndërr që nuk zgjati shumë, duke konsideruar zhvillimet e mëtejshme të jetës së Ollgës, sjellë në mënyrë të artikuluar dhe të apasionuar nga autorja, që Ollgën e ka takuar: “Ollga, zëri i të pazëshmëve lënë në harresë, jetonte në rrugën e Kavajës, mbuluar nga heshtje. Kuptohej që shfaqjen e saj në publik e bënin të vështirë kufizimet e kohës. Ishte një arsye madhore, që e bëri të mbyllë gojën e të lërë penën, gruan që dikur kishte sfiduar kohën”. (f. 30).

Përpara rënies së perdes së hekurt, por në të vërtetë edhe pas rënies së saj, “një pjesë e mirë e shoqërisë sonë feminizmin si koncept e konsideronte më tepër si shfaqje kapitaliste, si një deviancë borgjeze, madje edhe armiqësore, dhe jo vetëm në Shqipëri [...]”. Gratë ashtu si edhe burrat, kanë vuajtur gjithë pasojat e një regjimi që prodhonte kufizime dhe shkelje të mëdha në të drejtat njerëzore pavarësisht nga gjinia. Ajo që u shpall si emancipim i gruas, si orientim politik dhe krijimi i një kuadri ligjor, që garantonte të drejta të grave, pa dyshim që hapën rrugën për një sërë ndryshimesh në jetën e gruas. Qysh në fillim mbledhja e Këshillit të Dytë Antifashist, në nëntor 1944, sanksionoi të drejtat e barabarta të grave me burrat [...] dhe më pas këto të drejta u sanksionuan edhe në Kushtetutën e parë të Shqipërisë: ‘Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike e shoqërore’. Natyrisht, jo të gjitha gjërat kanë funksionuar si në letër, gjithsesi duhet thënë se arsimimi dhe punësimi; krijimi i një kuadri ligjor mbështetës;

1 Hannah Arendt, *Was Ist Politik? Fragmente Aus Dem Nachlass*, kuruar nga Ursula Ludz, Kurt Sontheimer. München, Piper, 1993.

2 Premtimi i Politikës. Shiko Hannah Arendt, *The Promise of Politics*, parathënie nga Jerome Kohn. New York, Schocken Books, 2005

3 Pararendës për temën e të drejtave të njeriut është e mirënjohura Deklaratë e të drejtave e Virginia-s, 1779.

4 *Déclaration des droits de la femme et de la citoyenne*, publikuar në shtator të 1791 nga shkrimtarja dhe aktivista për të drejtat e grave si dhe të skllërvëve nëpër kolonitë franceze, Olympe de Gouges. Konsiderohet si dokumenti i parë ku kërkohet barazia ligjore dhe juridike mes grave dhe burrave, duke vënë në dyshim autoritetin patriarkal.

5 Në historinë franceze dhe europiane Deklarata e famshme është lakuar me termin “homme”, “man”, “mensch”, burrit, maskullitet si përgjithësues i njerëzimit, derisa u transpozua në “droit de l’humanité, droits humaines”, të drejta të njerëzimit ose të njeriut. Zgjedhja semantike mbarte brenda një kufi gjinor akoma përpara se të diskutohej çështja e dhënies së shtetësisë/*citoyenneté/citizenship* në terma veçimi mbi bazë *census-i* nga formulimet e para republikane pas rënies së monarkisë franceze, e cila nuk do të ishte më kurrë e njëjta monarki edhe pas Restaurimit. Por pavarësisht kësaj zgjidhje semantike, fakti i zbulimit të politikës dhe të pluralitetit fiziologjik që e përbën, dha shkëndijën në shumë hapësira, sidomos atë të shoqatave politike që shërbyen si katalizatorë aktivizmi për bazën e shoqërisë, parisienne fillimisht, që asnjëherë nuk ishte përfshirë në aktivizëm apo në rolin e aktorit politik. Pikërisht kjo shkëndijë krijoi një parantezë shumë interesante aktivizmi edhe nga ana e grave, që tentuan, fatkeqësisht pa sukses, të merrnin fjalën në agorinë publike, nëpërmjet përpjekjes për barazi politike, në një kohë kur pikërisht barazia ishte fjala kyce e laboratorit revolucionar.

6 Sipas të dhënave <https://www.isigurt.al/> deri në 2019.

7 “Burrrat nën hije, lozin, kuvendojnë, pika që s’u bie, se nga gratë rrojnë.”

puna e bërë për çrrënjosjen e patriarkalizmit dhe veprimit të kanunit; disa të drejta si ajo e divorcit, e marrëdhënieve të pronësisë në çift, zgjatja e lejes së paslindjes për gratë nga 45 ditë në një vit, përfshirë edhe të drejtën e babait për ta marrë këtë leje, krijimi i disa kushteve lehtësuese për gratë si kopshtet, çerdhet, konsultoret e nënës dhe fëmijës në çdo fshat etj., pa dyshim që ishin elemente të rëndësishme në çlirimin e gruas. Këto i konsideroj si gjëra shumë të rëndësishme për të drejtat e grave.

Thënë këtë, nuk mund të themi se gratë në kohën e komunizmit arritën të drejtat njerëzore në kuptimin dhe vlerën që marrin ato në një shoqëri demokratike e që lidhen me lirinë e shprehjes, lirinë e besimit, të pronës, edhe pse kjo e fundit në letër ishte e zgjidhur, lirinë e lëvizjes apo të drejtën e asaj që quhet ‘choice’ ose të drejtën për të vendosur në çift për fëmijët etj.” [...].

Dhe ende mbetet thelbësore tema e barazisë së të drejtave, jo thjesht në letër, por mbi të gjitha në kulturën e një shoqërie e të një epoke që duket se ende mban përmbushjen e kuotave rozë si standard primar barazie, duke mënjeluar problemet strukturale të penalizimit të pjesëmarrjes së gruas në realizimin e potencialit shoqëror. Angazhimi i femrës në mbarëvajtjen e familjes dhe të shtëpisë, nuk konsiderohej dhe ende nuk konsiderohet mirëfilli si *labour*, pavarësisht insistimit të një pjese të feminizmit duke filluar nga vitet ’70 në përfshirjen e kësaj përgjegjësie, që kryesisht bie mbi shpatullat e grave, në kategorinë e punës së papaguar nga shoqëria, pra si pasojë një ndër format e shfrytëzimit mbi të cilin vetë sistemi ekonomik mbështetet.

Por, në një anë të botës, barazia thuhet e parajstë që sistemi komunist parashtonte, përkthehej në një dyfishim të përgjegjësi të femrës në shoqëri, punë e shtëpi bëheshin urdhëresë kategorike që, ama, nuk ribarazonin ekuilibrin e roleve gjinore dhe nuk shkëputnin rolin gjinor nga ai biologjik. Ashtu sikurse nuk vinin në dyshim radikal traditën tërësisht moderne dhe njëkohësisht arkaikë të kufizimit të përgjegjësisë së gruas në sferën domestike, sferë në të cilën impenjimi i saj nuk konsiderohej *labour*, por përgjegjësi, duke trashëguar kështu në këtë traditë që ka strukturuar historinë perëndimore që prej fundshekullit të XVII, pabarazitë gjinore së bashku me pabarazitë e tjera të sistemit.

Ky shumëfishim i përgjegjësi të gruas (në mungesë të një rishpërndarje të roleve sociale), shpesh u jepte argument pikërisht një sërë akuzave që një pjesë e së djathtës konservatore në SHBA-në e viteve ’70 akuzonte arbitrarisht feministet radikale apo reformatore, për *agenda*-n e tyre “djallëzore”, sipas së cilës këto të fundit kishin objektiv të shtynin femrat drejt një jete jofamiljare, një jetë pa tutelën e rolit të nënës, një jetë në fabrikë e në stërmundim si pasojë e barazisë ligjore në vendet e punës, të vendosnin shërbimin ushtarak të detyruar për gratë, të shndërronin gruan në një individ më të shfrytëzueshëm dhe burrin, në një individ pa detyrimin ligjor e shoqëror për “ta mbajtur” atë. Phyllis Schlafly dhe kundërvënia e saj dhe e grupimit politik Eagle Forum por edhe të grupimeve New Right, ndaj Equal Rights Amendment në fund të viteve ’70, natyrisht nuk përfaqësonte të gjithë spektrin e republikanëve, ndër të cilët e të cilat, ka pasur subjekte të angazhuara në aprovimin e kurrëarritur të ERA. Në kundërshti të plotë me feminizmin e Betty Friedan, Shirley Chisholm apo Gloria Steinem, Schlafly hipotizonte, polemikisht, pikërisht këtë shtysë asgjësuese për gruan si femër: shoqëria, sipas saj, nuk duhet të kishte detyrimin e të financuarit një shtet asistencial për të ndihmuar gratë që duke zgjedhur punësimin, linin fëmijët pa përkujdesje prindërore. Imperativi primar e më përmbushës për një grua duhet të ishte ai biologjik, të qenët nënë, së bashku me imperativin kulturor e ekonomik të së qenët grua e një burri; vetëm në mënyrë residuale, një femër mund të kishte “edhe” interesa të tjera jashtë sferës domestike. “Pse duhet të bëj dy punë, nënë e nëpunëse, nëse mund të bëj vetëm mëmësinë, pa pasur ‘nevojë’ të punoj në zyrë as edhe një ditë”, theksonte shpesh Schlafly.

Ndonëse mund të tingëllojë anakronike edhe për periudhën në të cilën shqiptohej kjo frazë dhe megjithëse nuk ka qenë kundërvënia e Schlafly elementi kryesor e i vetëm për mosmiratimin e ERA, mbetet emblematike sesi termat e diskutimit mbi rolin dhe identitetin e gruas, si nga njëra anë e globit në tjetrin janë të lidhura me trashëgiminë e përbashkët patriarkale, që lidh aq fort rolin biologjik të femrës me rolin e saj shoqëror e politik si grua e si njeri.

Një trashëgimi shumë e vështirë për t’u sublimuar, duke konsideruar sistematicitetin me të cilin operon e që aq shumë është studiuar e që së fundmi, me krizën e shkaktuar nga pandemia prej COVID-19 dhe masat emergjenciale, ka dalë rrëmbyeshëm në pah me shifra konkrete që tregojnë si dhe sa gratë janë pre e një sistemi ekonomik ku roli i tyre në tregun e punësimit është tërësisht i pabarabartë dhe menjëherë i sakrifikuashëm. Sikurse pohon Valentina, “pabarazia gjinore përbën një pengesë serioze për uljen e varfërisë dhe për zhvillim të qëndrueshëm. Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm të një vendi pa integrimin e grave në proces dhe nuk ka zgjidhje të problemit gjinor pa një zhvillim të qëndrueshëm. [...] Kur familja është e varfër gruaja është dyfish e varfër, edhe pse ajo ishte dhe mbetet personi që administron [...] gjërat bazë për cilësinë e jetës. [...] Por po ashtu gratë janë kategoria më e predispozuar për të rënë në kurthin e varfërisë dhe një nga problemet që e bën jo shumë të dukshme në agjendat, që adresojnë probleme të zhvillimit njerëzor në Shqipëri”. (f. 76).

Është shprehur mrekullisht nga çmimi *Nobel* për Ekonominë në 1998, Amartya Sen, se varfëria nuk është thjesht mungesa e të ardhurave dhe burimeve ekonomike, por edhe mungesa e mundësisë për të realizuar dëshirat, pra mungesa e lirisë për të vendosur mbi jetën tonë. Nuk mund të ishte më i qartë ky princip në praktikën e mikrokredisë së krijuar nga Muhammad Yunus, çmim *Nobel* për Paqen në 2006, nismë që sikurse njihet i ka ardhur në ndihmë punës dhe aftësive sipërmarrëse të shumë grave, fillimisht në zonën Jobra te Bangladeshit, ku nga takimi dhe njohja

me problematikat ekonomike e financiare të një vajze 21-vjeçare, Sufiya Begun, lindi një prej eksperimenteve më të suksesshme të financimit të mikrokredive, mjet që i vjen në ndihmë jo thjesht më të varfërve, por të gjithë atyre që janë përgjithësisht të mënjeluar nga qarku bankar tradicional duke mbetur vazhdimisht nën kthetrën e borxhit, dhe si pasojë të destinuar në qarkun vicioz të varfërisë dhe të pamundësisë për të realizuar resurset e aftësisë dhe *capabilities*⁸ si individë dhe si komunitet. Jo rastësisht, gratë kanë qenë element bazë dhe histori suksesi në zhvillimin e këtij mjeti, pikërisht, sepse jo vetëm janë ende kategori më pak e pajisur me mjete për të mos rënë në kurthin e varfërisë, por edhe, sepse nuk mund të mënjanohej çështjet e grave nga strategjia e zhvillimit të një shoqërie të shëndetshme.

Një tjetër faktor i përvojës dhe tematikës që autorja përshkruan, është edhe aktivizmi politik, një arenë gjithnjë e më e artikuluar globalisht, mjafton të mendojmë për kërkesat që nuk rreshtin së përqasuri opinionin publik botëror mbi tema e çështje të feminizmit interseksional - *all oppression is connected* - mbi problematikat e të gjithë spektrit gjinor dhe të orientimit seksual, mbi kujtesën kolektive dhe dekolonializimin, racizmin strukturor, integrimin, çështjet e identitetit, etj.

Për sa i përket Shqipërisë, autorja thekson karakteristikat dhe dallimet mes aktivizmit të shoqërisë civile shqiptare në vitet ’90, përkundër tendencës më tepër *donor driven* të viteve pasuese, duke vënë në pah një anë tepër të rëndësishme të mënyrës se si është strukturuar rrjeti i shoqërisë civile shqiptare.

⁸ *Capability approach*, përkufizuar fillimisht në vitet ’80 dhe përcaktuar gjerësisht nga autorë si Amartya Sen dhe Martha Nussbaum, lind si alternativë e ideve tradicionale mbi ekonominë e mirëqenies duke u nisur nga principi se jo thjesht e drejta dhe liria për të arritur mirëqenien, por mbi të gjitha mundësia konkrete për ta realizuar atë, është thelbësore në zhvillimin e mirëqenies njerëzore. Për një bibliografi të detajuar, shiko Robeyns, Ingrid and Morten Fibieger Byskov, “The Capability Approach”, *The Stanford Encyclopedia of Philosophy* (Winter 2020 Edition), Edward N. Zalta (ed.), <https://plato.stanford.edu/archives/win2020/entries/capability-approach/>

Nëse do të shtonim në këtë kontekst edhe një digresion rreth gjendjes së institucioneve e jetës publike në lidhje me fenomenin e korrupsionit, literatura do të zgjerohej në kohë dhe hapësirë, duke konsideruar raportet dhe studimet që vazhdimisht lëvrohen mbi çështjen e kapjes se shtetit, interesat e asistencës ndërkombëtare dhe interesat e donatorëve në 30 vitet e fundit në të gjithë Ballkanin perëndimor⁹.

Por mbetet e patundur bindja se roli i përfshirjes dhe i shoqërisë civile si pol angazhimi është i pashmangshëm për një shoqëri plurale dhe korale, edhe në raport me besimet fetare. Natyrisht angazhimi politik është një spektër që tejkalon thjesht përfshirjen në grupime politike apo struktura qeveritare, duke qenë fiziologjikisht i pranishëm në agoranë politike apo në krijimin e opinionit publik - për ta thënë me termat e Jurgen Habermas - ku përfshihet çdo subjekt që ka një rëndësi publike: media, analistë, akademikë, sindikata, sfera e subjekteve financiare dhe ekonomike, gjithkush ka përgjegjësinë e drejtimit, dhe natyrisht shoqëria civile. Gjithnjë e më shpesh në fakt, po theksohet rëndësia se gjithkush ka një “mikrofon” duhet të konsiderohet si pjesë e opinionformimit publik e politik. Gjithçka që ndodhet mes polit qeverisë dhe administrues dhe materialitetit të komunitetit të përbashkët kur conceptualizohet si “popull” a si sovranitet, përbën frymën publike ku manifestohen objektivat e vullnetit të përbashkët. Hapësira ku fryma publike edukohet për përfshirjen në *citoyenneté*/qytetësi, një hapësirë/sferë publike, barazimtare dhe plurale, bazuar në forcën e argumentit më të mirë dhe që ende sot vuan pikërisht një destrukturim argumentativ dhe pabarazi, është gjithashtu hapësira që ka semantizuar trajtat e demokracisë dhe të legjitimitetit politik duke trashëguar një ide të politikës si dedikim ndaj interesit të përbashkët. Ndaj bëhet thelbësor roli i aktorit politik, figurës që ka pikësëpari përgjegjësinë për të zgjedhur se cili, mes të tjerësh, është interesi i përbashkët i një komuniteti dhe cili është mjeti për ta realizuar. Pikërisht që demokracia të mos shndërrohet në një tirani të mazhorancës apo në një dispozitë demokratik¹⁰, sikurse argumentonte Tocqueville, përvoja politike moderne ka krijuar një sërë frenash, limitesh dhe mjetesh mbrojtëse për formën demokratike dhe për “zërin e të pazëshmëve”, që Valentina nuk resht së nënvizuari në çdo pjesë të këtij libri, apo për protestat dhe manifestimet e shoqërisë civile mbi çështje bazike për jetën e përbashkët. Mund të jenë protesta në rang lokal e të kufizuara në kohë, si ajo kundër armëve kimike në Shqipëri, apo më tej e më gjerë lëvizjet altermondialiste, kundër globalizimit dhe konsumizmit që kanë influencuar sferën publike globale në më tepër se njëzetë vitet e fundit. Por roli i aktorit politik dhe i përgjegjësisë së zgjedhjes politike, nuk mund të tejkalohet në një sistem përfaqësues, qoftë edhe në një formë socialdemokracie brenda sistemeve të demokracisë liberale, ndonëse shfaqen vazhdimisht shtysa teknokratike të prezantuar si apolitike e ndonëse rrezikjet për një teknologji të pamonitoruar bëjnë gjithnjë e më urgjent rrezikun e kontrollit. Mjafton të përmendet risku i monitorimit të natyrës njerëzore dhe rendit social nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit së të dhënave në modelet parashikuese të sjelljes (bihejviorizmi). Një sistem që Shoshana Zuboff e quan *surveillance capitalism*¹¹.

Sikurse pohonte Max Weber, pavarësisht morisë së subjekteve që përbëjnë pëlhurën e politikës dhe angazhimit politik, roli i politikanit nuk mund të interpretohet nga çdo subjekt: politikanin është dhe duhet të jetë faktori që merr përgjegjësinë e zgjedhjes, mes një “etike të principeve” dhe një “etike të përgjegjësisë”¹².

⁹ Will Bartlett, *International assistance, donor interests, and state capture in the Western Balkans*, “Journal of Contemporary European Studies”, 2021, 29:2, ff. 184-200; “Journal of Regional Security”, Volume 15 Issue no. 2, 2020; 2020 Report, *Examining State Capture: Undue Influence on Law-Making and the Judiciary in the Western Balkans and Turkey*, https://images.transparencycdn.org/images/2020_Report_ExaminingStateCapture_English.pdf

¹⁰ Alexis de Tocqueville, *De la démocratie en Amérique*, Paris, Gallimard, 1992 (1951; ed. original 1835).

¹¹ Shoshana Zuboff, *The Age of Surveillance Capitalism: The Fight for a Human Future at the New Frontier of Power*, New York, PublicAffairs, 2019.

¹² Max Weber, *La politica come professione*, në *Il lavoro intellettuale come professione*, Torino, Einaudi, 1948; Max Weber, *Politics as a Vocation* në *The Vocation Lectures*, United States, Hackett Pub., 2004.



Pikërisht në këtë ndërlidhje mes këtyre dy modeleve sintetizohet “thirrja në misionin politik”, sepse pa të parin i dyti nuk siguron dot rezultatin e synimeve dhe degjeneron në oportunitizëm¹³: kërkojmë lirinë, por prodhojmë tirani, duam paqe, por përfundojmë në luftë. “Njeriu duhet të bëjë atë që beson te vetja se është e drejtë dhe të përpiqet të ndikojë edhe te të tjerët, ndryshe pse ka zgjedhur të jetë njeri i angazhuar në raport me alternativa e zgjedhje të tjera të mundshme në një shoqëri të hapur (f. 145)”, thotë Leskaj.

Tepër interesant është edhe pasazhi i librit dedikuar spektrit politik majtas-djathtas, që pavarësisht tendencës neoliberalë, teknokratike apo të ekstremit të qendrës, për të anuluar çfarëdo dallimi mes poleve, nuk mund të eliminohet pa sakrifikuar edhe vetë mbarëvajtjen e çdo hapësire pluraliste dhe demokratike bashkëkohore. Një ligjërim i tillë duhet të vazhdojë të mbahet gjallë, jo vetëm, sepse polet e majta e të djathta ekzistojnë për sa kohë ekzistojnë polarizimet e interesave dhe kulturave politike, por edhe, sepse ideja e fundit të ideologjive, po aq sa e fundit të historisë (F. Fukuyama) nuk kanë shpjeguar dot zhvillimet e botës globale të sotme. Po aq sa nuk ka mundur të rrokë artikulinin dhe ndërthurjen e problematikave post-’89, teza e Huntington, që, në 1993, pohonte se vitet në vijim nuk do të kishin më për bazë konflikte ekonomike apo ideologjike, por vetëm kulturore, ku konflikti do të ishte “të gjithë kundër Perëndimit”. Në erën e antropocenit, ku ndërlidhja globale vuan pabarazi dhe shpërndarje hierarkike të pushtetit e të lirisë, po aq sa vuan kriza të tregut botëror, duket më se e tejkaluar teza se po jetojmë në erën e fundit të ideologjive.

Në libër natyrisht përmenden emra të rëndësishëm si Anthony Giddens, Norberto Bobbio, që ende sot informojnë mënyrën sesi interpretojmë sferën politike, por në të njëjtën mënyrë edhe nocione në dukje të apolitizuara si p.sh. politika e qendrës¹⁴, po fillojnë të konsiderohen më gjatë e më gjerë si manifestime të po të njëjtit spektër politik e jo thjesht si politika të moderimit, të menaxhimit apo administrimit të përditshëm, si të ishte një lloj praktike politike objektive, neutrale. Ideja e politikës së qendrës si ngjyrim po aq ideologjik¹⁵ sa mund të jenë e djathta dhe e majta është aktualisht narracioni legjitimues pikërisht i konfigurimeve bashkëkohore të teknopolitikës neoliberale (së cilës shpesh iu bashkëngjiten figura të tilla si Mario Monti, ish-kryeministër i Italisë në periudhën 2011-2013, Lëvizja Pesë Yjet përsëri në Itali (Movimento Cinque Stelle) apo, për arsye të tjera, Emmanuel Macron, presidenti i Republikës Franceze prej 2017. Një narracion aq i shtrirë, sikurse përmendet nga autorja (f. 151), saqë ka kooptuar dhe shpërfytyruar edhe kontekste politike e partiake të së majtës a së djathtës duke i paraqitur si kartela të shkëmbyeshme, për të imponuar imazhin e konfigurimit të qendrës si e vetmja hapësirë ku ka sens qeverisja, pasi ideja e së majtës dhe e së djathtës “është tejkaluar tashmë”. Vetë mohimi i ekzistencës së ideologjisë, sot, është kthyer në ideologji dhe program politik më vete, aq shpesh i përdorur nga forca dhe nisma me retorikë dhe stil populist, jo vetëm të pozicionimit të qendrës, por edhe, kryesisht, të djathta (meqenëse forma të ashtuquajtura të populizmit të majtë përgjithësisht synojnë një radikalizim të termave, si p.sh. për E. Laclau dhe Ch. Mouffe).

Aq më tepër e shtresëzuar është analiza e Leskajt e spektrit politik në vendet e bllokut ish-komunist, si në rastin e Shqipërisë, ku “kapitalizmi u paraqit si një sistem i pasurimit të lehtë [dhe mendohej se] të huajt do të na sillnin çdo gjë” e ku “për shkak të kompleksit nga e shkuara komuniste, [e majta] ka lëvizur drejt qendrës ose me raste edhe djathtas, ndërkohë që e djathta ka adoptuar disa nga idetë dhe qasjet e majta, për të tërhequr një pjesë të elektoratit,

sidomos atë pjesë që përbën fashën gri” (f. 152-7). Sikurse kujton autorja, në Shqipëri, në vitin 2009, “Partia Socialiste përdori sloganin *Përtej së Majtës dhe të Djathtës* si pjesë e tendencës për të tërhequr elektoratin që te politikja ishte tashmë edukuar të mos kishte më besim.”

Rimarr pikërisht citatin e Giddens që autorja i ofron lexuesit dhe që përmbledh pikërisht rëndësinë e manifestimit të ndasive ideore që partitë, që janë pjesë e së tërës, përmbajnë, një kulturë demokratike ku pluraliteti është baza e rregullimit të jetës publike të përbashkët:

Diskutimi mbi kapërcimin e supozuar të koncepteve të tilla, si e djathta dhe e majta, ka edhe një defekt të thellë: ai nënkupton një besim që, në botën e sotme, ka nevojë për më pak politikë nga sa nevojitej një herë e një kohë, ose më saktë, më pak ideologji, më pak parti, më pak qeveri, a thua se gjithçka varet nga të qenët të disponueshëm apo të padisponueshëm për ndryshimin intensiv, njësoj si progresi i përgjithshëm i njerëzimit. Përkundrazi, besoj se sot ka nevojë për më shumë politikë sesa më parë, për shkak se problemet botërore, që nga krizat dramatike ekonomike-financiare tek efekti serrë, demonstrojnë se vetëm një ndërhyrje kolektive, e programuar, nga një qeverisje e shëndoshë ndërkombëtare, mund ta vendosë planetin tonë në rrugën e drejtë.

Sikurse thekson autorja, duhet të shkohet përtej ndarjeve dhe konflikteve personale dhe partiake, por jo përtej politikës. Ndaj mbetet themelor principi arendian i politikës, *politika si pluralitet*, në të cilën çdo nënshtetas, çdo qytetar/qytetas gëzon përfshirje, dhe kësisoj, përfton një kulturë të pluralitetit, e cila mund të mbajë larg, nga një anë, shtysën e reduktimit të politikës në diferencimin identitar mik-armik që aq shumë informon kulturën e fidelizimit partiak dhe, nga ana tjetër, shndërrimin e politikës në monolit gjithëpërfshirës që nuk mund kurrësi të tejkalojë vetë arsyen pse ekziston politika - pluralitetin dhe agoranë publike ku ky pluralitet nxjerr në pah kërkuesat shoqërore. E mira e përbashkët duhet të përcaktohet gjithnjë në agoranë publike të polisit, nuk mund të ekzistojë jashtë saj apo në forma *otherdirected* të ndërlidhjeve shoqërore. Në këtë agora konflikti si element i paeliminueshëm i shoqërisë duhet të shfaqet dhe diskutohet, ndaj sikurse dëshmon ky libër, duhet t’i qëndrojmë bindur kërkesës së vazhdueshme të parimeve themeluese të një shoqërie demokratike, ku risku më i madh sinjalizohet të jetë jo vetëm një personalizim i mëtejshëm i politikës, por edhe shndërrimi i arenës publike në një skenë për shfaqje dhe i publikes në një “publik spektatorësh”.

Pra, me fjalët e Havel që Valentina thekson bindshëm, “teknologjia e demokracisë është e pakonceptueshme pa kulturën demokratike” (f. 188).

Kultura e urrejtjes ka depërtuar në të gjitha shoqëritë e konsideruara me demokraci të stabilizuar, mjafton të shihen shifrat për *hate crimes*¹⁶ dhe abuzimi i ligjëratës së urrejtjes që vazhdimisht mbars shoqërinë *online* dhe atë reale. Në këto kushte bëhet edhe më e domosdoshme, sikurse këshillon autorja, që institucionet, pikësepari Parlamenti, të mos adoptojnë një gjuhë urrejtje dhe denigrimi të gjithanshëm, pasi ka marrë trup “një klimë që ka lënë gjurmë në vlerësimin e shoqërisë ndaj institucionit, në kredibilitetin e politikës dhe në marrëdhënien brenda saj. Në njëfarë mënyre kjo situatë ka relativizuar e shpesh zhvlerësuar edhe vetë peshën e fjalës dhe të mendimit politik. [...] Mendoj se duhet bërë rezistencë ndaj kësaj kulture, edhe pse shpesh ka një kosto personale, po gjithsesi është një e mirë publike” (f. 274-275).

Prania e atyre që Judith Shklar konsideron *vese te rëndomta*, pra më të përhapura e më të pranishme në shoqëri, vendosin një qendër pikërisht këto problematika në dukje dytësore, por që, në të vërtetë, kanë qenë e janë trajta tepër njerëzore e që në sistemet liberal-demokratike jo vetëm dalin ende më tepër në


pah, por gëzojnë një dimension publik përveçse privat¹⁷. Sipas Shklar, e cila është frymëzuar nga mendimi i Michel de Montaigne dhe i Montesquieu, çfarë duhet të mënjanohet në një shoqëri është pikësepari mizoria që sjell mbisundimin e frikës. Meqenëse në format demokratike postulati është ai i barazisë dhe teorikisht sistemet demokratike duhet të jenë tërësisht të lira nga format e hierarkizimit të sojit aristokratik, këto sisteme - bazuar mbi principin e meritokracisë¹⁸ - kthehen, sipas Shklar, në teatër më të përshtatshëm për vese të tilla si hipokrizia, snobizmi apo mizantropia. Shtysa për të shkualifikuar kundërshtarin, politik a personal, mbi argumente kontingjence dhe hipokrizie - duke shndërruar edhe akuzuesin në hipokrit moral, sepse të gjithë jemi hipokritë në një masë apo një tjetër - dhe jo mbi bazën e kundërshtimit të argumentit apo pikëpamjes së kundërt, i hap rrugën pikërisht mizorisë. Dhe gjithashtu arena *online*, si katalizator hipokrizish, ka treguar sa solide është kjo tezë. Por, thotë Shklar, i rrezikshëm është edhe fanatizmi kundër mizorisë së përditshme, që përfundon duke u shndërruar në një formë absurde të mizorisë së kontrollit dhe të indiferencës kundrejt vuajtjes njerëzore. Pra, të luftosh në mënyrë rrënjësore dhe fanatike mizorinë e përditshme apo vese të tilla si hipokrizia, duke i shndërruar në qëllim në vete, do të thotë t’i hapësh rrugën vetë mizorisë, frikës dhe t’i kthesh kurrizin lirisë¹⁹. Pra, “vetëm duke refuzuar t’i nënshtrohesh urrejtjes, mund të jesh vërtet i lirë” (f. 313).

Problematikat e përshkuara dhe të përshkruara në këtë libër janë nga më të ndryshmet dhe sjellin një panoramë të detajuar të elementeve shqetësuese, por edhe të atyre shpresëdhënëse në kontekstin shqiptar, rajonal, european dhe gjithashtu botëror.

Janë tepër interesante, të pasionuara dhe frymëzuese pasazhet mbi përvojën si aktiviste e shoqërisë civile; mbi angazhimin e palodhur në çështjet e gruas dhe të mirëqenies sociale; mbi takimin dhe përshkrimin e rrethanave e kushteve të jetesës së gruas në fshatin Klobçisht, e cila punonte tokën dhe ushqente dhjetë fëmijë me bukë e ujë; mbi vizitën në qelinë dhe burgun ku u mbajt për 18 vjet Nelson Mandela; mbi jetën dhe aktivitetin shkencor e politik të Thoraya Obaid. Gjithashtu, përshkrimi dhe kujtimet mbi hapat drejt përfshirjes së Shqipërisë në NATO kur Valentina ishte përfaqësuesja e vetme e opozitës në delegacionin e Samitit të Bukureshtit; problematikat e rajonit të Ballkanit perëndimor; insistimi mbi rëndësinë e pranimit të “tjetrit” në gjuhën dhe gramatikën shoqërore e politike për një bashkëjetesë më solidare, kundra gjuhës së “shprishur dhe [të] urrejtshme”; theksimi mbi përgjegjësinë e mediave dhe mjeteve të reja të rrjeteve sociale; tema e bashkëjetesës fetare; puna dhe angazhimi në çështjet e zhvillimit demografik në Shqipëri dhe të moshimit të popullsisë e emigracionit; rëndësia e investimit në ekonominë e dijes, jo në “zhvillimin me fasoneri”; si dhe zbulimi i ekselencave shqiptare jashtë shtetit, janë momente mjaft interesante të librit dhe japin një panoramë “nga brenda” të shumë ndodhive dhe situatave lokale e ndërkombëtare.

Si dëshmi, libri i përshtatet mjaft mirë një leximi nga brezat e rinj, që kurrë nuk duhet të reshtin së besuari në fuqinë e tyre për të farkëtuar një botë më të drejtë. Mesazhi i shpresës mbetet pikërisht ai, që jashtë çdo mospërfilljeje e shkujdesjeje, angazhimi shoqëror dhe politik, të jetë mjeti që çdo komunitet duhet e mund të përdorë për të mos humbur kurrë kulturën demokratike që i jep linfë dhe besueshmëri institucioneve, ligjeve, sistemit në tërësi dhe mbi të gjitha, shoqërisë dhe komunitetit të përbashkët.

NJË BOTIM I RI NGA MINERVA



Pasi mbarova autobiografinë time, një sprovë argëtuese, por tmerrësisht intensive, që arrita ta realizoj në orët e vjedhura prej punës reale, asokohe u betova që nuk do të shkruaja kurrë një libër tjetër.

Por, siç duket, nuk e mbajta fjalën.

Justifikimi, nëse ka një të tillë, është se ideja për këtë libër nuk ishte imja.

Atë ma dhanë.

Ishte një dhuratë për pensionin, si të thuash, nga ata mijëra njerëz të mrekullueshëm që kam takuar që kur u largova nga GE-ja - njerëz energjikë, kureshtarë, guximtarë dhe ambiciozë, aq të dhënë pas biznesit sa për të më bërë çdo pyetje të mundshme që mund të imagjinohet. Për t’iu përgjigjur, mu desh vetëm që të vlerësoja çfarë dija, ta klasifikoja, ta kodifikoja, dhe të përdorja historitë e tyre - dhe ky libër mori udhë.

Pyetjet nuk pushuan edhe pas turneut për librin. Ato vazhduan në aeroporte, restorante dhe ashensorë. Një herë, një tip m’u afrua me not mes dallgëve në Miami Beach, për të kërkuar opinionin tim mbi një rrjet biznesi që kishte ndërmend të krijonte. Por ato janë shtruar kryesisht në rreth 150 sesione pyetje-përgjigje, ku kam marrë pjesë tre vitet e fundit në mbarë botën, nga Nju Jorku në Shangai, nga Milano në Mexico City. Në këto sesione, me një publik nga tridhjetë deri në pesëmijë vetë, unë rri në skenë me një moderator, zakonisht një gazetar i ekonomisë, dhe përpiqem që t’i përgjigjem çdo pyetjeje që më bënë publiku.

Dhe çfarë nuk pyesin - pyetje për gjithçka, nga përballimi i konkurrencës kineze, te trajtimi i njerëzve të talentuar, por të vështirë, gjetja e punës ideale, punësimi i ekipit të duhur, drejtimi në kohëra të pasigurta, mbijetesa pas blerjeve dhe bashkimeve, hartimi i një strategjie të përkryer, e kështu me radhë.

Çfarë duhet të bëj, thonë ata, nëse arrij rezultate të shkëlqyera, por punoj për një idiot që duket se aq i bën, ose nëse jam i vetmi në kompaninë time që mendon se ndryshimi është i nevojshëm, apo nëse procesi i buxhetit në kompaninë time ka mani-pulime shifrash, apo nëse jam gati të paraqes një produkt të ri fantastik dhe ata lart nuk më japin autonominë dhe burimet që më duhen?

Çfarë mund të bëj, pyesin njerëzit, nëse menaxherët në kompaninë time nuk thonë të vërtetën, ose kur më duhet të pushoj një punonjës që më pëlqen por s’ia del dot punës, apo nëse më duhet të ndihmoj në drejtimin e organizatës sime përmes krizës, të cilën kemi një vit që përpiqemi ta përballojmë?

Ka pasur mirëfilli me mijëra pyetje. Por thelbi i shumicës është ky:

“Çfarë duhet për të fituar?”

Dhe për këtë është ky libër, si të fitosh. Ndoshta asnjë temë tjetër nuk do më kishte shtyrë që të shkruaja sërish!

Jack Welch, pjesë nga parathënia

¹⁷ Judith N. Shklar, *Ordinary Vices*, Belknap Press of Harvard University Press, 1984.

¹⁸ Pavarësisht ngjizjes polemike dhe ironike të këtij termi nga Michael Dunlop Young, *The rise of Meritocracy*, London, Thames & Hudson, 1958, termi ka informuar çdo sistem liberal demokratik.

¹⁹ Judith N. Shklar, *Ordinary Vices*, Belknap Press of Harvard University Press, 1984.

¹³ Maurizio Bonolis – Lorenzo Sabetta, *Verso una congiunzione funzionale delle due ‘etiche’ weberiane*, Quaderni di Sociologia [Online], 81- LXIII | 2019: <http://journals.openedition.org/qds/3483>.

¹⁴ Gjenealogjia e së cilës është po e njëjta me sferën politike majtas-djathtas, në kontekstin e Revolucionit Francez.

¹⁵ *Ideologjia* e nënkuptuar në sensin përshkrues, si “një sistem idesh dhe idealesh të caktuara, të një grupimi të caktuar”, përkundër negativizimit politik të mëpasshëm të termit, operuar fillimisht nga përcaktimi që u dha nga Napoleon Bonaparti dhe kësisoj i përdorur në vijim nga Karl Marx dhe e gjithë tradita politike europiane.

TRIGJETHËSH I GJELBËR ME BOJËRA UJI

Ndodhem në një ëndërr. Jo në ëndërrën time.

Jam veshur me të bardha dhe po grindem me një grua të veshur po si unë. Ajo ka një çelës në dorë. Më tërheq për flokësh dhe më mbyll në një raft muri. Ngjan me musendrat që mbajnë erë tërfili të thatë. Rafti ku më kanë burgosur vjedh pak dritë ngjyrë vjollcë.

Iu luta të më shkonte një kryq mbi trup më mirë. E pashë në sytë e saj që donte t'më vriste. E nuhata se ajo po përgatitej. Nuk më kujtohet mirë si munda të shpëtoj.

Të dyja spekulua në ëndërrën e tij.

Fytyrën e kam të butë, të bardhë si të larë me qumësht. Buzët më djegin nga puthjet e egra. Ai më mban për dore, më tërheq drejt vetes. Ajri është elektrizuar, në ëndërr ai mbaron.

Dua të dal nga ëndrra e tij, të kthehem në shtëpinë time.

Nuk më le të iki.

Ma shtrëngon dorën, sytë i ka të lagësht dhe më lutet. Ka përgatitur një kanistër të vogël me kuvertë të leshtë dhe më shtrin atje. Unë s'dua të jem një kotele. As ajo.

Nuk shmang dot as të qarat e saj. Mua nuk më kanë pëlqyer lidhjet e lehta. Gris një copë të fustanit tim të bardhë, ia fshij lotët. Më duket sikur ajo qan me lotët e mi. Duhet të bëhemi gati. Ëndrra ngazëlluese. Asnjëri nga ne nuk është mjaftueshëm mirënjohës.

Ja kështu!

Më duhet ta përqafoj dhe jashtë. Punën e kam më të vështirë sesa duket. Pres të zgjohet. Jam ngushtë në ëndërrën e tij. Do të mundohem të plotësohem.

MË BËHET SIKUR BIE

Mbrëmë më vajti ters e nuk të prita dot.

Ca të pathënave nuk u jap dot trajtë, i shpërbëj e i fsheh nëpër mendje aq thellë, saqë po të mendoj se duhen zbardhur, dridhem. Me siguri rrethanat e pafavorshme për t'i dalë faqebardhë jetës vijnë e më takojnë kur vjen rasti i pavolitshëm.

Si nuk më mbetet gjë tjetër për t'ia dalë hullisë që kam ndërtuar vetë, gatuaj. Ah, kujdesi im, në krahasim me atë që duhet të bëj, ka një shije të stërholluare gruaje!

Një dridhje e dukshme nxjerr në pah merakun e vjetër se papritur mund të vdes. E marrtë djalli njeriun fytyrngushtë, i cili nuk le kuptim pa shkoqitur dalldinë e çdo lëvizjeje të sajuar nga vogëlsia e jetës që ka bërë.

Unë dua ta gëzoj jetën së tepërmi, por kryesisht nuk më ecën siç e përfytyroj.

Mbrëmë nuk kishte ujë. Një pompë e vjetër që kishte ndërruar ngjyrë nga vitet bënte zhurmë brenda kokës sime. Mendimet m'u çoroditën dhe u ktheva më këmbë nga vendi ku kisha ndërmend të nisesha. Si mundem ta përshkruaj se mes gjithë atij turbullimi të brendshëm më duhet të mbaj një qendrim të përzemërt me zhurmën dhe me etjen që ndiej. Kam jetuar me një farë krenarie të paarsyeshme dhe në një vështrim të parë dukem e lumtur.

Mund të sillem sipas qejfit tim, por kjo nuk është aspak një padjallëzi e çiltër, vetja më bën shpesh shërbime të fshehta të cilat nuk kam si të mos i pranoj.

Ndonjëherë, siç e thashë më parë, kur mbaroj dënimet që i jap vetes, gatuaj. Vetëm duhet ta ndiesh se ç'efekt më jep të gatuarit.

Që atë çast nanuris një supë. Dikush mund të përqendrohet në një soditje të papërfillur, punë supe. Unë trazoj e përqendruar supën e kobshme, megjithëse të tjerët nuk rrinë dot pa shprehur një farë habie për përkushtimin tim të denjë me gjeste të ëmbla gruaje.

Ky mister i supës, i gatuar me rrepa, halle e dëshira të fshehta, qepë e karota të

NUHATJA E NJË PESHKU TË KUQ

tregime nga Esmeralda Shpata



freskëta toke, më josh. Të gjitha këto perime të zymta e gënjeshtare ziejnë e fjalosen me njëra-tjetrën dhe më lënë pa mend. Trupi im i kolmë, i ri, me gjak të pastër, me lëkurën që ndrin nga shëndeti, bie.

Në tenxheren time shfaqen vegime të tmerrshme të së ardhmes. Të vdekurit kanë bërë gati lugët dhe presin të hanë supën.

NUHATJA E NJË PESHKU TË KUQ

E pritë dy orë të gjata, sa katër iu dukën, pranë stacionit ku ajo ndalonte. Autobusi erdhi, njerëzit vraponin për t'u shpërndarë si në arrati nëpër qytet. Ajo doli, një xhup të lehtë mbante në dorë. Shikonte majtas e djathtas për ta gjetur. U panë.

Ai u ul në gjunjë, nuk ishte aristokrat i shekullit XVIII, i puthi dorën e më pas e përfshiu në gjoks.

Sado i përmbajtur të jetë një burrë, kur vjen puna për mos të treguar ndjenjat e veta, ai është një peshk i kuq.

- Të dua moj kumbull lojcake!-i tha.

Ajo u turbullua, as hapat nuk po hidhte dot më tej.

Burri hapi krahët e tij gjigand, e përfshiu për beli dhe e puthi fshehurazi në kokë.

Një lot iu rrokullis faqeve, nga ata të nxehtit, që djegin nga malli për dashuritë e thella.

Këtë herë e kapërdiu trishtimin. I paraprirë nga një mendim, se padashje

mund të prishet gjithçka, e fshiu lehtë me kurrizin e dorës dhe vazhdonte ta puthte në flokë të dashurën.

Ajo një natë më parë kishte vrarë veten.

Dhimbja therëse ndërsa shihte thikën të lyer me gjakun e saj të ngrohtë, u përhap me shpejtësi në të gjithë trupin. Sapo pa njerëz që e rrethuan lotët i rrodhën çurg, aq sa ndjeu veshët që lageshin. E ëma i mori kokën në prehër dhe pandehmat se u çmend, ditë më pas, dolën të pavërteta.

I ati, një burrë i errët dhe i heshtur, uli kokën mbi të dhe me ata gishta të akullt po shtypte me mollëza të çarën nga ku po derdhej gjaku me forcë.

Shyqyr, fati e deshi që nuk kishte motra, ato do ulërinin nga dhimbja, po të ishin. Koha do t'i shëronte, por më mirë që nuk ekzistonin fare.

Përnjëmend, deri këtu ishte gjithçka në rregull me vetëvrasjen. Një fakt tjetër, po aq kryeneç, kishte një fytyrë me historinë e saj, kishte tre fëmijë të mitur. I shoqi pati ngrirë me duar të mbërthyera, nuk qe i zoti të nxirrte nga gjoksi asnjë tingull. Lotët ishin aq të nxehtë sa mend vratat e tyre nuk u fshihen faqeve sa të jetë.

Mësymja e beftë e gjithë kësaj pamjeje ia ndryshoi mendimin për vetëvrasje, me një tufë psherëtimash e futi thikën e mishit në sirtar dhe doli nga shtëpia.

Si u përqaftuan atje afër asaj ndërtese fatakeqe, ai e kapi për dore dhe mori drejtimin në një rrugicë ku ishin parkuar taksitë. I zgjati një kartmonedhë shoferit

dhe adresën për diku, gjetiu.

E ndihmoi gruan të ulej në sediljen e pasme, u gjend pranë saj dhe ia mblodhi duart e ftohta me duar. U frynte me buzë, i shtrëngonte, i ngrohte me sy. Nuhaste thellë me hundë. Tendosja e trupit ndihej, xhamat e taksisë u veshën me avuj nga atmosfera. Si rastësisht i prekte gjunjët dhe gishtin e madh ia shëtiste poshtë mëngës së trikos.

“Hyjneshë”, i pëshpëriti pas qafe.

Me një dridhje të thellë i përgjigjej ajo dhe sakaq, shoferi reshti së ekzistuari.

Buzët e tyre u bashkuan, ajo pastërti mishërash i ktheu në një përpëlitje të vetme që vibron, kushedi nga çfarë ngërçesh të çliruara në thellësi të trupave të tyre.

Puthjet qenë të shturura, të bukura e përvëluese, duart e tij rrëshqitën me vrull drejt gjinjve. Ato u kapërthyen në një plotësi të mrekullueshme. Ajo dridhej, i merreshin mend dhe dëshira e fortë e çonte në yje. Ai çmendej nga kënaqësia. Kur ajo i kërkoi mëshirë, kërkesa ishte e tmerrshme, e tërbuar, e panginjur, një kafshë e lashtë sa bota. Akti dashuror, përmbushja, psherëtimat dhe amëzat e thella i kaluan skajet. Brenditë shpërthyen në spazma të forta kënaqësie, nga ato të provuarat rrallë ose fare.

Ai i puthi sytë, e donte femrën shumë më shumë pas. Pa asnjë pozë ceremoniale ia vuri duart në buzët e nxehta dhe i tha “Të kam!”.

Shoferi parkoi në një vend dhe kohë të papërcaktuar, pa diell dhe ujë, aty ku s'mund të jetë askush që s'ndien.

POTHUAJSE TY

Para meje je ti. Kam gjithë jetën që dua të të takoj. Dua të takoj patjetër. Fytyra jote tani ka marrë një fizionomi të qartë, kjo u ndodh burrave, ata dallojnë pas kësaj moshe. Ka dhe një detaj tjetër, i cili të shpërfaq, vërshimi i dritës dhe ajrit të freskët.

Ty nuk të duhet çfarë mua më shkon, ndaj druhesh të më zgjasësh dorën. Më thua se unë jam një blasfemi. Arsyen nuk ma thua. Dua të jem e bukur dhe e ndjeshme për ty, në mënyrë që të kesh një arsye të fortë për të më parë.

Unë dua t'ua kaloj të gjithave. Edhe për këtë kam arsyet e mia.

Unë kam ndërtuar një skemë në mendje, ajo është me tre lëvizje, parë nga jashtë duket trekëndësh barabrinjës, kur ndodhesh brenda, (unë ndodhem brenda), këndet ngushtohen sa të marrin frymën. Unë prirem të kafshoj, i ngul dhëmbët këndit ku ndodhem dhe e brej aq sa të mundem të hap një shteg.

Në këtë mënyrë unë pa e kuptuar kam ngrënë brinjët e mia, kjo është një mënyrë jodjallëzore që të hapem me botën.

Moti jashtë është i shkëlqyer, por jo skema që unë kam ngritur. Ajo tani është një figurë e grisur, pa kulme.

Nuk kam ç'të them për jetën që bëj. Gjithmonë që kam menduar ta njoh më ka pushtuar frika dhe jam tulatur.

E pranoj që prita gjatë të të gjeja, kjo është shpirtin tim me gjuhë ashtu si gjirafa veshin.

Kush është i pavëmendshëm mendon se po përsiat për një temë të humbur dashurie.

E vërteta është se nuk kam ç'të them për këtë, nuk jam unë e detyruar ta kuptoj pozicionin ku ndodhem. Mua më duhet të zhytem te skema që kam mbetur peng.

Me frikë të madhe dhe jo pa admirim, nuk mundem të rri pa thënë ca të vërteta tronditëse që sapo i zbulova, sigurinë e të qenit e vëmendshme dhe zemërimin tim të vjetër.

E dhe sot e kësaj dite, sa herë që shkoj në stacionin e pritjes, në atë stacion ku më vjen vetëm pikëllimi, i shoh të njëjtit zogj me të cilët Loni, krejt rastësisht, krijoi një miqësi të çuditshme. E di që ka qenë një ditë e zymtë vjeshte me rrugë boshe. Kishim ndaluar në stacionin e pritjes, sepse një ditë më parë, postieri më kishte thënë ta pres aty, sepse do të më sillte një letër të çuditshme. Ishim fillikat, unë dhe Loni.

-Çka po presim, - pyeti Loni.
-Postierin.
-Ai nuk do të vijë!
-Do të vijë.
-Nuk do të vijë.
-Pse?
-Sepse është lodhur nga pesha e përmbajtjeve të letrave.

Mbeta pa fjalë, sepse nuk e prita një përgjigje të tillë nga ai. Kjo, mbase më shkaktoi një shqetësim. Pas pak, u dëgjuan ca trokëllima nallanesh dhe pranë nesh kaloi një vajzë e vogël, e cila sapo na shikoi përvajshëm, u zhduk në errësirën e kthinës së parë. Në atë çast më kaploi një ankth i turbullt dhe ndjeva se do të plandosem.

-Të ikim, - thashë.
-Të presim edhe pak.
Nga dritarja e hapur sipër nesh, sakaq erdhi një zë i trishtueshëm, që më shumë i ngjante një klithme gruaje. Më kaploi një ligështim dhe u përkula duke marrë rëndë frymë.

-Janë klithma të lindjes, - thash unë.
-Lindjet janë të rënda, - tha Loni.
Pastaj dëgjuam shkurt vajin e foshnjës, sepse dikush shpejt e shpejt i mbylli dritaret dhe sërish pllakosi heshtja.

-Po vonohet postieri.
-Duhet të jetë afër, sa nuk e ka shpërthyer errësirën.
Nga valixhja e vogël, të cilën e mbante në krah, Loni nxori sandviçin e tij dhe më këqyru ngulshëm.

-Kam uri, nuk duroj dot.
Ndërkaq unë sikur gëlltita një grusht me zemërim, sepse sikur diçka përbrenda meje më thoshte se kot jemi duke pritur. Pastaj, seç u dëgjua një fëshfërimë dhe nga errësira dolën ca zogj, të cilët u lëshuan para këmbëve të Lonit. Kurse ai, pa u hamendur fare u ul, e grimcoi bukën dhe filloi t'i ushqejë zogjtë. Kurrë nuk m'u shlye ajo pamje, ai gëzim që ia përshkoi fytyrën bashkë me sytë e përlotur.

-Babi,-tha ai me një zë të ngjirur, unë nuk kthehem në shtëpi, do të fluturoj me zogjtë nëpër qiell. Do t'i zgjojmë mëngjeset atje ku mungon dita, pastaj...pastaj do t'i gëzojmë lulet, do ta sjellim pranverën...do të...
-Oh, Loni im, po ne s'mund të fluturojmë, - i thashë butë.
-Do të fluturoj, do të fluturoj...do të shkoj larg, shumë larg...

MONA LIZA

tregim nga Shkëlzen Halimi



Ndjeva një shtrëngim në kraharor. Ndjeva se po zhdukeshin në atë humbëtitë nate që po mbushej me një pikëllim. Ndjeva një harlisje të mendimeve që po fundoseshin në humnerat e kujtesës. Po mbytesha i përflakur në thellësitë e dhembjes. Dhe, kur mendova se do të plandoseshin mbi kalldrëmin e lagur, befas para meje u paraqit një plakë e lodhur, e cila në dorë më lëshoi një zarf të verdhë. E dëgjova tek më tha shkurt: te pret – dhe aty për aty u zhduk tej tymit që vinte nga helli i shitësit të gështenjave. Më kishte shkruar dikush me emrin Mona Liza: “në ora njëzet e tre më prit pranë telefonit”. Kur pas shpërqendrimit erdha në veta, pashë se Lonin nuk e kisha pranë. U tmerrova. Thjeshtë më lëshuan këmbët dhe rashë në gjunjë duke dënesur. Nuk e di se sa kam dënesur, por e di se sikur u turpërova kur pashë gruan që mbante mbështetur në gjoks foshnjën e saj.

-Zotëri, jeni mirë, - më pyeti ajo.
-Nuk e di.

-Po pritni dikë.
-Po, postierin plak.
-Postieri ka vite që ka vdekur.
-Ka vdekur.
-Po dhe na ka lënë shumë keq.
-Duhet të shkoni se do të ketë shi.
-Po e pres tim birin.
-Ku është ai?
-Nuk e di, ishte këtu, thjeshtë u zhduk...nuk e di...e di, e di, Loni do të kthehet...
-Lonin po e mbaj në gji.
-Lonin?
-Ja tek e ke Lonin...Do ta ruaj unë...

Dëgjova një murmurimë mbytëse dhe sakaq, si një litar, shpërtheu rrebeshi i shiut, sa që në afërsi nuk shihej as gruaja e as shitësi i gështenjave. Pastaj, si i marrë kam vrapuar nëpër rrugët e qytetit me shpresë se do ta gjeja Lonin. Pak para orës njëzet e tre, i bërë qullë, u gjeta përballë ndërtesës, ku jetonim në banesën njëdhomëshe. I këputur deri në rraskapitje, u ula të pushoj pranë ashensorit të prishur, sepse më priste rrugë e gjatë deri në katin

e trembëdhjetë. Teksa po mbushesha frymë para derës, ndjeva se zogu i orës së vjetër cicëroi njëmbëdhjetë herë dhe po në atë çast kumboi cingërima e telefonit. Shpejt e shpejt e hapa derën dhe ia ngjita kufjes, duke rënë përmbys.

-Jam Mona Liza, - dëgjova një zë femre, - a të kujtohem?
-Mona Liza!
-Natyrisht, nuk të kujtohem, se ka vite e vite që nuk jemi takuar.
-Ndoshta...nuk e di...unë...unë... kujtimet nga e kaluara i kam palosur në albumin që është i mbushur përplot me dhimbje e pikëllim dhe gjithmonë kujdesem që të mos i shfletoj ato mijëra faqe, thjeshtë për të mos i ngacmuar plagët...

-E di...e di...kurse unë kam qenë e burgosur në një skëterrë dhe po mos të ishte ai zogu ynë, ai me flatra të bardhë, me siguri se qysh moti do të isha e harruar nga të gjithë. Më mbajti në jetë. Por, ndodhi diçka e kobshme, zogu u zhduk pa nam e nishan, ndaj dua që sërish të ma pikturosh atë zog, të lutem...
-Po unë nuk jam piktor...alo...alo... alo...

Sa herë që shkoj në stacionin e pritjes, gjithnjë duke shpresuar se do t'më kthehet Loni, i vërej të njëjtit zogj, të cilët më afrohen pa frikë, sepse e dinë se u kam sjellë ushqim. Dhe, gjithnjë zogu i njëjtë, me krahë të bardhë, më ngjitet në sup dhe më pëshpërit diçka, por që unë nuk e kuptoj. Kur fillojnë të bie pikat e para të shiut, e shi, çuditërisht, bie sa herë që shkoj në atë stacion, zogjtë menjëherë zhduken në qiellin e turbullt. Me lot ndër sy e përfytyroj kthimin e Lonit, e përfytyroj çastin kur u miqësua me zogjtë, pastaj edhe plakën, duke ma sjellë zarfin e verdhë. Kur në orët e mbrëmjes kthehem në dhomën time të vogël, në katin e trembëdhjetë, vazhdimisht, pak para mesnatës, cingëron telefoni. E kapi kufjen, por veç një frymëmarrje të sforcuar, nuk dëgjoj asnjë fjalë. Ndërkaq unë mendoj se ajo frymëmarrje e sforcuar është e Mona Lizës, zëri i së cilës nuk depërton deri te veshi im, për shkak se pikërisht në atë moment, zogu i orës cicëron dymbëdhjetë herë. Në fakt, është një cicërimë e përvajshme, një cicërimë mallëngjyese, të cilën e dëgjoj vetëm unë dhe Mona Liza e humbur diku në sferat e pakapshme, ku qëndron e mbyllur duke pritur zogun e saj, pikërisht siç e pres unë Lonin tim, i cili shumë kohë më parë më pati thënë se nuk kthehem më në shtëpi, se do të fluturoj me zogjtë nëpër qiell...

**ANKTHI, ANKTHI ËSHTË
TRASHËGIMTARI IM**

Ankthi, ankthi është trashëgimtari im
plaga ime në fyt,
britma ime e botës
Tani ngurtësohet shkumbë e qiellit
në dorën e madhe të natës
tani ngrihen pyje
dhe lartësi të ngurta
shterpe drejt qiellit
drejt hapësirës
së tkurrur qiellore

Unë kërkoj me duar në këtë hapësirë të errët
ndjej tehun e mprehtë të shkëmbit në gishtrinjte e mi
unë i rjep gjak duart e mia, të ngritura lart kah lecat e ngrira
të reve
Ah, unë i gërryej thonjtë
unë i gërvisht duart e mia deri në plagë, e dhembje
nëpër male e pyje të errëta,
nëpër hekurin e zi të qiellit
dhe nëpër tokën e ftohtë.

Ankthi, ankthi është trashëgimtari im
plaga ime në fyt,
britma ime e botës

**KUSH KALOI PRANË DRITARES SË
FËMIJËRISË SIME**

Kush kaloi pranë dritares së fëmijërisë sime
dhe la frymën aty
kush kaloi nëpër natën e thellë të fëmijërisë sime
që ende është pa yje.

Me gisht vizatoi një shenjë
në xhami e mjegulluar
me butësinë e gishtit të tij,
dhe vazhdoi tutje në botën e mendimeve.
Më braktisi
përgjithmonë.

Si mund ta shpjegoj këtë shenjë,
shenjën e avullt nga goja e tij
Qëndroi aty për një çast, por jo mjaftueshëm
që të mund t' i jap një shpjegim.
Përjetësia e përjetësisë nuk do të mjaftonte për të shpjeguar.

Kur u zgjova në mëngjes qelqi i dritares
ishte krejtësisht i kthjellët
dhe unë e pashë botën vetëm ashtu si
është.
Gjithçka më dukej e huaj
shpirtin e kisha përplot vetmi dhe shqetësim
matanë xhamit.

Kush kaloi pranë,
pranë natës së thellë të fëmijërisë sime
dhe më braktisi
përgjithmonë.

ZEMRA IME ËSHTË NJË VETURË

Zemra ime është një veturë që këlthet natën.
Unë ulem dhe dëgjoj se si lëvizë nëpër errësirë dhe përmes
qytetesh që shkëlqejnë si xhevahirë të dendur.
Më në fund e shoh tek më pret,e zezë dhe e zbrazët, pranë
portës sime. Unë qëndroj në dritare dhe e shikoj
fshehurazi, është e vërtetë,
Por unë e dërgoj dikend poshtë duke i thënë: nuk e kam
porositur këtë veturë, nuk e kam kërkuar zemrën time.
Dhe përsëri qëndroj vetëm. Dëgjoj një veturë që lëvizë nëpër
errësirë dhe dritë.

ZBUKUROHET VENDI KU KALON TI

Zbukurohet vendi kah kalon ti
toka, shtegu, bregdeti që ti e ndjek,
gjithcka duket se ndriçon, gëzohet,
çdo gjë që të shih ty

Vallë a mund të gëzohet toka
se dikush ecën mbi të,

Çmimi Nobel 1951

**GJITHÇKA DO TË
HARROHET**

poezi nga Pär Lagerkvist

Përktheu Qerim Raqi

që shkelë mbi të,
që e do?

Mos më pyet mua. Unë shoh vetëm imazhin,
sesi të mbështjellë
ngrihet mbi tokë
sikur toka të buzëqeshte.

Shkel aty ku gëzohen duke të parë të lumtur.
Por shkel butë
me mendimin se të duan.

GJITHÇKA DO TË HARROHET


Gjithçka do të harrohet. Të gjitha fatet njerëzore
do të zbresin poshtë shkallëve të shkumëzuara të harresës
për t' u shuar në errësirën e fundit.
Ghithçka do të shuhet. Tragjedia do të marr fund, skena
ndriçuese do të shuhet, të gjithë yjet në qiell që kanë
parë ngjarjet e tmerrshme të dramës,
të pakuptimtë dhe të varfër me ligësinë e saj
Skena e zbrazur, dekoracionet e ndyra
dhe shpata e vogël helmuese që njerëzit e kanë përdorur
kundër njëri-tjetrit e hedhur në plehëra.

Harrimi, heshtja. Asgjë për t' u kujtuar.
Askush s' mund të kujtojë.
Zbrazëti.

Ishte kjo e tëra?
Nuk e dimë

Me sy të mplakur shikoj të shkuarën.
Gjithçka është e largët.
Një rrugë me kalldrëm,
me qetë e lodhur mbrëmjes që kthehen në stallë,
një qerre e ngarkuar, një gjurmë e rrotës së vjetër, dera gri
e hapur e stallës
me dritë në njëren dritare
Livadhet rreth përroit
mjegulla mbi ujin e errësuar

Përse e kujtoj këtë? Çfarë ka të bëjë kjo me mua?
Jeta ime shkoi shumë larg
në një kohë tjetër. Si një botë tjetër.
Dhe tani gjithçka shkon kah fundi
s'ka rëndësi



ku ka lindur njeriu
ku ka filluar jeta e tij
për të përfunduar pastaj portave të vdekjes
çfarë do të thotë kjo?
Një rrugë me kalldrëm,
një qerre e ngarkuar, një gjurmë e vjetër rrote

Shpirti im është përplotë varfëri mbrëmjes
dhe nga ndriçimi i fanarit të vjetër të ahurit
kur flinin shtazët në gjumë të rëndë.
Pastaj bartej drejt shtëpisë
dhe ndriçimi regëtues mbi hyrje të kopshtit që nuk është më
dhe dëgjohet shkalla e thyer nga një njeri i vdekur qëmoti
Gjithçka është shumë e largët.

Shpirti im është përplotë varfëri mbëmjeje
dhe nga ndriçimi i fanarit të vjetër të stallës
në hyrje të ahurit që nuk është më.
Shpirti im? Çfarë ka të bëjë shpirti im me këtë? Me livadhin
përreth përroit.

Shpirti im është i përzgjedhur për të kërkuar largësitë,
gjërat e fshehura, të shtegëtoj nën yje.

Një rrugë me kalldrëm, një qerre e ngarkuar, një gjurmë e
vjetër rrote

Me duart e bëra grusht dëgjojmë fjalët,
fjalët e mëdha të pakuptueshme për shpirtin e njeriut,
me grusht pranë një tavoline të vjetëruar
ku muzgu ka ikur, një libër i vjetër
është vënë aty në qetësi, në qetësinë mbitokësore.
Një yll nga një vendi i largët qëndron mbi çatinë e ahurit nga
lëndina e të vdekurve
në mbrëmjen e vjeshtës së vonë.
Aty hyn dikush me hapa të rëndë
dhe e lëshon fanarin aty tek dera
dhe depërton në shkëlqimin e hënës.
Tani nuk mungon askush.
Por të gjithë janë të vdekur.
Edhe ata jetuan nën shkëlqimin e hënës
kur përfundonte dita e tyre e rëndë nga puna
Së bashku uleshin në atë shkëlqim të qetë,
një yll i vetëm- jo, i të gjithëve, i të gjithëve.

Së bashku...
Pranë një tryeze të vjetër.
Me duart e mëdha të lodhura.

Përse e kujtoj këtë? Çfarë kam unë me këtë?

Shpirti im, digju i vetëm në zjarrin tënd të errët!

Një i huaj jam unë, u linda i huaj.
Akoma një i huaj në vjeshtën e jetës sime.
Me sy të mplakur e shoh të kaluarën.

Prej nga vijnë? Çfarë është shpirti ynë?
Një mjegull mbi errësimin,një ndriçim fanari, ylli?
Me dorën në syrin tim të mplakur, që dikur ishte i një fëmije-
... kopshti i të vdekurve
në mbrëmjen e vjeshtes së vonë.

Aty brenda hyn dikush me hapa të rëndë,
dhe e vë fanarin pranë derës
dhe depërton në shkëlqimin e hënës.
Tani mungon dikush...

Përse e kujtoj këtë?

Rrënjake

Mos numëroni!
Mos numëroni,
frymëmarrja e fundit a numërohet?

Ti zogëz,
që s'arrin të numërosh degët për foletë e tua,
që harron pranverat e pakthjera. Ndal numërimin!

Mjaft na numërove, oj tokë,
që ripërtrirja jote është kalbja ime.
Se si t'i këpus unë rrënjët e mia?
Zgjatuar janë flokëve të mia, e nëpër gjinj, nëpër kofshë, e
poshtë në shputë...
...atje me lidhin me nënën,
i kalojnë asaj nëpër fytyrë, nëpër gjinj, në bark, nëpër këmbë,
shputë... ..tek gjyshja,
kalojnë nëpër gjinj, në bark, në këmbë, në shputë... ..nga
shputa tek stërgjyshja,
kalojnë te stër- stër gjyshja, te katragjyshja.

ndërrojmë tokë,

rrënjët vazhdojnë të lidhen, kalojnë, zgjaten,
l+i+dh+e+n
kalojnë dyndje të popujve, police, kalojnë shpella, dy
shkronja *MA-MA*,
rrënjët

z
gj
a
t
e
n
|
z
gj
a
t
e
n

-lindin dy djem.-
Nëna- rrënjët në mollë.
Molla mu në zemër të tokës.
Gjysmë hëna e pa këtë gjamë.
Dhe nisi numërimi.

Dhëmbët e orës

Rrokullisem nga dita në ditë si
ortek bore mbështjellur duar e këmbë
nën postejllkat e lurekut.

Me zërin e nënës sime
dikush vjen pas dere
dhe m'i këndon dy-tri ninulla
që të më kujtojë robërinë time.

Ditët sjellin vjeshtën
që të më përkundë në bojën e saj baltore.
Pastaj shushuron shiu dhe lan tatuazhet që m'i bënë
dhëmbët e orës.
Dhe rreth e më rreth vijat ngjyhen me ngjyrën e gjakut
tim.

Gjaku im pekmez, që nuk duron të vlojë në kohë.

Rrokullisem nga mali i syve të mi,
kush ta shohë të rënë ndanë trotuarit,
lëreni anësh atë këpucë të veçuar nga historia.

Fytyrën ma mori vjeshta

Dëgjoj zërin e pendesës,
zërin e kohës që s'kthehet
njësoj si kjo ditë e mugëtuar
në këtë vend shirash të trishtuar
në këtë vjeshtë që ec me fustanin e saj të verdhë
anë e më anë detit,

S'të kam harruar zemra ime,
mot i ftohtë bën këtu në tokën time
përrenjtë ndalën rrjedhën,
as diell, as ditë.

S'të kam harruar shpirti im,
ndonëse zemra m'u helmua

RRËNJAKE

poezi nga Nurie Emrullai

nga urrejtja që të desha tepër,
që s'të kisha, që vazhdoj mos të të kem.

Dhe vazhdoj të të kujtoj,
si një refren të pashkëputur,
si një gur unaze të humbur,
si një yll që e pash teksa shuhet.

Vazhdon të më mbushet zemra
me plagë e urrejtje,
me mall e pritje,
që të kisha dhe u humbëm.

O, dashuria ime
sa më kujtohen ditët e këtyre vjeshtave
sa flokët më nuk m'i zë asnjë rreze
se si këtu e përgjumur në këtë kllapitje vetmie,
Unë ende gënjehem se do të shpëtoj,
se do t'i ik vuajtjes
se melankolia është e njëtrajtshme
dhe se fytyrën akoma s'ma ka marrë.

Rruga Baharian

Pulëbardhat kanë filluar luftën e ajrit,
këlthitjet e tyre çajnë qiellin e zi,
sikur çdo mjegull e ndajnë për kokë...

asaj i ra alarmi. 22 e 45 piu barnat.
ora 23 e 10 shkoi të shtrihet.

Ora tre e mëngjesit.
Macet bëjnë sfilatë në ballkon,
veç njëra prej tyre mungon.

Ora vajti katër dhe nuk ndodh asgjë e jashtëzakonshme.
E njëjta e mërkurë përsëritëse vjen midis jave. Dielli thonë
se rritet.
Dashnorët gjetën vendet e fshehta.
Për çdo trup, ka antitrup. Velenxën e paqes e hodhën mbi.



në orën pesë të mëngjesit ra telefoni.
“Alo”- tha ajo.
Një alo kërcënuese u dëgjua nga ana tjetër.

“Mos më kërkto para se nuk kam.”
“Unë po vij atje.” dhe sinjali ra.

“Jam nëna jote, ç'bën kështu, bir?! Dielli akoma s'ka çel.”
Ajo flet mistershëm si poet.
Ai ndjen si jetim.

Vendin e kanë ndarë në dy faltore,
njëra anë i bie zotit në gjunjë, tjetra anë ngre duart lart
dhe midis ujit, zoti bën not.

Në orën gjashtë ra dera.

macet përcjellin dashnorët e tyre,
erë duhani dhe afshi pas tyre ra.

ora gjashtë, dikush ishte te dera.
Në gjashtë e pesë minuta ra alarmi për pirjen e barnave.

Dy këmbë zvarriten. Dy të tjera lënë shenjën.

I mistershëm mesi i javës si poeti,
vend ka për të gjithë,
por s'pranon asnjë në vetminë e tij.

Na ishte njëherë...

Fjalët përkunden në gojën tonë,
hanë nga netët tona në urinë e jetës:
rrëfimi i jetës suaj do të fillojë me “Na ishte njëherë...”

Dhe ju do të pyetni:
A ishte britma që solli gjithë këto lindje?
A isha i vetëm, apo erdhëm bashkë?

Dhe ju do të dëgjoni...
Na ishte njëherë një shi që solli këto përralla.
Na ishte një zë që solli këto këngë.

Dhe ju do të qeshni nën jorgan. Se jeta na qenka kaq e
thjeshtë.
Se përralla qenka si jeta,
se përralla paska një fëmijë dhe ai fëmijë je ti.

Na ishte një herë... ju bëri të ëndërroni për jetë.

Dhe ti pyet: cilët thonj ia nxorën jeshilin tokës?
Në cilin det të kripur notojnë sytë tanë?
Nga ç'verë u krijua djersa jonë? Në cilin ujë mbetëm të
patharë?
Ç>fazë e hënës u bë djep i vetmisë sonë?
Në ç'shekull të kohës u përkundëm ne?

Në ç'tingull të fyellit çohet shpirti peshë?
Në ç'djegje temjani pushuan dhimbjet tona?

Ç>peshë na mban në tokë?
Ç'lehtësi na çon përpjetë?

Ç'jeton më gjatë?
Ecja a fluturimi?

Jeta jonë nis me
“Na ishte njëherë...”
Një nënë
Një vëlla
Një motër
Një baba që mungon.

Ne premtojmë që do jemi nxënësit e dobët të kohës:
Që n'fund e n'fillim, do të kemi padurimin.
Që gjithë mësimet do t'i çmësojmë.
Që përherë do ta nisim me “Ishim njëherë...”

Përmbledhja trigjuhëshe me poezi *Tempi che sono... Zeiten wie... Kohë që janë...* e Gentiana Mingës u botua vitin e kaluar nga shtëpia botuese “Terra d’ulivi edizioni”, në Itali.

Përmbledhja *Tempi che sono... Zeiten wie... Kohë që janë...* sjell një poezie solide, të ankoruar mirë në vend dhe në kohë. Konturet gjeografike të poezisë janë të qarta dhe të zgjedhura me kujdes: Durrësi, Daka, Verona, Trento, Bolzano, Rovereto, Magrè, Dachau, ose Libia, Siria a Palestina dhe shëtitëtorja *Hikmet*. Janë ujërat e Maltës, ura *Talvera*, Mesdheu, Nili apo Eufrati. Në vargje enden fëmijë të Europës lindore, një kurd, dy magrebinë, *lieber Franz*, prindër shqiptarë dhe autoktonët. Poezia pozicionohet gjithnjë në vende të caktuara fizike: del në dritare, në ballkon, në lëndinë, në udhë e rrugica, në bujtinë, në ishull.

Edhe ankorimi historik i poezisë është i qartë, falë angazhimit të drejtpërdrejtë dhe fokusit në një nga fenomenet më të diskutuara të kohës: emigrimi, në të gjitha përshfaqjet e tij. Si poezi e angazhuar në kohë, ajo mban të lidhura në vetvete referenca të jashtme, të cilave ndihesh i detyruar t’u drejtohesh për ndihmë në lexim. Kështu, *Anthony* i zgjon menjëherë në kujtesë lexuesit të vëmendshëm historinë e dhimbshme të vogëlushtit 5-vjeçar nga Sierra Leone, i cili u gjet i vetëm në një vagon mallrash në veri të Italisë:

Ti vije kapur pas një treni, mall prej kufijsh me dëborë

Oh, Anthony, i vogli Anthony, je nga të shpëtuarit!

Po kështu, përmendja e Gaspare Giarratano-s, e shtyn lexuesin të gjejë historinë e kapitenit që shpëtoi pesëdhjetë emigrantë në det.

Përmbledhja është e strukturuar në katër pjesë: Pjesa e parë, *ad Anthony*, përmban poezi në italisht dhe në shqip; pjesa e dytë, *Assaggio*, përbëhet nga një poemë në italisht, përkthyer në gjermanisht nga Ilir Ferra; pjesa e tretë titullohet *L’eco del pargolo/ Jehona e foshnjës* dhe përmban poezi në italisht dhe në shqip; pjesa e katërt, *Tempi che sono.../ Zeiten wie diese...* përmban poezi në italisht, të përkthyer në gjermanisht nga Wener Menapace.

Pjesa e parë ka strukturën e një poeme të numëruar nga *Një* në *Tetë*, që unë i lexoj si tetë kohë. Tematikisht kjo pjesë është e lidhur me një lloj kundrimi të vetvetes, kornizuar në një kohë dhe vend të caktuar, në ndërveprim me njerëzit përreth. Në kohën *Një*, poetja e gjen veten të huaj e të paplotë (*unë vetë e shoh veten të paplotë kudo/ ku u linda e për ku shkoj, grua dhe e huaj*), të ngecur në vend, me gjuhë të trazuar, ndërsa *treni fërshëllen me dufmbi dritaren e tjetrit*. Në *Dy* fryn koha e vetjakes, njerëzit nuk i tremb më vetmia, i druhen vetëm humbjeve:

në këtë situatë të re

kujdesemi për lehen tonë

Në kohën *Tre* ndihet ai ton pikëllues që bulon aty-këtu në përmbledhje, një pikëllim me nota dorëzimi nga një luftëtare e lodhur nga lufta e përditshme. Koha shkon, ndërsa poetja sheh si mbetet gjithnjë e më larg *ajo që kam dashur të jem*:

U bë kohë që nuk shoh luledetet.

Të gjitha lëndinat janë në anën tjetër.

Në *Katër* është koha e refugjatëve, është koha e kalimeve me rrezik për jetën nga një botë në tjetrën:

...Oh, patjetër do t’i vënë re

trupat që dalin prej thellësive

Rekomandim leximi:

Përmbledhja me poezi *Tempi che sono... Zeiten wie... Kohë që janë...* e Gentiana Mingës

Nga Entela Tabaku

si delfinë të helmuar

Në *Pesë* fryn koha e një bote të dyzuar. Nga njëra anë shkon i ngopuri, ai të cilit *i duhet vetëm të fusë duart në xhepa*. Nga ana tjetër shkon ai që e merr bukën tinëz, i pambrojturi me kafkën delikate, *nën peshën e një lufte të padukshme*

Në *Gjashtë* dyzohet vetvetja. Nga njëra anë shkon egoistja (*i druhen siç i druhen kobrës*), nga ana tjetër shkon e vetëdijshmja:

Po të mos kisha vendosur të mbijetoja

me ndërgjegjen e re

do kisha vdekur patjetër

Në *Shtatë* koha e ka zbutur unin, përprjekja e ka humbur mprehtësinë. Dikur mjaftonin dy-tri lule

e shndërrohesha në thikë të mprehtë.

Por kujt i duhet tashmë të derdhë edhe më lot në liqenin e lotëve?

Në *Tetë* është koha për bilancin e shpresave, bilancin e së ardhmes:

Shpresat e mia të vogla zbresin e ngjiten në mua

Shpresat e mëdha presin jashtë meje

E gjithë pjesa e parë duhet lexuar me atë fëmijën e braktisur refugjat në sfond.

Atëherë ndihet mes vargjesh droja për një të ardhme me kufij si dyer të mbyllura, droja për një vetvete që sheh vetëm punën e vet. Është një drojë shumë njerëzore dhe shumë pikëlluese, e përjetuar në një kohë që karakterizohet nga nota luftarake në përplasjet midis të drejtave njerëzore dhe atyre individualiste.

Pjesë e dytë e librit përbëhet nga një poemë në italisht dhe gjermanisht, që mund të përkthehet si “Marshi i autoktonëve”. Kur ndihet i huaji më i huaj si kurrë? Kur e krahason veten me autoktonët, me ata që e çojnë jetën në tokën që u përket brez mbas brezi. Ndërsa autoktonët kanë ritmin e vet, jetën e vet, shkëlqimin e dritave të veta, të huajit i duket se gjithçka ndalet kur u kalon pranë. Si barazpeshë, poetja i thërret një kohe të shkuar, në të cilën të gjithë jemi autoktonë: fëmininë. Në skenë hyn *Renata*, shoqja e fëminisë dhe poema shndërrohet në këngën e dy vajzave të vogla, që kalojnë mbrëmjen buzë fushës së futbollit të lagjes.

Si vazhdim i logjikshëm i pjesës së dytë, në të cilën *Renata* bën lidhjen me

të shkuarën, vjen pjesa e tretë, *Jehona e foshnjës*, shkruar në italisht dhe përkthyer në shqip nga autorja. Siç e përmenda më lart, fëminia në këtë përmbledhje nuk është vetëm ajo kohë së cilës i rikthehem të gjithë me mall, sidomos në kohë të vështira. Fëminia nuk është thjesht ajo periudhë e jetës që i jep ngushëllim së tashmes së trazuar. Në këtë përmbledhje fëminia është një pozicion gjeografik, vendi ku poetja ndihet autoktone. Është një projekcion kohor me nota gjeografike, ku rrinë njerëz që e njohin, me ritëm jete të njohur, ku askush nuk e ndërpret të folurën pse afrohet ajo, e huaja.

Thuaji atij që i kujton ende palat e pantallonave

terital e të arnuara,

kokën e qethur për verë, sytë cinik,

tek zbres shkallët e thyera,

apo në anë të fushës së sportit

duke blerë fara tek nëna e Çimit,

që ulur në thep të stolit

buzëqeshte pa dhëmbë, me hijet mbi

mollëza prej kasketës

e mjekrrën e ndriçuar prej dritës,

perandoresha e lagjeve detare,

thuaji që akoma eci shtrembër.

Poezitë e pjesës së tretë thirren në një prani bashkëbiseduese, ose më mirë bashkëdëgjuese. Në shumicën e herëve kjo prani thirret qartë: *ty si të kam; tani tek po të shkruaj, thuaji; dikur u viheshe pas hapave të mi; nuk ta kujtova ndjesinë tonë të hidhur, shihe në mëngjes*. Nganjëherë vetëm sa ndihet në tonin intim të poezisë:

Duart e mia, që janë nënat e mia, e këmbët, që janë baballarët e mi,

shkojnë në kërkim të shtëpisë së vjetër të tejdukshme,

ku rriteshin brënda stinëve të ngrohta,

e merrnin ngjyrën e arrës.

Figura të njohura të fëminisë janë babai i vetës së parë, ai në kanotiere, në ballkon me borzilokë ose i ulur në kolltuk, mbas perdeve të mbyllura. Ose babai i vetës së dytë, ai me flokë të rrallë të portokallinjë:

Po mendoja ta ketë marrë veten

pas vdekjes së nënës tënde,

pa ty në krah...

Ose nëna:

Mbi shkallë nënën time,

me ballin ngjyrë rrushbardhë

Por edhe zagushia, xixëllonjat, qyteti i lindjes.

Pjesa e katërt, në italisht dhe gjermanisht, dëshmon për një kohë të angazhuar, ku historia përsëritet. Njerëz qenë ata që u dogjën në furrat e krematorëve në Dachau, njerëz janë ata që mbyten ndërsa përpiqen të kalojnë detin drejt një jete më të mirë. Kohët që po jetojmë kërkojnë një lexues syçelur, që di ta lexojë historinë e njerëzimit.

Më sipër u përqendrova në leximin e poezive shqip, por duhet shënuar se shumëgjuhësia i jep përmbledhjes një karakter të veçantë. Botimet dygjuhëshe nuk janë të pazakonta për autorët që botojnë në vendet ku kanë emigruar. Më së afërmi më vijnë ndër mend përmbledhjet shumë interesante me poezi të Gëzim Hajdarit.

Ajo që bie në sy më së pari te kjo përmbledhje është se përmban poezi jo në dy, por në tri gjuhë: në italisht, në shqip dhe në gjermanisht. Shumëgjuhësia e poezive përjetohet lehtësisht nga lexuesi si metaforë e realitetit të përditshëm të kësaj poezie. Ana tjetër interesante është vetëpërkthimi që bën autorja nga italishtja, gjuha e vendit ku jeton,



në shqip, gjuha e vet. Edhe ky proces mund të lexohet si një metaforë që i shkon shumë për shtat përshfaqjes tematike të librit në kërkim të një vetveteje autentike dhe autoktone, ku vetvete nuk është thjesht poetja, por çdo njeri më vete. Por kjo përmbledhje është sidomos një rast interesant për sa i përket studimeve të vetëpërkthimit. Vetëpërkthimi në rastin e autorëve extraterritorialë, për të përdorur një term të fushës, është një instrument që më së shumti përdoret për të përkthyer nga gjuha amë në gjuhën e vendit, shtyrë nga dëshira për t'u lexuar edhe në vendin pritës. Rasti i përkundërt, domethënë vetëpërkthimi nga gjuha e vendit pritës në gjuhën amë, zgjon hipoteza të reja interpretimi. Përpos një dëshire për t'u lexuar edhe nga bashkatdhetarët, në rastin e përmbledhjes *Kohë...* më duket se kemi të bëjmë edhe me atë që njihet si vetëpërkthim për të eksploruar marrëdhëniet që krijon poezia edhe me një gjuhë tjetër. Dora e poetes më ngjan më e sigurt në italisht, se sa në shqip, ku zgjidhjet nganjëherë më shfaqen të mangëta. Si në rastin e *Ne jo*, ku variantit shqip i mungon gjinia femërore e ne-së narrative, që i jep leximit të poezisë në italisht një dimension tjetër. Por nuk mungojnë edhe rastet kur më duket se e shoh si poetja dygjuhëshe e shijon procesin e vetëpërkthimit, si për shembull, në poezinë *Malli*. Një studim i tillë krahasues kërkon një hapësirë tjetër, por mund të them se barazimi që i bën poetja dy sistemeve të shenjave të mbarsura me kultura të ndryshme, i mundëson lexuesit ndjekjen e një “loje” eksperimentale që rezulton në një përjetim të ri estetik. Leximi dygjuhësh është i menduar si lexim vertikal: një poezi nga fillimi në fund, njëra mbas tjetrës duke ndjekur fillin e një gjuhe, domethënë vetëm ato në italisht, ose vetëm ato në shqip, ose një herë njëerën, mandej tjetrën. Por unë e shijova shumë leximin horizontal, domethënë vargu i parë italisht-shqip, vargu i dytë italisht-shqip e kështu me radhë. Tematika e përmbledhjes është kaq intensive dhe e fokusuar, sa e justifikon një lexim të tillë. Poezia dygjuhëshe, në origjinal dhe e vetëpërkthyer, më ngjan më e madhe se vetja e vet dhe përbën një përjetim estetik më vete për lexuesin.

Tempi che sono... Zeiten wie... Kohë që janë... është një përmbledhje me poezi që do të doja të mos kalonte pa u lexuar. Jo sepse është një përmbledhje e përkryer. Më pëlqen, për shembull, përzgjedhja e përkorë e poezive dhe struktura që ndihmon lexuesin të ndjekë fillin poetik. Por do të kisha dashur të ishte një përmbledhje më e plotë. I gjithë vëllimi mbështetet në gjithsej tridhjetë poezi, që më lënë pak të panginjur si lexuese e një vëllimi poetik. Më mungon edhe dora e fundit korrigjuese e versionit shqip. Nuk është një përmbledhje antologjike, fantastike, apo -ike -ike të tjera të këtij lloji. Por është një poezi që i thotë eja! eja! një tematike shoqërore të angazhuar dhe të drejtëpërdrejtë, me një nënton dorëzimi dhe pikëllimi. Ky kombinim më duket i veçantë për poezinë tonë. Përpos kësaj, kjo përmbledhje është dëshmi e atij fenomeni që vihet re në letërsinë bashkëkohore, ai i eksplorimit të letërsisë si eksperiment i shumëgjuhësisë. Dhe përmbledhjet e poezive që kërkojnë dhe gjejnë diçka të re janë në përgjithësi të rralla. Prandaj jua rekomandoj ta lexoni.

1.

Rroftë revolucioni.
Nuk e kam ditur se revolucionin është parulla më reale e mashtrimit.
Ajo e Diktaturës së Proletariatit.
Ndoshta edhe më shumë se diktatura e hasreti Adolfit, hasreti Stalini dhe e hasreti Kopilit, të Bleshkëve të Nemuna.
Nëse ka mbetur edhe diçka për t'u thënë, thuaje, një mik më tha.
Zoti nuk ka nevojë për mashtrimet.
Njeriu nuk duhet të luaj me drejtpeshimin.
Djali im është një besim me brirë.
Pas çdo kthese e zë nata.
Botë e vogël.
Djali im çfarë durimi.
Rrafsh.
Njeriu është në zhdukje nga procesi krijues.
Prandaj dielli shpejt do të errësohet.
Nuk është faji i askujt.
Humbësi harrohet.
Dashtë Zoti përpara.
Për t'u kënaqur pa kufi, njeriu përqafton çmendurinë.
Mashtrimi është hero imagjinar.

2.

Historia zbavitëse.
Pse jemi kaq të heshtur.
Pse jemi kaq të humbur.
Më vjen keq.
Legjenda ime Rozafati po e vazhdon jetën e vet të mitit.
Pse është gjithë kjo rrëmujë.
Haraç, zotëri, haraç. U mbush kupa.
Vendi më i sigurt është toka.
Për çmendurinë nuk kam pyetje tjetër.
Për asgjënë nuk jam i sigurt.
Mos e ndryshoni mendjen.
Ruajeni shëndetin mendor.
As çka është turpi.
Në rregull.

Deri aty ku nuk bëhet nami.
E kuptueshme.
As në njerëzi.
As në kohë.
Çka është e drejtë nuk po na intereson.
Për dashurinë nuk ka pyetje tjetër.
Njeriu i ka shkelur ligjet e natyrës.
Dhe – nuk e din se çka është turpi e çka nuk është turpi...

3.

Duke u rrotulluar ngadalë nga e majta në të djathtë dhe nga e djathta në të majtë tani e dimë pse njeriu e ka humbur personalitetin..
Mund të kemi alergji.
Çfarë është ky tjetër njeri.
Kam ardhur nga fillimi.
Nuk kisha më shumë se pak.
Atëherë kur jeta mbyllej pa heronjtë e vet.
Për të zbuluar diçka që ka një pikëpyetje në fillim.
Dhe – mos bëni zhurmë.
Me tri sekonda kohë e kemi mendjen.
Ç'dreqin po ndodhë!?!..
Rrini anash dhe shikoni, shikoni se me çfarë krenarie po dalin te përmendorja e Skënderbeut, dajallarët dhe kumbarët e patriotëve tanë sojli.
Prandaj ish-Njeriu po sillet çuditshëm.
Me vetë dëshirë është larguar nga planeti i vet.
Është betuar se do të bëjë çmos.
Mënyra e vetme për të shpëtuar nga çmenduria është besimi vetëm në djallin.

4.

Njeriu, çka ka bërë njeriu me fatin e vet është për të ardhur keq.
Mua edhe pse po i shoh e çka s'po shoh

DJALLI KA SURRAT TË BUKUR

ese nga Rexhep Ferri



nuk po më besohet.
Një tjetër kohë.
Një tjetër skenë.
S'dua ta fsheh.
Më lini pak kohë të mendohem.
Zemër, dua të flas.
Dua të pyes: a kam të drejtë.
Jeta po na afrohet si një gënjeshtër.
Është më mirë ta ruajmë distancën.
Me këtë të vërtetë, njeriu nuk e ka ditur si ta përballojë famën.
Unë edhe vdekjen e pashë me sy, por nuk vdiqa.
Gjatë rrugës vdekjes i thashë: faleminderit që më tregove se çka është jeta kur njeriu nuk di asgjë për asgjë.

5.

Është koha ta vras ujkun.
Ta shpëtoj njeriun.
Jemi prej mishit e gjakut.
Prandaj lëreni historinë.
Historia na e ka mbushur kokën me erë.
Përtej horizontit një takim konfuz.
Eja...
Po na mungon edhe një çmenduri tjetër për gabime.
Për Kosovën – shtëpia në tym dhe fronti im...
Në Bleshkët e Nemuna.
Me legjendën Rozafa...
Mos më zhgënje, mos më zhgënje.
Populli im ende nuk ka dalë nga lufta.
Për të bërë shire nuk di.
Dielli po perëndon.
Kanë ndodhur shumë gjëra.
Ju lutemi më ndihmoni.
Feniksi na ka munguar.
Kush ka bërë shire nuk e di.

6.

Kjo paturpësi më helmon frymëmarrjen.
Unë besoj në atë që shikoj e jo në atë që dëgjoj.
Jam dije reale që ndryshon.
Bota e frikshme është forcë tërheqëse.

7.

Një mik një herë më ka thënë:
- Nuk mund ta ndalim botën ku duam ne. Ajo ndalet vet, aty ku mendon vet. Ku jemi ndoshta edhe ne.
Nga një dhimbje e bukur.
Nuk ka njeri.
Na pëlqen vetmia.
Është mashtrim.
Nuk e di se ku mund të shkonte.
Është kafshë që ecë me telekomandë.

8.

Zoti për njeriun pse nuk flet?
Nga syri i uritur dhe nga grykësia e mbushi kupën.
Njeriu në fillimet e veta ishte njeri.
Nuk e di se si rrëshqiti e shkoi deri te një gjysmë njeri, nuk e di se si doli.
Të gjitha majat e maleve të Bleshkëve të Nemuna kanë legjenda.
Dashuri dhe vdekje.
Këngë dhe varre.
Bukuria është e fshehtë.
Idiotët e gjejnë.
Kjo e sotmja është e vështirë.

Unë jam dy gjëra: një princ dhe një burrë i vogël. Askush nuk më beson kur them se jam një princ. E kam vënë re këtë ngaqë zgërdhihen, ose më thonë pa hezituar fare se nuk jam një princ. Një djalë më pyeti se ku gjendet pallati im.

- Nuk do të ta tregoj.
Dhe ai tha:
- Po atëherë ku jeton ti?
Por unë nuk u përgjigja. Nuk e bëra, sepse mami më ka thënë të mos tregoj. Ja çfarë më ka thënë ajo:
- Tani më dëgjo me kujdes. Mos guxo t'i tregosh kujt se ku jetojmë.

Kjo është ekzaktësisht ajo që më ka thënë ajo:

- ... mos guxo...
Kështu që kur ai djali më pyeti: - Po atëherë ku jeton ti?

Unë nuk nxora asnjë fjalë nga goja. Thjesht i thashë kaq:

- Nuk të duhet gjë ty.
Dhe ai tha:
- Pra, nuk është e vërtetë që je princ.
Unë iu përgjigja:
- Është e vërtetë.
- Jo, nuk është e vërtetë.
- Është e vërtetë.
- Jo.
- Po.
- Jo.
- Po.
- Jo, jo.
- Të thashë që po!

As që më intereson fare se çfarë tha ai djali, gjithsesi. Emri i tij është Kianu.

Unë *jam* një princ. Dhe një burrë i vogël. Sepse kështu më thotë mami. Çdo ditë ajo më thotë: “Ti je princi im.”

Çdo ditë para se të fle. Por ajo po ma thotë më shpesh këto kohët e fundit, mendoj që nga ajo ditë.

Çdo ditë ajo më thotë: “Ti je princi im.” Çdo ditë para se të fle.

Pothuajse çdo ditë në oborrin e shkollës plas ndonjë sherr. Për shembull, u bë një sherr midis Kianusë dhe një djali tjetër nga një klasë tjetër. Tani, unë nuk kam frikë nga Kianu. Kur ai xhaxhai vinte për vizitë tek ne, ai më thoshte që nëse dikush më ngacmonte, unë thjesht duhet ta godas në fytyrë. Kështu më thoshte gjithmonë ai. Por pastaj një herë i thashë mamasë se çfarë më kishte thënë xhaxhai dhe ajo tha: “Mos guxo ta bësh!”

Kështu që herë bëj atë që më ka thënë xhaxhai, dhe herë bëj atë që më ka thënë mamaja, në varësi se kush do të jetë djali që më ka bërë padrejtësinë. Ndonjëherë mendoj se xhaxhai nuk është në të vërtetë xhaxhai im. Së pari, unë kurrë nuk e kam parë tezen, dhe së dyti sepse mami vazhdon të më thotë të mos i them askujt se një xhaxha vjen të na vizitojë. Nuk e di, por kjo unë mendoj kështu. Ka kaluar goxha kohë që nga hera e fundit që ka qenë tek ne, dhe mami më tha të mos pyes për të.

- Mjaft më!
Kjo është ajo që më tha ajo:
- Mjaft më me atë xhaxha.

Ai më pëlqente sepse gjithnjë më sillte diçka. Por ajo që nuk më pëlqente ishte se mamaja më dërgonte në shtrat dhe pastaj kur zgjohesha ai tashmë ishte zhdukur. Ka kaluar shumë kohë që kur ka qenë tek ne për herë të fundit. Që nga dita e atij sherrit të madh gjithçka ka ndryshuar. Por prapëseprapë, mami më thotë çdo ditë:

- Ti je princi im i vogël.
Ditën që plasi sherri unë po qaja, dhe ajo po i bërtiste atij burrit dhe i thoshte:
- Shiko! Shiko, ti krijesë e ndyrë! Ti po e frikëson fëmijën tim!

Njeri mizor. Tani nuk po flas për atë xhaxhin. Një burrë tjetër. Mizor. Ky tjetri pi duhan. Dhe duhanpirësit janë tashmë

BURRI I VOGËL

tregim nga Immanuel Mifsud

Përktheu Elisa Ivanaj

mizorë sepse pirja e duhanit dëmton njerëzit. Mizor, mizor. Ai po bërtiste, dhe mami bërtiste edhe më fort se ai. Ajo i tha:
- Shiko! Fëmija im po qan për shkakun *tënd*, ti krijesë e ligë!

Dhe ai po thoshte fjalë të këqija që mami më thotë se nuk duhet t'i them. Ai tha fjalët e hëngrët dhe dreqi dhe vazhdoi të këlhiste:

- Prandaj ik! Merr gjithçka që ke dhe dil jashtë. Kjo është shtëpia ime. Do rrish sipas kushteve të mia ose fare.

Dhe përsëri ai tha fjalët e hëngrët dhe dreqi.

Mami im ka sy kafe. Si të mitë.
Ditën e sherrit e pashë duke qarë. Ajo vazhdimisht më thoshte se unë isha burri i saj i vogël.

“Ti je burri im i vogël.”
Ne morëm ca thasë plastikë në supermarket dhe i futëm rrobat tona në to. Edhe uniformën e shkollës. Pastaj vendosëm gjithçka në bagazhin e makinës dhe në sediljen e pasme. Bënte vapë.

- Ku do të shkojmë tani, mami?
- Do ta shohim.
- Po kur do të shkojmë në shtëpi?
- Ne nuk do të kthehemi në shtëpi. Na e morën shtëpinë.
- Ai burri na e mori, mami?
- Po, ai burri.
- Ai që po thoshte e hëngrët dhe...?
- Nuk dua që ti t'i thuash ato fjalë. E kupton? Vetëm burrat e këqij flasin ashtu.
- Po tani, ku do të jetë shtëpia jonë, mami? Do të blejmë një të re?

- Do ta shohim.
- E po, sa kohë do të qëndrojmë këtu?
- Do ta shohim.
- Po pse na e mori shtëpinë ai burri, mami?
- Sepse ai është njeri i lig.
- Kjo është e sigurt. Ai është njeri i lig, po thoshte e hëngrët dhe...
- Të thashë të mos i thuash ato fjalë!
- Jam i uritur.
- Më vonë.
- A mund të shkojmë tek “McDonald's”, mami?
- Do ta shohim.
- A nuk ke uri, mami? Nuk kemi ngrënë drekë akoma, e di?
- Ju lutem! Më lër të mendohem.
- Mirë, mami, por jo për shumë gjatë sepse kam vërtet shumë uri.

Dhe pastaj, krejt papritur, mami filloi të godiste timonin e makinës dhe filloi të qante dhe ta gjuante gjithnjë e më fort, edhe unë fillova të qaja gjithashtu. Paskëtaj mami më tha të mos qaja. Ajo tha se unë jam një burrë i vogël dhe ndaloi së qari. Vazhdova edhe për pak kohë, pastaj u ndala. Atë ditën kur ndodhi sherri me atë burrin mizor, blemë pica nga dyqani në qoshe dhe e hëngrëm në makinë. Nuk më pëlqeu dhe e lashë mënjanë. Mami tha se do të haja po të njëjtën copë që kisha lënë të nesërmen. Kështu që iu futa dhe hëngra edhe pjesën tjetër. Filloi të binte shi dhe nuk mund të bëja asgjë më në dritare.

Pastaj u errësua.
- Ku do të flemë?
Kush e di se çfarë thashë ndonjë gjë të gabuar, por ajo filloi të qante përsëri.
Ajo tha:
- Do ta ul sediljen tënde që të mund të flesh. Hiq këpucët.
Nuk e kisha idenë se sediljet e makinave mund të shndërroheshin edhe në shtretër. Ajo më tha të mbyll sytë dhe më puthi.
- Ti je princi im i vogël. Tani fli deri në mëngjes.
- Por nesër a do të na e kthejë shtëpinë tonë ai burri?

Më pëlqen Kianu, por nganjëherë m'i acaron nervat sepse vazhdon të thotë që unë nuk jam me të vërtetë një princ, dhe se nëse do të isha një princ do të jetoja në një pallat dhe nuk ka asnjë pallat në qytetin tonë. Unë e di se ku jeton Kianu sepse një herë e kam parë duke luajtur pranë shtëpisë së tij. Ai jeton në një shtëpi me të vërtetë të madhe me një shilarës në oborrin përpara shtëpisë. Para pak kohësh, ai më ftoi të shkoja të luaja me të. Ndoshta në atë shilarësin. Madje ai më tha se mund të shkoja të flija andej nga shtëpia e tij. Unë do të shkoja të premten pas shkollës dhe mami mund të më merrte të dielën. Do të luanim gjatë gjithë kohës. Kjo do të ishte shumë argëtuese! Për arsye se Kianu ka shumë lojëra që i luan në televizor. Unë kisha një lojë të tillë dhe ia kisha marrë shumë dorën mirë, por pas atij sherrit, nuk kisha më mundësi të luaja. Mami më thotë se jam një burrë i vogël tani, nuk jam më një fëmijë. Kjo nuk është e drejtë. Nuk është mirë të jesh burrë i vogël. Kianu është mosha ime dhe ai ende vazhdon të luajë. Ai luan gjithmonë. Madje në verë ai noton në shtëpi.

- Ti bën not në shtëpi?
- Sigurisht që po.
- Çfarë! Si! Ti ke një det në shtëpinë tënde?
- Det? Çfarë deti! Ne kemi një pishinë në oborrin e pasmë të shtëpisë. E si ka mundësi që ti nuk ke një të tillë nëse je vërtetë një princ?

Ndihem keq sepse mami më paralajmëron që të mos flas për të gjitha këto gjëra. Ajo më thotë që ta mbaj gojën



të mbyllur dhe askush nuk ka punë të dijë se ku jetojmë. Kur i thashë që të flija nga Kianu, ajo më tha jo.

- Pse?
- Sepse unë të thashë jo.
- Nuk është e drejtë!
- Shiko, nëse ti shkon te shoku yt, ne do të duhet t'ia kthejmë ftesën dhe ta ftojme këtu. E kuptove?

Zonjusha Katja. Unë e dua shumë zonjushën Katja. Mësova se ku jeton edhe ajo, sepse pas atij sherrit ishim në makinë dhe e pashë duke dalë nga shtëpia e saj. Zonjusha Katja ka një shtëpi të bukur në fund të rrugës pranë shkollës. Ajo ka një makinë blu me të bardhë dhe nganjëherë parkon pothuajse në shkollë, dhe pranë saj ulet gjithnjë një burrë të cilit ajo i jep një puthje para se të zbrësë nga makina. Unë e kam parë. Mami më tha që të mos ia ngul sytë ashtu sepse nuk është puna ime, por unë e kam shumë xhan zonjushën Katja. Ajo luan lojëra me ne në klasë. Edhe ajo më ka xhan mua. Por... Sepse një herë i thashë asaj:

- Zonjusha Katja, a e di që unë jam një princ?

Vura re që zonjusha Katja nuk e dinte këtë.

- Një princ? Uau, unë kam një princ në klasën time këtë vit!

Unë i thashë edhe se jam një burrë i vogël, por kryesisht jam një princ.

- Pa të shohim: nëse ti je një princ, çfarë do të ishte mamaja jote atëherë?

- Një nënë.
- Po, por nëse je një princ, si e quajmë nënën tënde atëherë? Si quhet nëna e një princi? Hajde, më thuaj.

- Nënë. Ose mami.
- Nëna e një princi quhet mbretëreshë. A nuk e dije këtë? Kështu që, nëse ti je një princ, atëherë mami yt është një mbretëreshë, apo jo?

- Unë do t'i them asaj.
Pastaj zonjusha Katja më shpupurishi flokët dhe vazhdoi të flasë:

- Pra, nëse ti je një princ, atëherë duhet të jetosh në një pallat, apo jo? Në një pallat shumë të madh!

Edhe zonjusha Katja e përmendi pallatin. Si Kianu.

- Ti jeton në një shtëpi shumë të bukur, apo jo zonjushë? Ti jeton poshtë rrugës.

- Oh shiko! Nga e di ti këtë? Duhet të ketë qenë njëri nga rojet e pallatit tënd i cili ta tha këtë, apo jo? Kështu mendoj unë.

- Jo. Të pashë disa ditë më parë.
- Të pëlqen shtëpia ime?
- Po.

- Por pallati yt duhet të jetë më i bukur se shtëpia ime e vjetër, apo jo?

I vjen një erë e qelbur, mbytëse dhe karburanti. Dhe është errësirë. Mami më dha një elektrik dore për të bërë detyrat e shtëpisë, përndryshe nuk do të shihja asgjë. Atë ditë kur ajo më kishte marrë nga shkolla, më tha se dikush më kishte bërë një dhuratë: një shtrat. Kam fjetur në një dyshek në dysheme që kur kemi filluar të jetojmë në këtë garazh. Është errësirë këtu, por të paktën tani kam një shtrat. Mami ende fle në dysheme, por më tha se ndonjë ditë dikush do të na sjellë një shtrat tjetër.

Asnjë dobi nuk të sjell të kesh një elektrik dore. Dhe nuk do të përfundoj asnjë detyrë shtëpie. Nuk mund t'i bëj.

E varfra zonjusha Katja. Sot e dija që do të qaja. Ajo më tha:

- Më jep fletoren e detyrave të shtëpisë së gjuhës malteze.

Unë nuk doja. Në vend të kësaj, i dhashë fletoren e ushtrimeve të matematikës.

- Të gjithë janë të saktë. Çfarë djali i mirë. Tani më trego fletoren e gjuhës që të korrigjoj fjalitë e tua.



Nuk doja t'ia jepja fletoren e detyrave të shtëpisë. Nuk kishte fjali gjuhe në të, sepse unë kurrë nuk kam shkruar ndonjë.

- Eja tani, xhan, më jep detyrat e shtëpisë që të shohim se çfarë fjalish të bukura ke shkruar.

- A do të më japësh një ngjitëse për ushtrimet e matematikës?

- Ke të drejtë, e meriton një sepse i ke bërë të gjitha të sakta. Tani le të shohim ato fjalitë malteze. Ndoshta do të të jap një ngjitëse tjetër. Eja tani!

Kështu i dorëzova fletoren e detyrave të gjuhës malteze.

- Oh! Ku janë fjalitë që duhet të shkruaje?

Po tani çfarë të them? Mami më ka thënë që të mos i them askujt asgjë. As zonjushës Katja.

- Ti nuk i keni bërë detyrat e shtëpisë së gjuhës malteze.

- Jo.
Dhe në këtë moment fillova të qaj.

- A i ke harruar?
Unë qaja.

- Eja tani, mos qaj. Ndonjëherë njerëzit thjesht i harrojnë gjërat. E di se çfarë më ndodhi dje? Kisha harruar çelësat e shtëpisë dhe nuk mund të hyja brenda!

- E ke fjalën për shtëpinë që ke në fund të rrugës.

- Po, atë. Tani shiko, dua që të ndalosh së qari. Po të kthej fletoren e detyrave dhe kur të kthehesh në shtëpi do i shkruash fjalitë. Dhe sigurohu që të mos i harrosh përsëri sepse pastaj do të duhet t'i tregoj mamit tënd. Në rregull?

E po, po përpiqem. Po përpiqem vërtet shumë, por thjesht nuk mundem. Nuk ia kam idenë se si t'i shkruaj këto fjali. Dhe nuk i kam thënë as mamit që nuk i kam bërë detyrat. Kam frikë se ajo do të më bërtasë. Përsëri nuk shkrova asnjë fjali. Thjesht nuk mundja.

- Më trego. Përse nuk i ke shkruar fjalitë e gjuhës këtë herë? Mos po bëhesh si një nga ata djemtë e pabindur? A nuk më the që je një princ? Kështu më the një ditë, apo jo? Princat janë gjithmonë të mirë. Gjithmonë, gjithmonë. Tani çfarë të bëjmë? Përsëri u përpoqa, përsëri nuk munda.

Përsëri nuk do t'i shkruaj fjalitë. Nuk është se nuk dua t'i shkruaj, por nuk mundem. Nesër zonjusha Katja me siguri do të më bërtasë. Mbase duhet të qaj përsëri. Nëse filloj tani, sytë e mi do të më dhembën dhe atëherë do t'i them zonjushës Katja se më dhembën sytë.

- Pse po qan?
Nuk doja që mami të më shihte, por është vonë tani.

- Do të më bërtasë zonjusha Katja.
- Pse do të të bërtasë? Çfarë ke bërë?

Sepse nuk mund të bëj fjalitë që kam për detyrë shtëpie.

- Mos qaj më tani, nuk mund të të kuptoj. Përse do të të bërtasë zonjusha? Çfarë ke bërë? A je sjellë keq?

- Jo! Por nuk mund t'i shkruaj fjalitë.

- Të thashë të ndalosh së qari! Pse nuk mund t'i bësh detyrat e shtëpisë? Unë të dhashë një elektrik dore, kështu që mund të shohësh mjaft mirë. Pse nuk mund t'i shkruash fjalitë?

I dhashë mamit fletoren e ushtrimeve të gjuhës malteze, ku supozohet që të shkruaj fjalitë dhe kur ajo e pa atë më përqafoi dhe filloi të qajë.

- Mos u shqetëso. Shko dhe më merr shënuesit me ngjyra nga çanta jote e shkollës dhe shko të flesh.

- Por unë nuk mund t'i shkruaj fjalitë dhe zonjusha Katja do të më bërtasë.

- Shkoni, merr shënuesit dhe shko të flesh. Mos u shqetëso, nesër në mbrëmje do të shkruash fjalitë.

- Por për çfarë të duhen ngjyrat?

- Bëj siç të thashë dhe atëherë do ta shohësh. Eja tani, princ. Dhe nuk dua që të qash më. E sheh, as unë nuk po qaj tani. Hajde pra.

Sot zonjusha Katja nuk erdhi në shkollë. Zakonisht kur kjo ndodh unë trishtohem sepse përfundoj të shkoj tek klasa e zonjushës Alison dhe nuk e kam shumë qejf atë. Por isha me fat që ajo nuk erdhi sot sepse me siguri do të më kishte bërtitur për shkak të fjalive. As Kianu nuk erdhi. Unë mendoj se ai është sëmurë. Do kaloj nga shtëpia e tij sot. Mami nuk do të jetë në shtëpi, kështu që ajo më dha çelësin. Do të numëroj sa shtëpi ka nga shkolla tek

shtëpia e Kianusë. Duhet të jenë një mijë.

Ose njëqind. Shtëpia e Kianusë është më e bukura. Shiko, ka edhe një shilarës. Dhe shiko sa e madhe është dera e përparme! Sa ballkon i bukur! Do të doja ta trokisja dhe ta shihja si është. Ndoshta ai do të më linte të qëndroja dhe të lëkundesha pak. Por mami më tha të mos shkoja te Kianuja përndryshe ai do të donte të vinte për vizitë tek ne.

Çfarë shtëpie të bukur ka Keanu. Edhe shilarësi është i bukur.

Era e karburantit. Errësirë. Kemi një llambë, por në mbrëmje mezi ndizet. Supozohet të kem për të ngrënë peshk dhe patate të skuqura. Nuk i kam fort qejf kur janë të ftohta. Por gjithsesi janë mirë edhe ato. Pastaj shikoj drejt shtratit dhe thuajse tremben. Por më pas ndihem i lumtur. Duhet ta ketë vizatuar mami atë pikturë! Kjo është arsyeja pse i donte ngjyrat!

Shkruaj pesë fjali për: Çfarë shoh përmes dritares së dhomës sime.

nga dritara e dhomës sime shoh një kopsht të bukur dhe të mah

nga dritara e dhomës sime shoh shumë pumë dhe lule

nga dritara e dhomës sime shoh një pishinë të madhe te shumë peshq në të

nga dritara e dhomës sime shoh një dill dhe të madh dhe të verdhë

Sot zonjusha Katja erdhi. Sapo arritëm në klasë, unë i dorëzova fletoren e ushtrimeve të gjuhës malteze.

- Ah! Djaloshi im i mirë! Nuk i ke harruar fjalitë sot. Pra, le të shohim se çfarë mund të shohësh nga dhoma jote.

Kianu nuk ka ardhur akoma në shkollë. Nëse ai do të ishte këtu unë do t'i tregoja fjalitë e mia. Ai e sheh fletoren time dhe unë të tijën.

- O të keqen, sa gjëra të bukura sheh nga dhoma jote! Ti duhet të jetosh në një pallat.

Ndihem kaq i lumtur kur zonjusha Katja më thotë kështu. Nuk më intereson nëse Kianu nuk më beson për aq kohë sa zonjusha Katja më beson.

- E di çfarë? Një ditë do të vij në shtëpinë tënde që edhe unë të shikoj nga dritarja jote. Do të vij, si thua? A mund të vij në shtëpinë tënd e një ditë që të shoh këto gjërat e bukura nga dritarja jote?

Prej disa javësh trupa e Teatrit Kombëtar së bashku me një numër të madh studentësh të fakultetit të artit skenik (Master 1+2) dhanë me shumë sukses shfaqjen “CORIOLANUS” të W. Shakesperare-it. Këtë fundjavë që shkoi, vargu i shfaqjeve u përmbyll dhe mbarimi i “ciklit jetësor” të shfaqjes na lejon përfundimisht të rreshtojmë disa fjalë të përgjithshme, por edhe të përveçme rreth kësaj shfaqje që u dallue për një mori risish të aktualizimit, të ndërtimit regjisorial, të elementëve teatrorë e, padyshim, edhe të lojës aktoriale, e cila e kunorëzon të gjithën me vulën e njeriut-personazh.

Regjisori i mirënjohun Altin Basha, i cili për të gjashtë herë merret dhe ven në skenë Shakespearë-in, na kishte rezervue një befasim ambicioz dhe një realizim po aq të suksesshëm sa ambicja e tij krijimtare. Ai kishte vendosë të bante një shartim të guximshëm mes dy arteve kaq popullore siç asht teatri dhe kinemaja, tue përballue rreziqe financiare, debordim afatesh, lodhje të aktorëve dhe mbetje në gjysmë të ndonji realizimi. Por kjo nuk ndodhi falë seriozitetit që Shakespearë-i dhe regjisori i imponuen gjithë kësaj ndërmarrje kolosale, e cila u mishnue në një shfaqje komplekse, të larmishme, tronditëse dhe të pazakonte në pikëpamje të mjeteve dhe aksesorëve që u përdorën për ringritjen e një epoke, e cila, me pak retushime dhe spostime të logjikës, i binte tamam kohës sonë dhe aktualiteteve politike të periudhës që po kalojmë.

Regjisori dukshëm ka përzie me masë por edhe me guxim teknikat filmike me ato teatrore. Shfaqja i ka kthye shpinën teatrit pëshpëritës dhe fjalës së luejtun nën za e me frymë pak. Koncepti regjisorial e ka ndie nevojën ta shqyejë gojën e skenës dhe të krijojë një hapësinë të madhe, jashta zakoneve e konvencioneve të skenës, për të impostue atje një *colossal* teatror me farefisni të dukshme filmike që sugjerohet nga shumë elemente që në teatrin tonë konvencional – të paktën – zhvillohen mbas kuintash e u ndigjohet vetëm rrapëllima e poterja. Regjia ka dashtë që gjithçka të ndodhë në skenë, spektatori të jetë i pranishëm në duelet, në përplasjet e falangave ndërluftuese, në dialogët, në fjalimet, në skenat ma të heshtuna dhe ma intime – deri tek puthja. Doza e dramaticitetit këtë herë na duket ma shumë si një diagnozë e randë që rri varë mbi kokën e spektatorit i cili, edhe pse dashamirës i teatrit, nuk i merr ende mesazhet e lirisë dhe të përgjegjësisë me daljen e tij nga salla.

Regjia ka vendosë ta rrisë dozën me anë të tronditjes, me anë të lëvizjes, me

CORIOLANUS

NJI MEGA-SPEKTAKËL NË TEATRIN KOMBËTAR

Nga Primo Shllaku



anë të muzikës, me anë të përplasjes fizike në mesin e një skene ku veprimi i zgjedhun ia zmadhon edhe fizikisht, edhe virtualisht hapësinat. Bokaskena kthehet në një ekran *cinemascope* dhe na ndihemi të sulmuem prej ekranit, prej krismave, prej britmave, prej batërdisë së armëve si një ogur i keq për lëkurëtrashët. Teatri i afrohet kësaj funksioneve të veta primordiale: tronditës, shkundës, zgjues dhe batërdisë. Ndoshta hamendësim regjisorial i një epoke fillestare kur teatri ishte kudhra mbi të cilën farkëtohej i nxehtë edhe i skuqun njerëzimi parak.

Coriolanus asht një tragjedi “romake” e W. Shakespearë-it e shkrueme më 1607. Ajo flet për një luftar patric të quejtun Kaj Marci, i cili u kishte pri ushtrive të Romës dhe kishte shtrure qytetin e Koriolës. Për këtë ai ishte mbiquejtë Koriolanus ose *Coriolanus*. Ngjarja ndodh në periudhën republikane të Romës rreth pesë shekuj para Krishtit. Pra jemi në epokën heroike të kombeve europiane. *Coriolanus*-i kishte tregue trimni të rrallë në luftë dhe ishte rritë si personalitet i randësishëm. Populli dhe bashkëpunëtorët e tij e shtyjnë të vejë kandidaturën për konsull. Por ai nuk ndihet mirë që të zgjidhet prej popullit të

cilin e përbuz. Mania e madhështisë dhe përbuzja ndaj popullit janë karakteristika të një autokrati. Virtytet e tij të kohës së luftës nuk ujdin me kërkesat në kohë paqe. Virtytet e paqes nuk mund të jenë virtyte të kohës së paqes. Paqja ka ligjet e veta dhe një luftar si ai mendon se kontributet në luftë automatikisht duhen shpërblje me ofiqe në paqe. Nuk i kupton zgjedhjet e as fushatat zgjedhore. Ndjejmë krizën e republikës romake, e cila po fuqizohet dhe, pa dashjen e saj, po kërkonte diktator që ta printe. Kjo periudhe e gjatë do të vazhdonte deri me Jul Qesarin në shek. I para erës së re, kur vrasja e tij do t'i jepte fund republikës dhe do të fillonte era e perandorëve.

Shakespearë-i na duket sikur na i cilëson si shumë ma të ndryshme sesa i dimë na periudhat e paqes dhe të luftës. Sikur na thotë se njerëzit e luftës i përfshin deliri i madhështisë dhe në kohë paqe ata vazhdojnë me sy mbyllë andrrën e tyne ngjitëse derisa kthehen në një fatkeqësi shoqnore. Lavdia e pakufi që sigurohej në lojën e randë me vdekjen, zhvillon mbrenda individëve të tillë një të drejtë të pakufishme që, përfund, i shkatërron ata vetë dhe mbas tyne edhe demokracinë dhe ekuilibrat shoqnorë. Tragjedia shpërthen në sprovimin e heroit të luftës në përpjekjen për t'u kthye në administrator të paqes. Ky pohim, me të gjithë tragjizmin e tij, rreshtohet dramaturgjikisht me të gjitha pikat e nxehta ku shpërthen tragjedia që nga lashtësia e deri tek klasicizmi francez kur kjo gjini hyni në klimaks dhe nuk e mori veten ma.

Gjetja dhe theksimi i paraleleve dhe analogjive të thelbit të kësaj drame me aktualitetin tonë shqiptar ka qenë pjesë e ndritshme e inteligjencës regjisoriale për ta rrokë një hark kohe ma se 80vjeçar shqiptar me bamat dhe hata të që na rezervoi historia e kësaj periudhe. Aktualizimi dhe kontekstualizimi i kësaj tragjedie me dramatikat e realitetit shqiptar në një hark bukur të gjatë kohë tregon për angazhimet e forta të regjisorit Basha në ndriçimin e epokës me dritën universale të gjenisë shakespeare-iane.

Një trupë fort e zgjedhun aktorësh asht thirrë për të jetësue një variant kaq të nxehtë e tronditës të tragjedisë së *Coriolanus*-it. Autori i veprës ka skalitë karaktere komplekse e me frymë të gjatë. Kushdo që të ishte regjisor do të ndalohej para dilemave dhe iluzioneve të zgjedhjes së aktorëve për të marrë një vendim personal e me perspektivë suksesi.





Coriolanus: Ky rol epik e heroik na vjen në interpretimin e aktorit dhe pedagogut të artit skenik, Gazmend Gjoka. I nisun nga prestacione fizike dhe aktoriale jo të zakonshme, regjia i ka caktue këtij aktori të ishte epiqendra e veprimit dramatik dhe skenik. Me trup përmbi mesataren, por me fizik të zhvilluem e me shtat të zhdërvjellët, të gjimnazuem dhe me volume të ndjeshme muskulore, Gazmend Gjoka hynte në këtë produksion me disa virtute të gatshme aktoriale dhe karakteriale. *Coriolanus*-i ishte luftar dhe atlet – sipas kulturës dhe kërkesave të përgatitjes ushtarake greko-romake -, me fizik të bashëm e të bukur, të zhdërvjellët e me të ramen e hidhtë të krahut, kur ai krah mban një shpatë apo një mburojë të randë. Ky personazh ka dy anët e tij të dukshme që shtrihen mbi linjën e madhe të ndarjes së punëve të luftës me ato të paqes. Ai asht i turrshëm dhe i pandalshëm në duele dhe mësyn si luan në zulmën e luftës. Duket si një perëndi lufte, një Mars i vërtetë sikurse afërsisht e ka edhe emnin e tij të

pagëzimit. Anmiqtë i tremben, askush nuk do që të gjendet tek e tek para shpatës së tij mizore. Por në kohë paqe ai zotnohet prej sekrecioneve të fshehta të shpirtit të tij, nga përbuzja dhe përcmimi i turmave, i popullit dhe i masës, të cilën e përbajnë edhe luftarët e paqes për demokraci e pushtet të ballancuem. Në kohën e paqes ai nuk i përfill, ka turp që t’u kërkojë votën dhe ndihet i poshtnuem që ai, goxha luftar i vijës së parë, të tregohet “lypës” i votës së njerëzve që ai nuk i njeh si të tillë. Në veshët e tij ka gjithnjë zanin e të amës, Volumnias, e cila e shtyn sa në luftë e sa në kohë paqeje. E shtyn drejt pushtetit me argumentin e virtytit të tij të pamohueshëm luftarak.

Gazmend Gjoka e ka mishnue mirë këtë personazh, me një përkushtim e seriozitet që duhet të bahet etalon i punës së aktorëve ma të rij në realizime kaq ambicioze dhe serioze sa *Coriolanus*-i. Asht shumë pozitive që ky aktor i ka bishtnue me dashje emfazës dhe gërvalljes që këto personazhe të shkruem në shek e



XVII e sjellin me vete si rrezik të vendosjes në epokë. E foluna e tij buron nga gjoksi, fuqishëm, me fraza të preme dhe të shkurta që nuk e ngulfatin aktorin. Vihet re një lëvizje totale e trupit në momentet kur ai reciton në rol. Kjo ia kompenson heroiken e mungueme nga eliminimi i emfazës dhe kantilenës, të cilat ai dhe regjia i kanë shmangë me projekt.

Të ndalemi pak tek maska ose portreti i *Coriolanus*-it alias Gazmend Gjokës. Nëse duhet ndonjiherë t’i përmbahemi historizmit të figurave deri tek detajet dhe tek imtësitë e tyne për të ndërtue diçka realiste dhe deri diku edhe të njoftshme në kodet njerëzore e vizuale të një epoke, mendojmë se figura e paflokë, pra e qethun zero, e *Coriolanus*-it kërcet disi. Duhet të sjellim ndër mend se figurat mashkullore e burrnore me kokën e qethun zero ose të rrueme në lashtësi janë ato të barbarëve që sulmonin qytetnimin romak, por jo vetëm. Kokërruemit ishin edhe kriminelët e keqbamësit e randë që, ose mbaheshin përjetë në qeli, ose ndodheshin në prag të ekzekutimit. *Coriolanus*-i nuk ishte asnjë prej këtyne. Periudha romake asht periudha e estetizimit të figurës mashkullore dhe e krijimit të një arketipi formal të mashkullit 20-50 vjeç. Pra shpatullgjanë, muskuloz, me qafën e trashë dhe me kokën e mbulueme me flokë të shkurtë e të krehun për poshtë mbi ballë e mbi tamtha. Ky të paktën asht ajo që marrim nga mija portrete skulpturore të antikitetit romak, si dhe nga studimi e kanunizimi i kinemasë hollivudiane që ka xhirue me mija filma me kostume e atmosferë romake. Mbase autorët e shfaqjes sonë e kanë gjetë një rrethanë lehtësuese tek filmi *Coriolanus* i 2012 me aktor kryesor Ralph Fiennes, i cili gjithashtu ka kokën e shogët sikurse *Coriolanus*-i i Teatrit tonë Kombëtar. Por në atë film regjia dhe konceptimi i përgjithshëm e ka zhvendosë ngjarjen në kohët tona, me armë moderne automatike dhe uniforma të ngashme me ato të marinsave amerikanë. Kësisoj puna ndryshon. Por një hero romak kokërruem asht një mosrespektim i kodit të historizmit.

Grupi grave, përkatësisht Volumnia – Luiza Xhuvani dhe Elia Zaharia – janë në vendin e tyne por në gjithë atë tension që mbahet shfaqja shpesh herë na duken si atone dhe anemike prania e tyne si karaktere. Volumnia asht një nanë heroie dhe si edukatore e tij ajo ndihet paksa e mështë dhe pa nerv për djalin që nuk po i bindet dhe që, për shkak të prepotencës së tij, nuk konformohet me anën formale të zgjedhjeve, ku konsulli i ardhshëm duhet t’u “bahet urë” zgjedhësve.

Elia Zaharia luen gruen e shqetësue me për fatet e burrit, por gjithsesi ka shumë statizëm dhe ngurtësim. Ajo nuse e re duhet ta dëbonte sadopak me qenien e praninë e saj atë duhmë maskiliste të kazermës dhe të fushëbetëjës.

Viktor Zhusti, një aktor gati 80vjeçar, por me përvoja të gjata në skenë e sidomos në teatër, e luajti me korrektesë teatrore atë rol, rolin e ndërmjetësit (edhe pse xhaketa e tij e gjelbër nuk kish asgja



romake e, ashtu, ma shumë dukej si ndonjë personazh i Molierit). Por regjistri i naltë i toneve të kësaj megashfaqjeje kërkonte njilloj tjetër pranie të tij, ma energjike, ma në sintoni me të tanën, ma këlthitëse ndoshta. Megjithatë plastika e tij aktoriale ishte e pajtueshme me rolin e tij delikat që kishte ai personazh mes palëve.

Helidon Fino ka krijuar figurën interesante të Aufidius-it, një figurë të çuditshme dhe ka një transformim kaq të skajshëm sa nuk na mbetet veçse ta admirojmë për këtë lloj transferimi në një rol të vështirë, por edhe tërheqës në variantet që ai ofron për interpretim. Personazhi asht dinak, diplomat, di të presë dhe di të “peshkojë”. Aftësia e tij prej politikani pragmatist deri në të paskrupull bën që ai ta marrë pas vetes *Corolianus*-in dhe ta përdorë atë për të sulmue Romën. Në fund *Coriolanus*-i asht ba tradhtar i qytetit të vet dhe nuk i duhet gjë askujt. Aty Aufidius-i edhe e vret *Corolianus*-in. Maska e këtij personazhi si e ndonji magjistari apo shamani të mbetet në mendje. Ftyrës së pastër e krenare të *Corolianus*-it i përgjigjet në skajin tjetër ajo e Aufidiusi-t, me gërshetat e gjatë dhe shikimet e fshehta.

Çifti Hervin Çuli dhe Genci Fuga që shfaqen literalisht si çift kudo bashkë janë dy personazhe që po u themi negativë për vetë faktin se ata shfaqen në kohë rrëmujash e në çaste kritike për të ndërruar e deformuar opinionin publik, për të intrigue e për të dezinformue. Këto dy figyra shfaqen kur s’e pret dhe mbijnë nga çdo vrimë ku mund të kalohet. Aja janë depërtues dhe rezultativë. Janë fryma e padukshme e korrupsionit që ka fillue me bre demokracinë e brishte romake, kur politikanëve u ka lindë nevoja të manipulojnë turmat dhe votat e tyne. Si dy brejtës të stërmëdhej ata e brejnë ndërtesën e demokracisë për interesat e një pakice, e cila nuk shfaqet në skenë, por ndihet aroma e prishjes së lojës dhe e rregullave të lojës demokratike.

Ndoshta këta personazhe me kumt të trishtë për demokracinë mund të ishin pak ma të kursyem në rrëshqitjet e tyne groteske. Ata po e gërryenin demokracinë dhe historikisht ia arritën ta shembin atë dhe të sjellin perandorët e tmerrshëm të Romës. Pra nuk mendoj se dozimi sado i vogël me grotesk do t’i bante ata ma interesantë ose ma të afërt me mendimin e kujtdo, si të autorit, ashtu edhe të regjisorit.

Një rol të randësishëm në këtë shfaqje kishte edhe turma e popullit, e votuesve ose edhe e ushtarëve që ngrehin përleshje mes tyne në mesin e skenës me shpata e mburoja punue me çelik të fortë balestrash. Ajo ishte një masë e madhe që hynte delte, sulmonte, ulej, rrëzohej, qeshte, brohoriste, këlthiste dhe kësisoj i dha shfaqjes në fjalë një energjizëm të papamë dhe një ritëm masakrant që tronditi platenë. Kjo masë e disiplinueme figurantësh dhe jofigurantësh ishin në masën dërmuese studentë të artit dramatik, Master I dhe II, si dhe absolventë të dy viteve të fundit. Këta studentë ishin Urim Aliaj, Ermir Hoxhaj, Griseld Kapllanaj, Juxhin Plovishtit, Bujar Hoxhaj, Theodhora Dhimo, Andërrjon Nazifi, Sinan Lila, Altea Dulellari, Asiana Koka, Arlin Capi, Anxhela Muça, Flobensa Bezati, Ina Zoto, Ivigina Hatija, Eraldo Malaj, Amedeus Xhizdari etj.

Për studentët e masipërm vumja në skenë e kësaj pjese ka qenë një përvojë dhe një shkollë e madhe. Atyne iu dha mundësia të punonin efektivisht përveçse pedagogjikisht me pedagogët e tyne në një shfaqje të madhe, të madhërishtme dhe shakespeare-iane. Disiplina e



punës, sinkronizimi i skenave, ndërrimi i koordinatave skenografike, pjesëmarrja në rolin e një turme që metamorfozohet fillim e mbarim kanë qenë një përplasje e fortë me detyrat e skenës dhe me nevojat e inskenimit të risive bashkëkohore. Në një bisedë me aktorin dhe pedagogun Gazmend Gjoka ai deklaroi me kënaqësi se mobilizimi i këtyne studentëve që kishin një rol dhe një funksion të randësishëm në staturën e kësaj shfaqje ka qenë maksimal dhe disiplina e tyne ka qenë shembullore në përcjelljen me të gjithë vemendjen e provave të gjata për jetësimin e kësaj shfaqje. Një shfaqje e tillë me regji e staf aktorësh të tillë do të ketë qenë për studentët një shans i rrallë,

sepse shfaqje si kjo janë të rralla dhe të kushtueshme. Përfitimi i studentëve nga kjo shfaqje dhe i shfaqjes nga studentët ka qenë i barazpeshuem dhe i ndërsjellë. Vumja në skenë e kësaj shfaqje ka qenë ndoshta si një shtesë masteri për të gjitha ata që u angazhuen në të.

Tashti dy fjalë për skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes.

Mund të them se një risi e padiskutueshme ka qenë skenografia e Iliriana Loxha Bashës. Ndërtimi funksional i skenave të lëvizshme në formë karrelash që shtyhen dhe rreshtohen simbas idesë regjisoriale, ka qenë një mënyrë që i ka dhanë mundësi kalimit nga hapësina teatrore në ato kinematografike. Gjithçka



e langët, e lëvizshme, gjithçka që rrjedh si fjalët e Heraklitit: *panta rei*.

Në kinetizmin e hatashëm që kishte kjo shfaqje për një shpikje fatlume të regjisë dhe të skenografes, edhe lëvizja e karrelave me shtyllat vertikale që sillen nëpër skenë si titanë mitologjikë ka kontribue me rrejtë zhurmën, ritmin dhe kinetizmin e lojës së aktorëve ndër mizanskena. Ato pirgje të bardhë që lëviznin herë para, herë mbrapa e që rreshtoheshin me shpejtësi herë paralel e herë diaagonal, krijonin mbyllje e hapje, korridore e shtigje prej kah aktorët delnin ose ku ata edhe zhdukeshin. Rreshtimi i tyne diagonal e zmadhonte hapësinën skenike dhe krijonte korridore edhe ma të gjata, sepse shkallat zbritëse e ngjitëse ishin vjedhje e hapësinës dhe thellim i skenës. Por kemi një ngatërrim të stilit. Kolonat mbi karrelat ishin me seksion katror ose drejtëkandësh, çka nuk na e sugjeron epokën romake dhe stilet e shtyllave të arkitekturës monumentale të asaj kohe. Skenografia asht pikturë dhe piktura ka kodet e saj. Një shtyllë cilindrike na çon fill tek epoka greko-romake që janë kaq të ngjashme e kaq të nënvaruna. Devijimi nga tipologjia arkitektonike e Romës nuk na e sugjeron Romën. Ajo lëvizje e hatashme masash vertikale na sugjeron luhatjen e ekuilibrave socialë dhe defektet e asaj loje demokracie, pra kemi trandje shteti e jo trandje familjare si në dramën. Jemi në terren tragjik dhe në lojë nuk janë disa ndjenja a disa ndjesi, por asht struktura e një qytetnimi dhe ky qytetnim ka shenjat e veta të pagabueshme që e identifikojnë. Kolona me seksion kandlejtë asht ma e vonë, mbase e epokës së betonarmesë. Po të mos përmendej në dialoget Roma si kryefjalë e atyne rropatjeve me fjalë e me armë, nga shenjat vizuale Roma na mungon si sugjerim lokacioni.

Po kështu mund të themi edhe me kostumografinë. Kostumet romake dhe kostumet e shfaqjes janë në mospërputhje vizuale dhe konvencionale. Ka plot manuale me tipologjitë e veshjeve të klasave e të krahinave të ndryshme italiane të kohës së Romës. Mbase ushtria ose plebejtë, shtresat e vorfna mund të jenë veshë me ato potura apo branavekë me gjinat e ulëta sikurse duken në shfaqje, por ideja e ngulitun që kemi na për veshjet romake urbane asht krejt tjetër. Pra konvencionalja i shërben teatrit, jo autentikja. Romakët identifikohen me tunikat e bardha ose të kuqe me pëlhurë të hjedhun krahëve e me mangët që sajohen nga gjatësia e pëlhurës. Kurse veshja romake e ushtarëve që mbanin shpatë ka qenë ajo ma mashkullorja e ma burrnorja e mundshme. Pancira prej lëkure buelli e çatisun me pulla bronxi e me basorelieve luanësh, rripat e kryqëzuem e pafkat e po kësaj lëkure që i zbresin ushtarit deri në gjysmë të kofshëve dhe ia mbrojnë ato nga shigjetat apo goditjet e shpatave. Ajo turmë ushtarësh ngjyrë kafe e murrme na sugjeronte ma shumë ushtarin aziatik të përtej Eufratit sesa ushtinë romake ashtu siç e jemi mësue me e pa ndër filmat e Hollywood-it.

Mbi versionin e parë teatror shqiptar të *Coriolanus*-it, mbas kaq javësh shfaqje, këtë fundjavë që kaloi ra sipari përfundimtar. Krijuesit e kësaj megashfaqje e dinë se çfarë ndodh me shfaqjet në përgjithësi. Vjen edhe nata e fundit dhe gjithë ai mund, gjithë ajo shtrydhje e fantazisë gremiset në hiçin e lindjes së një shfaqje tjetër. Për Altin Bashën, regjisorin e shfaqjes, *Coriolanus*-in ma shumë po e vret sipari sesa shpata e Aufidius-it. Ai do të donte që ky produksion të shfaqej edhe pak...

Fillimisht, më lejoni t’ju tregoj rreth një ditëlindjeje të veçantë: times.

Më është dhënë jeta në këtë botë më 12 janar, 1949, çka do të thotë se i përkas *boom generation*. E gjata Luftë II Botërore më në fund arriti në një fund dhe ata që ja kishin dalë të mbijetonin panë rreth vetes, morën frymë thellë, u martuan dhe filluan të bënin fëmijë njëri pas tjetrit. Përgjatë katër apo pesë vjetëve të ardhshëm, popullsia e botës u zgjerua – në të vërtetë, shpërtheu në një mënyrë si nuk ishte parë kurrë më parë. Unë isha një nga të paemrit, të panumërtit fëmijë të prodhuar gjatë asaj periudhe.

Dorëzuar në rrënojat e djegura të lëna pas nga sulmi i dendur i raketave, ne në Japoni u poqëm me Luftën e Ftohtë dhe periudha e menjëhershme e rritjes ekonomike, hyri në lulëzimin e adoleshencës dhe u pagëzua në ’60 e vonë si kundërkulturë. Djegur me idealizëm, protestuam kundër një bote të ngurtë, dëgjuam *The Doors* dhe *Jimi Hendrix* (Peace!) dhe mandej, pëlqenim apo jo, arritëm të pranonim jetën e vërtetë që nuk ishte as ideale, as e mbrujtur me rock’n’roll. Dhe tani jemi në të pesëdhjetat tona. Ngjarje dramatike ndodhën përgjatë rrugës – njeriu në hënë, shembja e murit të Berlinit. Këto duken si zhvillime kuptimplote të kohës, sigurisht, dhe ata mund të kenë ushtruar një ndikim praktik në jetën time. Tek shoh pas tani, gjithsesi, duhet të them me gjithë sinqeritetin që këto ngjarje nuk duket të kenë pasur ndonjë pasojë të veçantë në mënyrën se si i barazpeshoj lumturinë me palumturinë apo shpresën dhe dëshpërimin në jetën time. Pavarësisht, shumë ditëlindje që kam përmendur, pavarësisht shumë ngjarjeve ku kam qenë dëshmitar apo i kam përjetuar në vetë të parë, kam ndjerë gjithnjë të mbetem i njëjti unë, se nuk do të mund të isha asgjë tjetër.

Këto ditë kur ngas makinën, vendos CD në ngjyrë të argjendtë të *Radiohead* ose *Blur* në stereo. Kjo është ajo gjë që më tregon se vitet kanë kaluar. Dhe tani e gjej veten duke jetuar në shekullin XXI. Jam apo jo ai njeri që mendoj se nuk i është nënshtruar asnjë ndryshimi thelbësor, toka nuk e ka ndryshuar rrotullimin rreth diellit me të njëjtën shpejtësi të lashtë.

Në të njëjtën mënyrë, një ditëlindje qetësisht vjen përreth për mua një herë çdo vit. Më lumturojnë këto ditëlindje? Më duhet të them “Jo veçanërisht”. Sapo kalova nga 53 në 54: kush do ta shohë këtë si një arritje të madhe? Sigurisht, nëse mjeku i thotë dikujt “Nuk do të jetosh përtej moshës 52 vjeç. Më fal, por duhet të japësh dorëheqjen. Tani është koha të sistemosh çfarë ke në zotërim dhe të shkruash një testament,” dhe pastaj ky njeri gdhin datëlindjen e tij të 54, kjo është diçka që vlen të festohet. Kjo është një arritje e madhe. Për këtë, mund të shoh tek merr me qira një varkë dhe hedh një masiv fishekzjarresh në qendër të Tokyo Bay. Në rastin tim, gjithsesi, për më mirë a për më keq, (megjithëse, sigurisht, për më mirë), nuk kam dëgjuar asnjëherë një fjali të tillë vdekjeje. Dhe kështu, ditëlindjet e mia asnjëherë nuk më kanë bërë jashtëzakonisht të lumtur. Gjëja më e madhe që zakonisht bëj është të hap një shishe të veçantë vere për darkë. Por më lini t’i rikthehem kësaj më vonë.

Kam pasur një përvojë shumë të çuditshme ditëlindjeje – edhe pse ka qenë e çuditshme vetëm për mua, personalisht.

Herët në mëngjesin e ditëlindjes po dëgjoja radio në kuzhinën e shtëpisë time në Tokio. Zakonisht zgjahem herët që të punoj. Zgjohem mes orës katër dhe



HARUKI MURAKAMI

Ditëlindja ime, ditëlindja jote

Përktheu nga anglishtja Andreas Dushi

Pjesë nga parathënia e antologjisë së përgatitur prej tij me tregime për ditëlindjes, “Birthday Stories”

pesë të mëngjesit, bëj një kafe për vete (gruaja akoma po flë), ha një copë nga tosti dhe shkoj në studio që të filloj të shkruaj. Ndërkohë që përgatis mëngjesin, zakonisht dëgjoj lajmet në radio – jo për hir të një zgjedhjeje (nuk ka aq shumë çka vlen të dëgjohet), por sepse nuk ka aq shumë çfarë të bësh në atë orë aq herët. Atë mëngjes, ndërsa prisja ujin të valonte, lexuesi i lajmeve po shpallte një listë të ngjarjeve publike të planifikuara për ditën, me detaje kur dhe ku ato do të ndodhnin. Për shembull, Perandori do të shkonte për të mbjellë një pemë ceremoniale, ose një anije e madhe pasagjerësh britanikë po priste të ankorohet në Yokohama, ose ngjarjet që do të mbaheshin në vend në nderim të ditës zyrtare të përtypjes së çamçakizit (e di se ngjan qesharake, por nuk po e shpik: vërtetë është një ditë e tillë).

Gjëja e fundit në listën e ngjarjeve publike ishte një shpallje e emrave të njerëzve të famshëm, ditëlindja e të cilëve bie më 12 janar. Dhe aty, mes tyre, ishte edhe imja. “Romancieri Haruki Murkami kremton sot ditëlindjen e tij të **,” tha lexuesi. Isha vetëm gjysëm i përqendruar në dëgjim por edhe ashtu, në zërin e emrit tim thuajse godita ibrikun e ngrohtë. “Wow!” bërtita dhe pashë rreth dhomës mosbesues. “Kështu që,” më erdhi pas pak

një si brejtje, “ditëlindja ime nuk është më vetëm për mua. Tani ata e listojnë si një ngjarje publike.”

Një ngarje publike?

Epo mirë, ngjarje publike apo jo, të paktën në atë çast disa njerëz përreth Japonisë – ishte një frekuencë kombëtare – në këmbë (ose ulur) nga radiot e tyre kanë pasur të paktën ndoca mendime fluturse rreth meje. “Pra, sot është ditëlindja e Haruki Murakamit, eh?” ose “Oh, wow, Haruki Murakami është gjithashtu ** vjeç tani!” ose “Hey, don ta dish, edhe djemtë si Haruki Murakami kanë ditëlindje!” Ndonëse, në të vërtetë, sa njerëz në Japoni mund të kenë qenë në këtë orë qesharake që pa gdhirë duke dëgjuar lajmet në radio? Njëzetë ose tridhjetë mijë? Dhe sa prej tyre do ta kenë ditur emrin tim? Dy ose tre mijë? Nuk ia kam absolutisht idenë!

Statistikat mënjane, edhe pse nuk mund të ndihmoj por ndjej një lloj lehtësie, lidhjeje natyrore me botën. Nuk ishte një lidhje që mund të shërbente për ndonjë qëllim në vetvete, as ndonjë që kishte farë ndikimi në jetën e një personi. Ishte, supozoj, ajo lidhje e veçantë që njerëzit ndjejnë njëri me tjetrin kur e dinë se njëri syresh feston ditëlindjen e tij a të saj. Për pak, provova ta konturoj këtë lidhje në sytë e mendjes time: materialin, ngjyrën,

gjatësinë, këndet, intensitetin e saj. Sërish, për njëfarë kohe, mendova rreth idealeve dhe kompromiseve, rreth Luftës së Ftohtë dhe rritjes ekonomike të Japonisë. Mendova gjithashtu rreth plakjes, rreth testamenteve dhe fishekzjarrëve. Dhe atëherë, ndalova së menduari njëherazi dhe, në vend të saj, u përqendrova në bërjen e një filxhani të mirë me kafe për veten.

Kur kafeja ishte gati, e hodha në një gotë të madhe (një me logon e Muzeut të Australisë: diçka që kam blerë në Sidney), e mora me vete në studion time, u ula përballë tavolinës, afrova Apple Mac-un tim, vura të luhej një koncert Teleman për erën e pyllit në stereo me zë të ulët dhe fillova ditën time të punës. Ishte akoma errësirë jashtë. Dita sapo kishte filluar. Ishte një ditë e veçantë e vitit, por në të njëjtën kohë ishte një ditë tërësisht e zakonit. Po punoja në kompjuterin tim. Ndoshta ndonjë nga këto vjet, do të kem atë lloj datëlindjeje dramatike kur do të dua të vozis një varkë në qendër të Tokyo Bar dhe të hedh një masiv fishekzjarrësh. Dhe nëse një ditëlindje e tillë vjen ndonjëherë, do ta vozis varkën pa asnjë hezitim, nuk ka rëndësi çfarë mund të thojë kushdo, dhe do të lë Tokyo Bay në thellësinë e dimrit me një ngarkesë fishekzjarrësh. Por sot, të paktën, nuk ishte kjo ditë. Ditëlindja e këtij viti nuk ishte një ditëlindje e tillë. Thjesht do të rri në tavolinën time si gjithnjë, qetësisht në një ditë pune.

*

Sikurse e thashë më para, ditëlindja ime bie në 12 janar. Një herë kërkova në internet për të parë me kë tjetër e ndaj këtë datë dhe isha i emocionuar të gjeja emrin e Jack London (dhe njëres nga Spice Girls gjithashtu, më duhet të shtoj). Kam qenë një lexues i devotshëm i Jack London-it për vite. Me entuziasëm të madh, jo vetëm i punëve të tija të mirënjohura si *White Fang* dhe *The Call of the Wild*, por gjithashtu i një serë prej historive të tija më pak të njohura dhe biografisë së tij. E dua stilin e tij të fortë e të thjeshtë dhe vizionin e tij çuditërisht të qashtë romanor, e dua energjinë e tij të rrallë, mënyrën se si ai tejkalon sensin e zakonshëm dhe farkëton drejt e përpara, s’ka rëndësi se çfarë, sikur të jetë duke mbushur disa boshllëqe të mëdha. Kam menduar gjithmonë për të si për një shkrimtar i cili meriton shumë më shumë nderim letrar nga sa normalisht i është dhënë. Të mendosh se Jack London dhe unë kemi lidhjen intime të bashkëndarjes së ditëlindjes. 12 janari i tij bie në 1876, 73 vjet para timit.

Kur po udhëtoja në Kaliforni në fillim të ’90, për të respektuar këtë shkrimtar legjendar, vizitova fermën që kishte pasur Jack London në një vend të quajtur Glen Ollen, shteti Sonoma, *pranë së cilës gjendet edhe një kantinë që prodhon verë me emrin e tij*.

Për hir të këtyre kujtimeve kaq të këndshme, e kam bërë rregull tani që të hap një shishe vere *Jack London* (Cabernet Sauvignon) për darkë, çdo vit për ditëlindjen time. [...] E ngre gotën me shpresën që ky shkrimtar i shquar amerikan të prehet në paqe. Kjo ndoshta nuk është ceremonia më e përshtatshme për të përkujtuar vdekjen e një pijetari aq të shquar sa London (ai e shkatërroi mëlçinë dhe vdiq në moshën 40 vjeçare). Por, në çdo rast, kjo “Jack London” është verë e shijshme, e thatë dhe e plotë. Ata nuk prodhojnë shumë, prandaj mund të jetë e vështirë ta gjes, por është e përkryer për të shoqëruar leximin e veprës së London.



Pardje ka ndërruar jetë akademiku dhe shkrimtari i shquar Luan Starova. Lajmin për vdekjen e tij e kanë bërë të ditur familjarët e tij në *Facebook*.

Luan Starova ka *lindur* në Pogradec më 1941. Si student i gjuhës dhe i letërsisë frënge, punoi një kohë si gazetar. Më vonë u pranua asistent në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë frënge në Fakultetin Filologjik të Shkupit, në të cilën ka qenë profesor i rregullt i letërsisë frënge. Së fundmi ai ka ligjëruar në Universitetin e Europës Juglindore të Tetovës.

Luan Starova ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë dhe i Akademisë Mesdhetare në Napoli.

Trashëgimia e tij letrare është shumë e pasur. Ka botuar shtatë romane, dy vëllime me tregime, një me poezi, disa vëllime me ese dhe studime, ka përkthyer poetë të njohur francezë në shqip dhe maqedonisht. Ka shkruar paralelisht në shqip dhe në maqedonisht.

Starova renditet ndër shkrimtarët shqiptarë më të përkthyer në botë, pas Kadaresë. Është fitues i çmimit më të lartë francez për art dhe letërsi.

ExLibris ka pasur fatin të botojë një intervistë të gjatë për jetën dhe krijimtarinë e Starovës.

Redaksia e gazetës *ExLibris* dhe shtëpisë botuese *Onufri* u shprehin ngushëllimet më të thella familjarëve dhe miqve të shumtë të autorit.